



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 175

Tiranë – E enjte, 6 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 76/2026, datë 23.7.2026	Për grupimet ekonomike me interes evropian..... 17793
Dekret i Presidentit nr. 461, datë 31.7.2026	Për shpallje ligji..... 17802
Ligj nr. 77/2026, datë 23.7.2026	Për shoqëritë evropiane të bashkëpunimit (SHEB)..... 17802
Dekret i Presidentit nr. 462, datë 31.7.2026	Për shpallje ligji..... 17822
Ligj nr. 80/2026, datë 23.7.2026	Për kërkesat e transparencës për emetuesit e titujve..... 17822
Dekret i Presidentit nr. 458, datë 30.7.2026	Për shpallje ligji..... 17850
Ligj nr. 84/2026, datë 23.7.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 17850
Dekret i Presidentit nr. 467, datë 3.8.2026	Për shpallje ligji..... 17857



LIGJ
Nr. 76/2026

PËR GRUPIMET EKONOMIKE ME
INTERES EVROPIAN¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Themelimi dhe personaliteti juridik i grupimit

1. Grupimet ekonomike me interes evropian formohen sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Personat që synojnë të formojnë një grupim ekonomik me interes evropian duhet të lidhin një kontratë dhe të kryejnë regjistrimin e parashikuar në nenin 6 të këtij ligji.

3. Grupimi i formuar në këtë mënyrë nga data e regjistrimit të tij, siç parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, ka personalitet juridik të ndarë nga anëtarët e tij dhe aftësinë të ketë të drejta dhe detyrime, të lidhë kontrata ose të kryejë aktivitete të tjera ligjore, si dhe të padisë e të paditet.

Neni 2

Ligji i zbatueshëm dhe përkufizime

1. Ligji i zbatueshëm për kontratën për themelimin e grupimit ekonomik me interes evropian, me përjashtim të çështjeve që kanë të bëjnë me statusin juridik ose aftësinë juridike të personave të tyre fizikë (person fizik tregtar ose individin sipas kontekstit) ose juridikë dhe organizimin e brendshëm të grupimit, është ligji shqiptar, nëse adresa zyrtare e grupimit, siç përcaktohet në kontratën e themelimit, ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Ligji tregtar**” është ligji shqiptar për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;

b) “**Kontratë**” është kontrata për themelimin e një grupimi ekonomik me interes evropian;

c) “**QKB**” është Qendra Kombëtare e Biznesit;

ç) “**GEIE**” ose “**grupimi**” është një grupim të njohur si grupim ekonomik me interes evropian, i themeluar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) “**Shtet anëtar**” është një shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Neni 3

Qëllimi dhe kufizimet e veprimtarisë së grupimit

1. Qëllimi i grupimit është të lehtësojë ose të zhvillojë aktivitetet ekonomike të anëtarëve të tij dhe të përmirësojë ose të rrisë rezultatet e këtyre aktiviteteve. Qëllimi i grupimit nuk është të nxjerrë fitime për veten.

2. Aktiviteti i tij do të lidhet me aktivitetet ekonomike të anëtarëve të tij dhe nuk duhet të jetë më shumë se ndihmës i këtyre aktiviteteve. Rrjedhimisht, grupimi nuk mund:

a) të ushtrojë drejtpërdrejt ose tërthorazi administrimin ose mbikëqyrjen e aktiviteteve të anëtarëve të tij ose aktiviteteve të një shoqërie tjetër, veçanërisht në fushat e personelit, financave dhe investimeve;

b) të zotërojë drejtpërdrejt ose tërthorazi në çfarëdo baze, aksione të çfarëdolloji në kapitalin e një prej anëtarëve të tij. Pjesëmarrja në shoqëri të tjera si aksionar lejohet vetëm nëse është e nevojshme për realizimin e objektivave të grupimit dhe/ose kryhet në emër dhe për llogari të anëtarëve të tij;

c) të punësojë më shumë se 500 persona;

ç) të përdoret nga një shoqëri për t'i dhënë një hua një administratori të një shoqërie ose çdo personi të lidhur me të;

d) dhe nuk duhet të përdoret për transferimin e pasurisë midis një shoqërie dhe një administratori ose një personi të lidhur me të, përveçse në masën që lejohet nga legjislacioni përkatës i shteteve anëtare. Për qëllimet e kësaj

¹ Ky ligj është përfshirë plotësisht me rregulloren e Këshillit të Komunitetit Evropian për grupimin ekonomik evropian të interesit (EEIG), të publikuar me

rregulloren KE nr. 2137/85, të 25 korrikut 1985; OJ L 199, 31.7.1985, p. 1–9.



dispozite, dhënia e një huaje përfshin çdo transaksion ose marrëveshje me efekt të ngjashëm dhe pasuria përfshin pasuri të tundshme dhe të patundshme;

dh) të jetë anëtar i grupimit tjetër ekonomik me interes evropian.

3. Për qëllimet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 2 të këtij neni, dhënia e një huaje përfshin hyrjen në çdo transaksion ose marrëveshje me efekt të ngjashëm dhe prona përfshin pronën e luajtshme e të paluajtshme.

Neni 4

Anëtarët e grupimit dhe kushtet e anëtarësimit

1. Vetëm personat e mëposhtëm mund të jenë anëtarë të grupimit:

a) personat fizikë dhe personat juridikë të së drejtës publike ose private, të cilët janë krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar ose të një shteti anëtar dhe e kanë selinë e tyre të regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar. Kur sipas ligjit të një shteti anëtar një person fizik ose juridik, ose subjekt tjetër juridik nuk është i detyruar të ketë një seli të regjistruar ose statutore, është e mjaftueshme që ai person të ketë administratën e tij qendrore brenda Bashkimit Evropian;

b) personat fizikë që ushtrojnë çdo veprimtari industriale, tregtare, artizanale ose bujqësore apo ofrojnë shërbime profesionale, ose të tjera në Shqipëri ose brenda Bashkimit Evropian.

2. Grupimi duhet të përbëhet të paktën, nga:

a) dy persona fizikë ose juridikë, ose subjekte të tjera juridike në kuptim të pikës 1 të këtij neni, të cilët kanë administratat e tyre qendrore në shtete anëtare dhe në Republikën e Shqipërisë; ose

b) dy persona fizikë të cilët ushtrojnë aktivitetet e tyre kryesore në shtete anëtare ose në Shqipëri; ose

c) një person juridik dhe një person fizik, prej të cilëve i pari ka administratën e tij qendrore në një shtet anëtar ose në Shqipëri dhe i dyti ushtron aktivitetin e tij kryesor në një shtet tjetër anëtar ose në Shqipëri, me kusht që Shqipëria të mos jetë njëkohësisht vendi i administratës qendrore të personit juridik dhe vendi i aktivitetit kryesor të personit fizik, në kuptim të kësaj pike.

3. Grupimet e regjistruara në QKB, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, nuk duhet të kenë më shumë se 20 anëtarë.

4. Anëtarësia në grupim është personale dhe e pandashme, pa miratimin unanim të anëtarëve të tjerë. Transferimi i të drejtave të anëtarësisë te një person i ri lejohet vetëm me pëlqimin unanim me shkrim të të gjithë anëtarëve dhe me ndryshimin përkatës të marrëveshjes themeluese, i cili depozitohet pranë QKB-së. Çdo ndryshim në përbërjen e anëtarëve të GEIE-së regjistrohet dhe publikohet, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.

Neni 5

Përmbajtja minimale e kontratës së themelimit

Kontrata për themelimin e grupimit duhet të përfshijë, të paktën:

a) emrin e grupimit të paraprirë ose të ndjekur nga fjalët “Grupim ekonomik me interes evropian” ose nga inicialet “EEIG”, përveç nëse këto fjalë ose inicialet janë pjesë të emrit;

b) adresën zyrtare të grupimit;

c) objektivat për të cilët formohet grupimi;

ç) emrin, emrin tregtar, formën juridike, adresën e përhershme ose selinë e regjistruar, numrin dhe vendin e regjistrimit, nëse ka, të çdo anëtari të grupimit;

d) kohëzgjatjen e grupimit, përveç kur kjo është e pacaktuar.

Neni 6

Regjistrimi i grupimit

Grupimi regjistrohet në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, në përputhje me pikën 1, të nenit 38 të këtij ligji.

Neni 7

Dokumentacioni dhe të dhënat që depozitohen në regjister

Kontrata për themelimin e grupimit depozitohet në regjistrin e përmendur në nenin 6 të këtij ligji. Dokumentet dhe të dhënat e mëposhtme depozitohen në regjister, si më poshtë:



a) çdo ndryshim në kontratën për themelimin e grupimit, duke përfshirë çdo ndryshim në përbërjen e grupimit;

b) njoftimi për hapjen ose mbylljen e çdo dege të grupimit;

c) vendimi gjyqësor që themelon ose deklaron pavlefshmërinë e grupimit, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;

ç) njoftimi i emërimit të administratorit ose administratorëve të grupimit, emrat e tyre dhe çdo e dhënë tjetër identifikuese që kërkohet nga QKB-ja për regjistrimin e shoqërive tregtare të themeluara, sipas ligjit tregtar. Njoftimi se ata veprojnë vetëm ose bashkërisht dhe përfundimi i çdo emërimi të administratorit;

d) vendimi për miratimin e transferimit të pjesëmarrjes së një anëtarë në grupim ose një pjesë të tij së bashku me njoftimin përkatës, në përputhje me pikën 1, të nenit 22 të këtij ligji;

dh) çdo vendim i anëtarëve që urdhëron ose nis procedurat e likuidimit të grupimit, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, ose çdo vendim gjyqësor që urdhëron likuidimin në përputhje me nenin 31 ose 32 të këtij ligji;

e) njoftimi i emërimit të likuidatorit ose likuidatorëve të grupimit, siç referohet në nenin 35 të këtij ligji, emrat e tyre dhe çdo e dhënë tjetër identifikuese, në përputhje me kërkesat e QKB-së për likuidatorët e caktuar për shoqëritë tregtare të organizuara, sipas ligjit tregtar, dhe përfundimi i detyrës së likuidatorit;

ë) njoftimi i përfundimit të likuidimit të grupimit, siç referohet në nenin 35 të këtij ligji;

f) çdo propozim për transferimin e adresës zyrtare, siç referohet në pikën 1, të nenit 14 të këtij ligji;

g) çdo dispozitë që përjashton një anëtar të ri nga pagesa e detyrimeve të tjera që kanë lindur para pranimit të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji.

Neni 8

Publikimi i dokumenteve dhe të dhënave në regjistër

Të dhënat e mëposhtme duhet të publikohen, siç përcaktohet në nenin përkatës të këtij ligji, në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, si më poshtë:

a) të dhënat që duhet të përfshihen në kontratën për themelimin e grupimit, në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji, dhe çdo ndryshim i tyre;

b) numri, data dhe vendi i regjistrimit, si dhe njoftimi i përfundimit të atij regjistrimi;

c) dokumentet dhe të dhënat e parashikuara nga shkronja “b” deri në shkronjën “g”, të nenit 7 të këtij ligji.

Të gjitha të dhënat që përmenden në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni duhet të publikohen në formën e tyre të plotë në regjistrin tregtar. Dokumentet dhe të dhënat që përmenden në shkronjën “c” të këtij neni duhet të publikohen ose në formë të plotë, ose si pjesë përbërëse e ekstraktit tregtar të grupimit.

Neni 9

Certifikimi i regjistrimit dhe veprimet paraprake

1. Dokumentet dhe të dhënat që duhet të publikohen në përputhje me këtë ligj mund të përdoren nga grupimi kundrejt palëve të treta, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji kombëtar i zbatueshëm. Me regjistrimin e grupimit, QKB-ja lëshon ekstraktin tregtar që vërteton se GEIE-ja është regjistruar.

2. Ekstrakti tregtar përbën provë përfundimtare se kërkesat e këtij ligji lidhur me regjistrimin, si dhe çështjet paraprake dhe të ndërlidhura me të, janë përmbushur, dhe se grupimi është një organizim i autorizuar për t'u regjistruar dhe është regjistruar në përputhje me këtë ligj.

3. Nëse aktivitetet janë kryer në emër të grupimit para regjistrimit të tij, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe nëse grupimi nuk merr përsipër pas regjistrimit të tij detyrimet që rrjedhin nga aktivitete të tilla, personat fizikë, shoqëritë, firmat ose çdo person fizik ose juridik, që kanë kryer këto aktivitete, do të mbajnë përgjegjësi të pakufizuar solidare për to.

Neni 10

Regjistrimi i degëve në shtete anëtare

Çdo degë e grupimit, e vendosur në një shtet anëtar, do të regjistrohet në atë shtet.



Për qëllimin e këtij regjistrimi, grupimi do të depozitohet në regjistrin përkatës në atë shtet anëtar kopje të dokumenteve që duhet të depozitohen në QKB së bashku, nëse është e nevojshme, me një përkthim, që përputhet me praktikën e regjistrimit ku është regjistruar dega.

Neni 11

Njoftimi në gazetën zyrtare të komuniteteve evropiane

Njoftimi se grupimi është formuar ose se likuidimi i grupimit është përfunduar, duke deklaruar numrin, datën dhe vendin e regjistrimit dhe datën, vendin dhe titullin e publikimit, do të jepet në gazetën zyrtare të BE-së, pasi të jetë publikuar në QKB, sipas nenit 40 të këtij ligji.

Neni 12

Adresa zyrtare e grupimit

Adresa zyrtare e përmendur në kontratën për formimin e një grupimi duhet të jetë e vendosur brenda Bashkimit Evropian dhe/ose Shqipërisë.

Adresa zyrtare duhet të jetë e caktuar në njërin nga këto vende:

a) aty ku grupimi ka administratën e tij qendrore; ose

b) aty ku njëri prej anëtarëve të grupimit ka administratën e tij qendrore ose, në rastin e një personi fizik, aty ku zhvillon aktivitetin e tij kryesor, me kusht që grupimi të kryejë një aktivitet në atë vend.

Neni 13

Transferimi i adresës zyrtare të grupimit

Adresa zyrtare e grupimit mund të transferohet nga një vend në një tjetër brenda komunitetit. Nëse ky transferim nuk sjell ndryshim të ligjit të zbatueshëm për grupimin, në kuptim të nenit 2 të këtij ligji, atëherë vendimi për transferimin e adresës merret në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratën e themelimit të grupimit. Në të gjitha rastet e tjera, kur si rezultat i transferimit ndryshon ligji i zbatueshëm, zbatohen procedurat e veçanta të përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 14

Transferimi i adresës zyrtare kur ndryshon ligji i zbatueshëm

1. Kur transferimi i adresës zyrtare sjell ndryshime në ligjin e zbatueshëm, sipas përcaktimeve në nenin 2 të këtij ligji, propozimi për transferim duhet të hartohet, të depozitohet dhe të publikohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Asnjë vendim për transferim nuk mund të merret për 2 muaj pas publikimit të propozimit. Çdo vendim i tillë duhet të merret unanimisht nga anëtarët e grupimit. Transferimi hyn në fuqi në datën në të cilën grupimi regjistrohet, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, në regjistrin për adresën e re zyrtare. Ky regjistrim nuk mund të kryhet derisa të jetë paraqitur prova se propozimi për transferimin e adresës zyrtare është publikuar.

2. Përfundimi i regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e tij të vjetër zyrtare nuk mund të kryhet para se të jetë paraqitur prova e regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e re zyrtare.

3. Pas publikimit të regjistrimit të ri të grupimit, adresa e re zyrtare mund t'u bëhet e ditur palëve të treta, në përputhje me kushtet e referuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji, megjithatë, për sa kohë përfundimi i regjistrimit të grupimit në regjistrin për adresën e vjetër zyrtare nuk është publikuar, palët e treta mund të vazhdojnë të mbështeten në adresën e vjetër zyrtare, përveçse kur grupimi provon se palët e treta ishin në dijeni të adresës së re zyrtare.

Neni 15

Pavlefshmëria e grupimit

1. Një grupim mund të shpallet i pavlefshëm vetëm me vendim gjykatë. Gjykata të cilës i drejtohet çështja, aty ku është e mundur që punët e grupimit të rregullohen, të japë kohë për të bërë këtë.

2. Pavlefshmëria e grupimit bazohet vetëm:

a) në shkeljen e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 4 të këtij ligji;

b) kur qëllimi i grupimit është i paligjshëm ose bie ndesh me rendin publik.



3. Pavlefshmëria e grupimit sjell likuidimin e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji.

4. Një vendim që themelon ose deklaron pavlefshmërinë e grupimit mund t'u drejtohet palëve të treta, në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 9 të këtij ligji. Ky vendim nuk ndikon në vlefshmërinë e detyrimeve të pagueshme nga ose ndaj grupimit, të cilat kanë lindur para momentit kur vendimi mund të ketë efekt ndaj palëve të treta.

Neni 16

Organet e grupimit

1. Organet e grupimit janë:

a) anëtarët të cilët veprojnë kolektivisht dhe ushtrojnë kompetencat vendimmarrëse, të përcaktuara në këtë ligj dhe në kontratën për themelimin e grupimit;

b) administratori ose administratorët të cilët ushtrojnë funksionet ekzekutive e të përfaqësimit, në përputhje me këtë ligj dhe me kontratën e themelimit.

2. Kontrata për themelimin e grupimit mund të parashikojë edhe krijimin e organeve të tjera shtesë, për qëllime këshillimore ose mbikëqyrëse, duke përcaktuar qartë përbërjen e tyre, mënyrën e emërimit të anëtarëve të tyre, kompetencat dhe fushëveprimin e tyre, dhe raportet me organet e tjera të grupimit.

3. Kompetencat e secilit organ caktohen në përputhje me këtë ligj dhe me kontratën për themelimin e grupimit pa cenuar dispozitat e kapitujve të veçantë për administrimin dhe përfaqësimin e grupimit.

4. Anëtarët e grupimit, duke vepruar si një organ, mund të marrin çdo vendim të ligjshëm për qëllimin e arritjes së objektivave të grupimit.

Neni 17

Të drejtat e votës dhe vendimmarrja e anëtarëve

1. Çdo anëtar ka një votë. Kontrata për themelimin e grupimit mund t'u japë më shumë se një votë disa anëtarëve, me kusht që asnjë anëtar të mos mbajë shumicën e votave.

2. Vendimi unanim i anëtarëve është i nevojshëm:

a) për të ndryshuar objektivat e grupimit;

b) për të ndryshuar numrin e votave të caktuara për çdo anëtar;

c) për të ndryshuar kushtet për marrjen e vendimeve;

ç) për të zgatur kohëzgjatjen e grupimit përtej çdo periudhe të fiksuar në kontratën për themelimin e grupimit;

d) për të ndryshuar kontributin e çdo anëtari ose të disa anëtarëve në financimin e grupimit;

dh) për të ndryshuar çdo detyrim tjetër të anëtarit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata për themelimin e grupimit;

e) për të bërë çdo ndryshim në kontratën për themelimin e grupimit që nuk parashikohet në këtë pikë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ajo kontratë.

3. Përveçse kur ky ligj parashikon që vendimet duhet të merren unanimisht, kontrata për themelimin e grupimit mund të përcaktojë kushtet për kuorumin dhe për shumicën, në përputhje me të cilat do të merren vendimet, ose disa prej tyre. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga kontrata, vendimet do të merren unanimisht.

4. Me iniciativën e një administratori ose me kërkesë të një anëtari, administratorët organizojnë një mbledhje në të cilën anëtarët konsultohen paraprakisht për çështje të caktuara, në mënyrë që të mund të marrin një vendim.

Neni 18

E drejta e anëtarëve për informim dhe inspektim

Çdo anëtar ka të drejtë të marrë informacion nga administratorët për ecurinë tregtare të grupimit dhe të inspektojë librat dhe regjistrat e biznesit të grupimit.

Neni 19

Administratorët e grupimit, emërimi dhe kompetencat

1. Grupimi administrohet nga një ose më shumë persona fizikë të emëruar në kontratën për themelimin e grupimit ose me vendim të anëtarëve. Asnjë person nuk mund të jetë administrator i grupimit nëse, pas një vendimi gjyqësor ose administrativ të marrë, ose të njohur në Shqipëri ose një shtet anëtar, administratori



nuk mund të bëjë pjesë në organin administrativ, ose drejtues të një shoqërie tregtare ose nuk mund të veprojë si administrator i GEIE-së.

2. Kontrata për themelimin e grupimit ose, në mungesë të saj, një vendim unanim i anëtarëve përcakton kushtet për emërimin dhe shkarkimin e administratorit, ose administratorëve dhe kompetencat e tyre.

Neni 20

Përfaqësimi i grupimit dhe kompetencat e administratorëve

1. Përfaqësimin e grupimit me palë të treta e kanë vetëm administratori ose administratorët kur janë dy ose më shumë.

2. Grupimi mbetet i detyruar nga këto veprime edhe nëse ato nuk janë në përputhje me objektivat e tij, përveçse në rastet kur grupimi provon se pala e tretë ka pasur dijeni për mospërputhjen ose, në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni. Publikimi i të dhënave, të referuara në shkronjën “c” të nenit 5 të këtij ligji, nuk do të jetë në vetvete provë për këtë. Asnjë kufizim në kompetencat e administratorëve, pavarësisht nëse buron nga kontrata e themelimit të grupimit apo nga një vendim i anëtarëve, nuk mund t’u drejtohet palëve të treta, edhe nëse është publikuar.

3. Kontrata për themelimin e grupimit mund të parashikojë që grupimi të përfaqësohet vetëm nga dy ose më shumë administratorë që veprojnë bashkërisht. Një klauzolë e tillë mund t’u drejtohet palëve të treta vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji dhe vetëm nëse është publikuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

Neni 21

Pjesëmarrja në fitime dhe humbje

1. Fitimet që rezultojnë nga aktivitetet e grupimit do të konsiderohen si fitime të anëtarëve dhe do të ndahen mes tyre në proporcionet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të ndonjë dispozite të tillë, në pjesë të barabarta.

2. Anëtarët e grupimit do të kontribuojnë në pagesën e shumës me të cilën shpenzimet tejkalojnë të ardhurat në proporcionet e

përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të ndonjë dispozite të tillë, në pjesë të barabarta.

Neni 22

Transferimi i pjesëmarrjes së anëtarit dhe përdorimi i saj si garanci

1. Çdo anëtar i grupimit mund të transferojë pjesëmarrjen e tij në grupim, në tërësi ose për një pjesë të saj (në kuptimin e një përqindjeje të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga cilësia e anëtarit), të një anëtar tjetër ose një palë e tretë, me kusht që ky transferim të miratohet unanimisht nga të gjithë anëtarët e tjerë.

2. Anëtar i grupimit mund të përdorë pjesëmarrjen e tij si garanci vetëm nëse të gjithë anëtarët e tjerë japin miratim unanim, përveçse kur kontrata e themelimit parashikon ndryshe. Marrësi i garancisë nuk mund të fitojë statusin e anëtarit të grupimit vetëm në bazë të kësaj garancie, pa kaluar procedurën e pranimit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në kontratën e grupimit.

Neni 23

Ndalimi i mbledhjes së investimeve nga publiku

Grupimi nuk mund të mbledhë apo të marrë investime nga publiku.

Neni 24

Përgjegjësia e anëtarëve për detyrimet e grupimit

1. Anëtarët e grupimit kanë përgjegjësi të pakufizuar dhe solidare për detyrimet e grupimit, të çfarëdo natyre qofshin ato.

2. Çdo dispozitë në kontratën e themelimit të grupimit që përpiqet të përjashtojë ose të kufizojë përgjegjësinë e përmendur në pikën 1 të këtij neni është e pavlefshme.

3. Kreditorët nuk mund të kërkojnë ekzekutimin e detyrimeve të grupimit ndaj anëtarit, përveçse në rastet kur fillimisht i kanë kërkuar pagesën grupimit dhe pagesa nuk është bërë brenda një kohe të arsyeshme, por jo më vonë se 3 muaj.



Neni 25

Të dhënat e detyrueshme në dokumentet zyrtare të grupimit

1. Çdo shkresë apo dokument zyrtar i grupimit duhet të përmbajë:

a) emrin e grupimit të paraprirë ose të ndjekur apo nga fjalët “Grupim ekonomik me interes evropian” ose nga inicialet “GEIE”, përveçse kur këto fjalë ose inicialet tashmë gjenden në emër;

b) vendndodhjen e regjistrimit, të referuar në nenin 6 të këtij ligji, në të cilin është regjistruar grupimi, së bashku me numrin unik të identifikimit në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja;

c) adresën zyrtare të grupimit;

ç) kur është e zbatueshme, shënimin se administratorët veprojnë bashkërisht;

d) kur është e zbatueshme, shënimin se grupimi është në likuidim, në përputhje me nenet 15, 31, 32 ose 36 të këtij ligji.

2. Çdo degë e grupimit, kur regjistrohet në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, duhet të japë të dhënat e mësipërme së bashku me ato që lidhen me regjistrimin e saj në dokumentet e referuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 26

Pranimi i anëtarëve të rinj dhe përgjegjësia e tyre

1. Vendimi për pranimin e anëtarëve të rinj merret unanimisht nga anëtarët e grupimit.

2. Çdo anëtar i ri është përgjegjës, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji, për të gjitha detyrimet e grupimit, përfshirë ato që kanë lindur përpara pranimin të tij. Ai përjashtohet nga kjo përgjegjësi nëse një përjashtim i tillë parashikohet në kontratën për themelimin e grupimit ose në aktin e pranimin të tij si anëtar vetëm për detyrime që rrjedhin para anëtarësisë së tij. Ky përjashtim ka efekt ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 27

Tërheqja dhe përjashtimi i anëtarëve

1. Anëtari i grupimit mund të tërhiqet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose, në mungesë të kushteve të tilla, me miratimin unanim të anëtarëve të tjerë.

Anëtari i grupimit mund të tërhiqet, gjithashtu, nëse grupimi apo anëtarët e tjerë kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse grupimi i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e anëtarësisë. Anëtari që kërkon largimin duhet të njoftojë grupimin me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

2. Çdo anëtar i grupimit mund të përjashtohet për arsyet e listuara në kontratën për themelimin e grupimit.

3. Përveç sa është parashikuar në pikën 2 të këtij neni, me vendim unanim të marrë nga anëtarët e grupimit, në përputhje me kontratën e themelimit, grupimi mund të vendosë t’i kërkojë gjykatës përjashtimin e një anëtari, nëse ai ka dështuar të përmbushë kontributin e tij financiar ose kontribut tjetër, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për përjashtimin. Për qëllime të kësaj pike, përbëjnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin, kur:

a) anëtari, me dashje ose pakujdesi të rëndë, i shkakton dëme grupimit ose anëtarëve të tjerë;

b) anëtari përfshihet në sjellje që e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda grupimit;

c) veprimet ose mosveprimet e anëtarit pengojnë ndjeshëm funksionimin ose objektivat e përbashkët të grupimit.

Neni 28

Përfundimi i anëtarësisë

1. Statusi i anëtarit në grupim përfundon, kur:

a) anëtari është person fizik dhe ndërron jetë;

b) anëtari është person juridik dhe ai shpërbëhet, likuidohet ose çregjistrohet nga regjistri përkatës;

c) anëtari nuk i përmbush më kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 4 të këtij ligji.

2. Në rast vdekjeje të një personi fizik që është anëtar i grupimit, askush nuk mund të bëhet anëtar në vend të tij, përveçse sipas kushteve të përcaktuara në kontratën për formimin e grupimit ose, në mungesë të saj, me pëlqimin unanim të anëtarëve të mbetur.

Neni 29

Njoftimi dhe veprimet pas largimit të një anëtari

Sapo një anëtar pushon së qeni pjesë e grupimit, administratorët duhet të informojnë anëtarët e tjerë



për këtë fakt, si dhe të ndërmarrin hapat e kërkuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Përveç administratorëve, çdo person i interesuar mund të ndërmarrë këta hapa.

Neni 30

Vazhdimi i grupimit pas largimit të një anëtarit

Përveçse kur kontrata për themelimin e grupimit parashikon ndryshe dhe pa cenuar të drejtat e fituara nga një person, sipas pikës 1, të nenit 22 të këtij ligji ose pikës 2, të nenit 28 të këtij ligji, grupimi do të vazhdojë të ekzistojë për anëtarët e mbetur, pasi anëtarit i larguar të ketë pushuar së qeni pjesë e tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën për themelimin e grupimit ose të përcaktuara me vendim unanim të anëtarëve në fjalë.

Neni 31

Mbyllja e grupimit me vendim të anëtarëve

1. Grupimi mund të mbyllet me vendim të anëtarëve të tij, me kusht që ky vendim të merret unanimisht, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratën për themelimin e grupimit.

2. Grupimi duhet të mbyllet me vendim të anëtarëve të tij, kur:

a) ka përfunduar kohëzgjatja e grupimit, e parashikuar në kontratën për themelimin e grupimit ose kur ekziston ndonjë shkak tjetër për mbyllje të parashikuar në kontratë; ose

b) është përmbushur qëllimi i grupimit ose është e pamundur të ndiqet më tej ky qëllim. Në rast se 3 muaj pasi ka ndodhur një nga situatat e referuara në këtë pikë vendimi i anëtarëve për mbylljen e grupimit nuk është marrë, çdo anëtar mund t'i drejtohet gjykatës për të urdhëruar mbylljen.

3. Grupimi mbyllet me vendim të anëtarëve të tij ose të anëtarit të mbetur, kur kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 4 të këtij ligji nuk mund përmbushen më.

4. Pasi grupimi të jetë mbyllur me vendim të anëtarëve të tij, administratorët duhet të ndërmarrin hapat e kërkuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji. Përveç administratorëve, çdo person i interesuar mund të ndërmarrë këta hapa.

Neni 32

Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve të anëtarit që largohet

Kur një anëtar pushon së qeni pjesë e grupimit për çfarëdo arsye tjetër, përveç transferimit të të drejtave të tij, në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 22 të këtij ligji, vlera e të drejtave dhe detyrimeve të tij përcaktohet duke marrë parasysh aktivet dhe pasivet e grupimit në datën kur ai pushon së qeni pjesë e tij. Vlera e të drejtave dhe detyrimeve të anëtarit që largohet nuk mund të përcaktohen paraprakisht.

Neni 33

Përgjegjësia e anëtarit të larguar për detyrimet e mëparshme

Pa cenuar pikën 1, të nenit 37 të këtij ligji, çdo anëtar që pushon së qeni pjesë e grupimit do të mbetet përgjegjës, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, për detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e grupimit para se ai të pushonte së qeni anëtar.

Neni 34

Likuidimi i grupimit

1. Mbyllja e grupimit sjell likuidimin e tij.

2. Likuidimi i grupimit dhe përfundimi i likuidimit të tij do të rregullohen sipas dispozitave të zbatueshme për likuidimin e shoqërive kolektive.

3. Grupimi do të ruajë aftësinë e tij, në kuptimin e pikës 2, të nenit 1 të këtij ligji, derisa të përfundojë likuidimi i tij.

4. Likuidatori ose likuidatorët do të ndërmarrin hapat e parashikuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 35

Likuidimi vullnetar dhe falimentimi i grupimit

Grupimet do t'u nënshtrohen ligjeve shqiptare që rregullojnë likuidimin vullnetar, falimentimin dhe pagesat e vonuara. Fillimi i procedurave kundër grupimit për arsye të falimentimit ose rikuperimit të pagesave nuk do të shkaktojë vetvetiu fillimin e procedurave të tilla kundër anëtarëve të tij.



Neni 36

Afatet e parashkrimit për kërkesat ndaj ish-anëtarëve

1. Një afat parashkrimi prej 5 vjetësh nga data e publikimit, sipas nenit 8 të këtij ligji, të njoftimit të largimit të anëtarit nga grupimi prevalon ndaj çdo afati më të gjatë, të parashikuar në ligjin shqiptar, për veprimet gjyqësore kundër këtij anëtar, që lidhen me borxhe dhe detyrime të lindura përpara largimit të tij.

2. Një afat 5-vjeçar nga data e publikimit të përfundimit të likuidimit të grupimit zëvendëson çdo afat më të gjatë për ndjekje të veprimeve ndaj një anëtar për detyrime të lindura gjatë ekzistencës së grupimit.

Neni 37

Masat administrative për shkeljet e ligjit

1. Nëse grupimi zhvillon veprimtari në kundërshtim me këtë ligj, ministria përgjegjëse për ekonominë, vetë ose nëpërmjet ndonjë agjencie të autorizuar prej saj, mund të ushtrojë të drejtën për t'i kërkuar gjykatës mbylljen e grupimit, sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj. Për shkelje të kërkesave administrative të parashikuara në këtë ligj zbatohen sanksionet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

2. Grupimi dhe anëtarët e tij kanë të drejtë të bëjnë ankim ndaj vendimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 38

Regjistri, rregullat e regjistrimit dhe sanksionet

1. QKB-ja do të jetë institucioni përgjegjës për kryerjen e regjistrimit të referuar në nenet 6 dhe 10 të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton rregullat e posaçme për regjistrimin e grupeve në regjistrin tregtar të QKB-së, duke përcaktuar kushtet dhe mënyrën e depozitimit të dokumenteve të referuara në nenet 7 dhe 10 të këtij ligji. Rregullat duhet të sigurojnë që dokumentet dhe të dhënat e referuara në nenin 8 të këtij ligji të publikohen në QKB, duke parashikuar mënyrën e publikimit të dokumenteve dhe të dhënave të referuara në shkronjën “c”, të nenit 8 të këtij ligji. Të dhënat e regjistrimit tregtar për grupimet aksesohen lirisht nga

cilido, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji ose, kur është e përshtatshme, me nenin 10 të këtij ligji.

3. Informacioni që publikohet në gazetën zyrtare të komuniteteve evropiane, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, duhet t'i përcillet zyrës për publikime zyrtare të komuniteteve evropiane brenda një muaji nga publikimi i tij në QKB.

4. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve për depozitimin ose publikimin e dokumenteve, sipas neneve 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, çdo person juridik ose fizik, përgjegjës për grupimin, do të gjobotet nga QKB-ja në vlerën 50 000 deri në 200 000 lekë për çdo shkelje. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara në nenin 25 të këtij ligji për përfshirjen e të dhënave në dokumentet zyrtare të grupimit, gjoba do të jetë nga 30 000 deri në 100 000 lekë.

5. Për shkelje të përsëritura ose të qëllimshme, masat shtesë, përfshirë pezullimin e regjistrimit ose kërkesën për shpërbërjen e grupimit, mund të vendosen vetëm nëpërmjet gjykatës.

Neni 39

Tatimi

1. Fitimet ose humbjet që rezultojnë nga veprimtaria e grupimit do të konsiderohen si të lindura drejtpërdrejt për anëtarët e tij dhe do të jenë objekt tatimi drejtpërdrejt për ta, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

2. Në rastet kur anëtarë janë subjekt jorezident, grupimi vepron si agjent i mbajtjes në burim të tatimit mbi pjesën e fitimit që i takon këtij anëtar, përveçse kur vërtetohet se tatimi është paguar rregullisht në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian për atë vit fiskal.

3. Në rast se tatimi mbahet në burim nga grupimi dhe më pas anëtarë paraqet dokumentacionin provues, ai ka të drejtën e rimbursimit ose kreditimit të tatimit të paguar sipas procedurave të parashikuara në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 40

Njoftimi i Komisionit Evropian për kategoritë e personave të ndaluar të marrin pjesë në grupe

QKB-ja do të informojë Komisionin Evropian për kategoritë e personave fizikë dhe juridikë të



cilëve u është ndaluar pjesëmarrja në grupime, në përputhje me pikën 4, të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 41

Aktet nënligjore dhe afatet për zbatimin e ligjit

1. Procedurat e hollësishme për deklarimin, trajtimin dhe shkëmbimin e të dhënave të detyrueshme, sipas legjislacionit tatumor të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të punës dhe atij të statistikave, si dhe miratimi i procedurës së lëshimit të numrit unik të identifikimit të grupimeve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozim të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe financën, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e titullarit të QKB-së, miraton udhëzimin për formën dhe përmbajtjen e dokumenteve që lëshohen nga QKB-ja dhe formatet e kthimit të përgjigjes për çdo veprim të kryer, sipas këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të miratojë procedurat e hollësishme për hedhjen dhe formën e hedhjes, si dhe shfaqjen në regjistër të grupimeve, sipas përcaktimeve në ligjin për regjistrimin e biznesit dhe të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 461, datë 31.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 461, datë 31.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 76/2026, “Për grupimet ekonomike me interes evropian”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 77/2026

**PËR SHOQËRITË EVROPIANE TË
BASHKËPUNIMIT (SHEB)²**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për themelimin, regjistrimin, organizimin e brendshëm, funksionimin, administrimin, ristrukturimin dhe prishjen e shoqërive evropiane të bashkëpunimit, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtat e detyrimet e anëtarëve të tyre.

² Ky ligj është përafuar plotësisht me Rregulloren (KE) nr. 1435/2003, të Këshillit, datë 18 gusht 2003, “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB)”, e ndryshuar. Numri CELEX Faqe | 17802

32003R1435, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 207, datë 18.03.2003, faqe 1–24.



Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për shoqëritë evropiane të bashkëpunimit, që themelohen e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Forma e shoqërisë evropiane të bashkëpunimit

1. Një shoqëri evropiane bashkëpunimi mund të themelohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në formën e një shoqërie evropiane të bashkëpunimit (në vijim SHEB) sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.

2. Kapitali i nënshkruar i një SHEB-i ndahet në kuota.

3. Numri i anëtarëve dhe kapitali i një SHEB-i janë të ndryshueshëm.

4. Me përjashtim të rasteve kur statuti i SHEB-it parashikon ndryshe, anëtarët e një SHEB-i do të mbajnë përgjegjësi deri në vlerën e kontributit të nënshkruar prej tyre.

5. Në rastet kur anëtarët e SHEB-it kanë përgjegjësi të kufizuar, emri i SHEB-it do të pasohet nga fjalët “me përgjegjësi të kufizuar”.

6. SHEB-i ka për qëllim kryesor përmbushjen e nevojave të anëtarëve të saj dhe/ose zhvillimin e veprimtarive të tyre ekonomike e sociale, veçanërisht nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve për furnizim me mallra ose shërbime apo për kryerjen e punëve, si dhe përmes nxitjes së pjesëmarrjes së anëtarëve në veprimtari ekonomike të zhvilluara nga një ose më shumë SHEB-e dhe/ose shoqëri bashkëpunimi të themeluara në Republikën e Shqipërisë.

7. Një SHEB mund të zhvillojë aktivitetet e tij nëpërmjet një filiali.

8. Një SHEB nuk mund të ofrojë përfitimet e aktiviteteve të tij për subjekte joanëtare dhe as të lejojë pjesëmarrjen e tyre në veprimtarinë e saj, me përjashtim të rasteve kur statuti i saj parashikon ndryshe.

9. Një SHEB ka personalitet juridik.

10. Përfshirja e punonjësve në SHEB rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e punës dhe të marrëveshjeve kolektive.

Neni 4
Themelimi

Një SHEB me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të themelohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nga jo më pak se 5 persona fizikë, prej të cilëve të paktën njëri është rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një tjetër është rezident në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

b) nga jo më pak se 5 persona, përfshirë persona fizikë dhe persona juridikë të rregulluar nga e drejta publike ose private, të themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

c) nga persona juridikë të themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian e që rregullohen përkatësisht nga legjislacioni i këtyre dy shteteve të ndryshme;

ç) nga një bashkim ndërmjet shoqërive të bashkëpunimit të themeluara sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, me seli dhe zyrë qendrore brenda territorit të Bashkimit Evropian;

d) nëpërmjet shndërrimit të një shoqërie bashkëpunimi të themeluar në Republikën e Shqipërisë, që ka pasur për të paktën 2 vjet një degë të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

Neni 5
Kapitali minimal

1. Kapitali i një SHEB-i shprehet në monedhën kombëtare. Megjithatë, një SHEB mund të shprehë kapitalin e tij në euro.

2. Kapitali i nënshkruar nuk duhet të jetë më pak se 30 000 (tridhjetë mijë) euro ose ekuivalenti në lekë në datën e themelimit.

3. Statuti i SHEB-it parashikon shumën nën të cilën kapitali i nënshkruar nuk mund të zvogëlohet si pasojë e shlyerjes së kuotave të anëtarëve, që largohen nga SHEB-i. Kjo shumë nuk mund të jetë më e vogël se shuma e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Afati i përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji, sipas të cilit anëtarët që largohen nga SHEB-



i kanë të drejtë për pagesë për pjesën e tij në kapitalin e nënshkruar, do të pezullohet për sa kohë që shlyerja do të ulte kapitalin e nënshkruar nën kufirin e përcaktuar.

4. Kapitali i SHEB-it mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të reja nga anëtarët ekzistues ose nëpërmjet pranimi të anëtarëve të rinj. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet shlyerjes së plotë ose të pjesshme të kuotave të nënshkruara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me statutin e SHEB-it.

5. Ndryshimet e kapitalit në përputhje me dispozitat e këtij ligji nuk përbëjnë ndryshim të statutit e nuk kërkojnë publikim apo regjistrim të veçantë pranë regjistrimit tregtar.

Neni 6

Kapitali i SHEB-it

1. Kapitali i nënshkruar i një SHEB-i përfaqësohet nga kuotat e anëtarëve, të shprehura në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të emetojë më shumë se një kategori kuotash.

2. Statuti mund të parashikojë që kategori të ndryshme kuotash të japin të drejta të ndryshme, në lidhje me shpërndarjen e fitimit. Kuotat që u japin anëtarëve të drejta të njëjta do të përbëjnë një klasë.

3. Kapitali mund të përbëhet vetëm nga kontribute që kanë vlerë të matshme ekonomikisht. Kontributet e anëtarëve nuk mund të jenë në punë apo në shërbime.

4. Kuotat do të mbahen nga anëtarë nominalisht të përcaktuar. Statuti duhet të përcaktojë se kuotat e së njëjtës klasë kanë vlerë nominale të njëjtë. Kuotat nuk mund të emetohen me një çmim më të ulët se vlera e tyre nominale.

5. Kuotat e fituara kundrejt kontributit në para duhet të shlyhen në masën jo më pak se 25 për qind të vlerës së tyre nominale në momentin e nënshkrimit. Pjesa e mbetur shlyhet brenda një afati prej 5 vjetësh nga data e nënshkrimit, me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një afat më të shkurtër.

6. Kuotat e fituara kundrejt kontributit në natyrë duhet të shlyhen plotësisht në momentin e nënshkrimit.

7. Për vlerësimin e kontributeve në natyrë zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit

shqiptar, që rregullojnë emërimin e audituesit dhe procedurat e vlerësimit për shoqëritë aksionare.

8. Statuti përcakton numrin minimal të kuotave që duhet të nënshkruhen me qëllim anëtarësimin në një SHEB. Statuti nuk mund të përmbajë dispozita që kushtëzojnë pranimin si anëtar me zotërimin e më shumë se një kuote në rastet kur parashikon që shumica e anëtarëve në asamblenë e përgjithshme duhet të jenë persona fizikë dhe kur përmban kushte të veçanta për pjesëmarrjen e anëtarëve në veprimtaritë e SHEB-it përmes zotërimit të kuotave.

9. Kur shqyrton pasqyrat financiare për vitin financiar, mbledhja e asamblesë së përgjithshme vjetore, me anë të një vendimi, konstaton shumën e kapitalit në fund të vitit financiar, si dhe ndryshimin e tij në krahasim me vitin financiar të mëparshëm.

Me propozimin e organit administrativ ose drejtues, kapitali i nënshkruar mund të zmadhohet nëpërmjet kapitalizimit të të gjithë ose një pjese të rezervave të disponueshme për shpërndarje, me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me kërkesat për kuorum dhe shumicë të parashikuara për ndryshimin e statutit. Kuotat e reja ndahen ndërmjet anëtarëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin ekzistues.

10. Vlera nominale e kuotave mund të zmadhohet duke bashkuar kuotat ekzistuese. Në rastet kur një zmadhim i tillë kërkon kontribut shtesë nga anëtarët, në përputhje me dispozitat e statutit, vendimi merret nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme sipas kërkesave të kuorumit dhe shumicës së nevojshme për ndryshimin e statutit.

11. Vlera nominale e kuotave mund të zvogëlohet duke i ndarë kuotat ekzistuese.

12. Në përputhje me statutin e me vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme ose organi drejtues ose administrativ, kuotat mund t'i transferohen ose t'i shiten një anëtar ose kujt do që anëtarësohet.

13. Një SHEB nuk lejohet të nënshkruajë kuotat e veta, t'i blejë ato apo t'i pranojë si garanci, as drejtpërdrejt dhe as nëpërmjet një personi që vepron në emrin e tij, por për llogari të SHEB-it. Megjithatë, kuotat e një SHEB-i mund të pranohen si garanci në transaksionet e zakonshme të institucioneve të kredisë së SHEB-it.

**Neni 7
Statuti**

1. Për qëllimet e këtij ligji, statuti i një SHEB-i nënkupton aktin e themelimit dhe, kur hartohet si dokument më vete, statutin e SHEB-it.

2. Anëtarët themelues hartojnë statutin e SHEB-it me seli në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Statuti hartohet me shkrim e nënshkruhet nga anëtarët themelues.

3. Dispozitat për themelimin e shoqërive aksionare në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen edhe për themelimin e SHEB-it me seli në Republikën e Shqipërisë.

4. Statuti i SHEB-it duhet të përfshijë të paktën:

a) emrin e SHEB-it, të paraprirë ose të ndjekur nga shkurtesa “SHEB” dhe, sipas rastit, fjala “i kufizuar”;

b) objektin e aktivitetit;

c) emrat e personave fizikë dhe juridikë, që janë anëtarë themelues të SHEB-it, duke treguar veprimtaritë dhe selitë e tyre;

ç) adresën e selisë së SHEB-it;

d) kushtet e procedurat për pranimin, përjashtimin dhe dorëheqjen e anëtarëve;

dh) të drejtat e detyrimit e anëtarëve dhe kategoritë e ndryshme të anëtarëve, nëse ka, dhe të drejtat e detyrimit e anëtarëve në secilën kategori;

e) vlerën nominale të kuotave të nënshkruara, shumën e kapitalit të nënshkruar dhe një tregues se kapitali është i ndryshueshëm;

ë) rregulla të veçanta lidhur me shumën që, sipas rastit, duhet t’i kalojë rezervës ligjore;

f) kompetencat e përgjegjësitë e anëtarëve të secilit prej organeve drejtuese;

g) dispozitat që rregullojnë emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese;

gj) kërkesat për shumicë dhe kuorum;

h) kohëzgjatjen e ekzistencës së shoqërisë, kur është me kohëzgjatje të kufizuar.

**Neni 8
Selia**

Selia e regjistruar e një SHEB-i në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në statutin e saj.

**Neni 9
Transferimi i selisë**

1. Selia e një SHEB-i mund të transferohet në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, në përputhje me pikat 2 deri në 15 të këtij neni. Një transferim i tillë nuk sjell likuidimin e shoqërisë dhe as krijimin e një personi të ri juridik.

2. Organi drejtues ose administrues harton një propozim transferimi dhe e publikon atë në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Ky propozim duhet të tregojë emrin aktual, selinë dhe numrin e SHEB-it e do të përfshijë:

a) selinë e propozuar të SHEB-it;

b) statutin e SHEB-it, duke përfshirë, sipas rastit, emrin e saj të ri;

c) afatin kohor të propozuar për transferimin;

ç) çdo ndikim që transferimi mund të ketë në përfshirjen e punëmarrësve;

d) çdo të drejtë të parashikuar për mbrojtjen e anëtarëve, kreditorëve dhe zotëruesve të të drejtave të tjera.

3. Organi drejtues ose administrues harton një raport që shpjegon e justifikon aspektet ligjore dhe ekonomike, si dhe efektet e transferimit në punësim, dhe shpjegon pasojat e transferimit për anëtarët, kreditorët, punëmarrësit dhe zotëruesit e të drejtave të tjera.

4. Anëtarët, kreditorët dhe zotëruesit e të drejtave të tjera të një SHEB-i, si dhe çdo organ tjetër, që sipas ligjit mund ta ushtrojë këtë të drejtë, kanë të drejtë të paktën 1 muaj para mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për të vendosur për transferimin, të shqyrtojnë në selinë e SHEB-it propozimin e transferimit dhe raportin e hartuar sipas pikës 3 të këtij neni dhe, me kërkesë, të marrin kopje të këtyre dokumenteve pa pagesë.

5. Çdo anëtar që kundërshton vendimin e transferimit në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme ose në një mbledhje sektoriale ose të seksionit mund të paraqesë dorëheqjen e tij/saj brenda 2 muajve nga vendimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme. Anëtarësimi përfundon në fund të vitit financiar në të cilin është paraqitur dorëheqja; transferimi nuk hyn në fuqi në lidhje me atë anëtar. Dorëheqja i jep anëtarit të drejtën për shlyerjen e kuotave sipas kushteve të përcaktuara në nenet 5, pika 3, e 17 të këtij ligji.



6. Vendimi për transferim nuk mund të miratohet brenda 2 muajve pas publikimit të propozimit. Një vendim i tillë merret në përputhje me parashikimet e pikave 3 dhe 4, të nenit 62 të këtij ligji.

7. Para se autoriteti kompetent të lëshojë certifikatën e përmendur në pikën 8 të këtij neni, SHEB-i duhet t'i sigurojë atij që për çdo detyrim që lind para publikimit të propozimit të transferimit, interesat e kreditorëve dhe të zotëruesve të të drejtave të tjera lidhur me SHEB-in (përfshirë organet publike) janë mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ligji i zbatueshëm.

8. Noteri lëshon një certifikatë, e cila vërteton përfundimin e veprimeve dhe të formaliteteve, që duhen kryer para transferimit.

9. Transferimi i selisë nuk prodhon efekte deri në paraqitjen e certifikatës së përmendur në pikën 8 të këtij neni dhe të dokumentacionit, që provon përmbushjen e formaliteteve të kërkuara sipas legjislacionit të shtetit pritës.

10. Transferimi i selisë së një SHEB-i dhe ndryshimi i statutit të saj prodhojnë efekte nga data në të cilën bëhet efektiv regjistrimi i SHEB-it në shtetin e ri të selisë, në përputhje me pikën 1, të nenit 13 të këtij ligji.

11. Fshirja e regjistrimit në regjistrin tregtar shqiptar bëhet vetëm pas marrjes së njoftimit nga organi shtetëror, që administron regjistrin në vendin e regjistrimit të ri.

12. Regjistrimi i ri dhe fshirja e regjistrimit të vjetër do të publikohen në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

13. Pas publikimit të regjistrimit të selisë së re të një SHEB-i, kjo seli mund të përdoret në marrëdhëniet me palët e treta. Deri në publikimin e fshirjes së regjistrimit nga regjistri tregtar në Shqipëri, kjo e fundit konsiderohet ende e vlefshme në marrëdhënie me palët e treta, përveç rasteve kur shoqëria provon se palët kanë qenë në dijeni të selisë së re.

Nëse SHEB-i ushtron veprimtari, që i nënshtrohet mbikëqyrjes financiare sipas legjislacionit shqiptar, e drejta për të kundërshtuar transferimin e selisë i njihet edhe autoritetit kompetent mbikëqyrës.

Transferimi i selisë mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor.

14. Një SHEB nuk mund të transferojë selinë e tij nëse ndaj tij kanë nisur procedura likuidimi, duke përfshirë likuidimin vullnetar, falimentimin ose procedura të tjera të ngjashme.

15. Një SHEB që e ka transferuar selinë nga Shqipëria në një shtet anëtar konsiderohet, për çdo veprim juridik të lindur para transferimit, sikur ta ketë ende selinë në Shqipëri, edhe nëse ajo paditet pas kryerjes së transferimit.

Neni 10

Ligji i zbatueshëm

Një SHEB do të rregullohet:

a) nga ky ligj;

b) kur autorizohet shprehimisht nga ky ligj, nga dispozitat e statutit të saj;

Për çështjet që nuk rregullohen nga ky ligj ose për çështje që rregullohen vetëm pjesërisht nga ky ligj do të zbatohen:

i. aktet ligjore e nënligjore të miratuara nga Republika e Shqipërisë për zbatimin e masave të komunitetit evropian, që lidhen posaçërisht me SHEB-et;

ii. aktet ligjore e nënligjore, që zbatohen për një shoqëri bashkëpunimi të themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;

iii. dispozitat e statutit të saj në të njëjtën mënyrë sikurse zbatohen për një shoqëri bashkëpunimi të themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Parimi i mosdiskriminimit

Në përputhje me këtë ligj, një SHEB me seli në Republikën e Shqipërisë trajtohet si një shoqëri bashkëpunimi vendase.

Neni 12

Të dhënat e detyrueshme për regjistrim

1. Dispozitat që rregullojnë të dhënat e detyrueshme për regjistrim për shoqëritë aksionare zbatohen edhe për SHEB-in. Emri i SHEB-it duhet të paraprihet ose të pasohet nga shkurtesa "SHEB" dhe, kur është e nevojshme, edhe nga fjala "e kufizuar".



2. Vetëm SHEB-et mund të përfshijnë shkurtesa “SHEB” para ose pas emrit të tyre për të përcaktuar formën e tyre ligjore.

Neni 13

Kërkesat e regjistrimit e të deklarimit

1. Çdo SHEB regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

2. Një SHEB nuk mund të regjistrohet nëse nuk është arritur një marrëveshje mbi parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve, në përputhje me rregullat e pjesëmarrjes së punëmarrësve, sipas pikës 10, të nenit 3 të këtij ligji.

3. Për qëllime regjistrimi të një SHEB-i të themeluar nëpërmjet bashkimit, në rastet kur parashikohet pjesëmarrja e punëmarrësve në drejtim apo mbikëqyrje, duhet të jetë lidhur më parë një marrëveshje e posaçme mbi përfshirjen e punëmarrësve në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, asnjëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim nuk duhet të ketë qenë subjekt i rregullave për pjesëmarrjen e punëmarrësve në organet drejtuese apo mbikëqyrëse para regjistrimit të SHEB-it.

4. Statuti i SHEB-it nuk mund të jetë në kundërshtim me parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve, të përcaktuara sipas marrëveshjes përkatëse. Në rast se këto parashikime ndryshojnë dhe bien në kundërshtim me dispozitat e statutit, ky i fundit duhet të ndryshohet për të reflektuar përfshirjen e punëmarrësve.

5. Për qëllime të publikimit të të dhënave dhe dokumenteve, SHEB-i u nënshtrohet rregullave të parashikuara për shoqëritë aksionare në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 14

Publikimi i dokumentacionit

1. Dokumentet dhe të dhënat e SHEB-it publikohen sipas mënyrës së parashikuar në ligjin për regjistrimin e bizneseve për subjektet me

formë juridike të ngjashme me shoqëritë aksionare.

2. Për degët e një SHEB-i të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur selia e saj ndodhet në një shtet tjetër anëtar, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar që rregullojnë regjistrimin dhe publikimin e të dhënave për degët e shoqërive të huaja. Këshilli i Ministrave mund të miratojë rregulla të veçanta për regjistrimin e SHEB-eve, në përputhje me veçoritë e organizimit e të funksionimit të shoqërive të bashkëpunimit.

Neni 15

Fitimi i anëtarësisë

1. Me përjashtim të rasteve kur anëtarësia rrjedh si pasojë e bashkimit të shoqërive të bashkëpunimit sipas këtij ligji, pranimi si anëtar në një SHEB i nënshtrohet miratimit nga organi drejtues ose i administrimit. Kërkuesit, kërkesa e të cilëve për anëtarësim është refuzuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë për shqyrtim në mbledhjen e radhës së asamblesë së përgjithshme.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, anëtarësimi në një SHEB mund të fitohet nga persona fizikë ose persona juridikë.

2. Statuti i SHEB-it mund të parashikojë kushte të veçanta për pranimin si anëtar, në veçanti:

a) zotërimin e një vlere minimale kuotash në kapitalin e shoqërisë së bashkëpunimit;

b) përputhshmërinë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

3. Nëse parashikohet nga statuti, anëtarëve mund t'u kërkohej të nënshkruajnë kuota shtesë në kapitalin e shoqërisë së bashkëpunimit.

4. SHEB-i mban në selinë e saj një listë të anëtarëve, të renditur në mënyrë alfabetike, e cila përmban të dhënat identifikuese, adresat e tyre, si dhe numrin e klasën e kuotave që ata zotërojnë, sipas rastit.

Çdo person me interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm ka të drejtë të kërkojë të njihet me listën dhe të marrë një kopje të saj, të plotë ose të pjesshme, kundrejt një tarife, që nuk tejkalon kostot administrative.

5. Çdo transaksion që ndikon në mënyrën e caktimit, shpërndarjes, rritjes ose zvogëlimit të kapitalit duhet të regjistrohet në regjistrin e



anëtarëve, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, brenda një muaji nga data e ndryshimit.

6. Transaksionet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni nuk sjellin efekte ndaj SHEB-it apo ndaj palëve të treta me interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm, përpara se të jenë regjistruar në regjistrin e anëtarëve sipas pikës 4 të këtij neni.

7. Me kërkesë të anëtarit, shoqëria e bashkëpunimit lëshon një vërtetim me shkrim, që dëshmon se ndryshimi është regjistruar.

Neni 16

Humbja e anëtarësisë

1. Anëtarësia në një SHEB përfundon:

- a) me dorëheqje;
- b) me përjashtim kur anëtari ka kryer një shkelje të rëndë të detyrimeve të tij ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e SHEB-it;
- c) kur parashikohet nga statuti, pas transferimit të të gjitha pjesëve takuese që zotëron te një anëtar tjetër ose te një person fizik apo juridik, që ka fituar anëtarësimin;
- ç) me prishje (likuidim) nëse anëtari është person juridik;
- d) me nisjen e procedurës së falimentimit;
- dh) me vdekjen e anëtarit;
- e) në çdo rast tjetër të përcaktuar në statutin e shoqërisë ose në ligjin e zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit.

2. Çdo anëtar i pakicës, që ka kundërshtuar në asamblenë e përgjithshme një ndryshim të statutit, me të cilin:

- a) janë vendosur detyrime të reja për pagesa ose shërbime të tjera;
 - b) janë zgjeruar ndjeshëm detyrimet ekzistuese të anëtarëve; ose
 - c) është zgjatur periudha e njoftimit për dorëheqje në më shumë se 5 vjet,
- ka të drejtë të paraqesë dorëheqjen brenda 2 muajve nga data e miratimit të vendimit nga asambleja e përgjithshme.

Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, anëtarësimi përfundon në mbyllje të vitit financiar në të cilin është paraqitur dorëheqja.

Në rastin e parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike, anëtarësimi përfundon me përfundimin e periudhës së njoftimit që ishte në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit të statutit. Ky ndryshim statuti nuk prodhon efekt ndaj anëtarit në fjalë.

3. Dorëheqja i jep anëtarit të drejtën për shlyerjen e pjesëve takuese, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 5, pika 3, dhe nenin 17 të këtij ligji.

4. Vendimi për përjashtimin e një anëtari merret nga organi drejtues ose administrativ, pasi anëtarit t'i jetë dhënë mundësia të shprehet. Kundër këtij vendimi anëtari ka të drejtë të paraqesë ankim në asamblenë e përgjithshme.

Neni 17

Të drejtat financiare të anëtarëve në rast të dorëheqjes ose të përjashtimit

1. Me përjashtim të rasteve kur transferohen kuotat dhe në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, humbja e anëtarësisë i jep të drejtë anëtarit për t'u paguar për pjesën e tij në kapitalin e nënshkruar, të reduktuar proporcionalisht me çdo humbje, që është ngarkuar mbi kapitalin e SHEB-it.

2. Shumat që zbriten sipas pikës 1 të këtij neni përlogariten duke u bazuar në pasqyrat financiare për vitin financiar në të cilin ka lindur e drejta për rimbursim.

3. Statuti përcakton procedurat dhe kushtet për ushtrimin e së drejtës së dorëheqjes, si dhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet rimbursimi, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Në çdo rast, SHEB-i nuk është e detyruar të realizojë rimbursimin përpara se të kenë kaluar 6 muaj nga miratimi i pasqyrave financiare pas humbjes së anëtarësisë.

4. Pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen, gjithashtu, edhe në rastet kur rimbursimi i kuotave i referohet vetëm një pjese të pjesëmarrjes së anëtarit në kapital.

KREU II THEMELIMI

SEKSIONI 1 PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 18

Ligji i zbatueshëm për themelimin

1. Themelimi i një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë u nënshtrohet ligjeve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Regjistrimi i një SHEB-i bëhet publik në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.



Neni 19

Personaliteti juridik

1. Një SHEB fiton personalitetin juridik në ditën e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji.

2. Në rast se përpara regjistrimit të një SHEB-i janë kryer veprime në emër të tij dhe SHEB-i kundërshton detyrimet që rrjedhin nga këto veprime pas regjistrimit të saj, personat fizikë, shoqëritë, sipërmarrjet ose entitetet e tjera ligjore, që i kanë kryer këto veprime, do të jenë përgjegjëse solidarisht dhe individualisht, pa kufizim, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe me marrëveshje.

SEKSIONI 2

THEMELIMI NËPËRMJET BASHKIMIT

Neni 20

Procedurat për themelimin nëpërmjet bashkimit

1. Një SHEB mund të themelohet nëpërmjet një bashkimi të kryer, sipas:

- a) procedurës së bashkimit me përthithje;
- b) procedurës së bashkimit nëpërmjet krijimit të një personi të ri juridik.

2. Në rastin e bashkimit me përthithje, shoqëria e bashkëpunimit përthithëse merr formën e një SHEB-i në momentin e realizimit të bashkimit. Në rastin e bashkimit nëpërmjet krijimit të një personi të ri juridik, ky i fundit merr formën e një SHEB-i.

Neni 21

Ligji i zbatueshëm në rastin e bashkimit

Për çështjet që nuk rregullohen nga ky seksion ose kur ato rregullohen vetëm pjesërisht dhe për aspektet që nuk janë të mbuluara prej tij, çdo subjekt që merr pjesë në themelimin e një SHEB-i nëpërmjet bashkimit u nënshtrohet dispozitave të pjesës IX, “Për riorganizimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive anonime”, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Neni 22

Kundërshtimi i bashkimit për arsye të interesit publik

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë, pas konsultimit me institucionet rregullatore sipas fushës së veprimtarisë, mund të kundërshtojë pjesëmarrjen e një shoqërie bashkëpunimi në formimin e një SHEB-i me anë të bashkimit nëse vlerëson se ky bashkim cenon interesin publik.

2. Për efekt të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, ministria udhëzon Qendrën Kombëtare të Biznesit që të pezullojë lëshimin e vërtetimit të ligjshmërisë përpara bashkimit.

3. Kundërshtimi i ministrisë duhet të jetë i arsyetuar dhe ndaj tij mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente administrative.

Neni 23

Projekt marrëveshja e bashkimit

1. Organet drejtuese ose të administrimit të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim hartojnë në bashkëpunim projekt marrëveshjen e bashkimit. Kjo projekt marrëveshje përmban të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe selinë e shoqërive të bashkëpunimit që marrin pjesë në bashkim, si dhe emrin e selinë e propozuar për SHEB-in që do të krijohet;

b) raportin e këmbimit të kapitalit të nënshkruar në kuota dhe shumën e çdo kontributi shtesë në para; në rastet kur nuk ka kuota, ndarjen e saktë të aktiveve dhe vlerën e tyre të barasvlershme në kuotë;

c) rregullat për alokimin e kuotave në SHEB;

ç) datën nga e cila zotërimi i kuotave në SHEB i jep zotëruesit të drejtën për të përfituar nga shpërndarja e fitimit, si dhe çdo kusht të veçantë që ndikon në këtë të drejtë;

d) datën nga e cila veprimet tregtare të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim do të konsiderohen, për qëllime kontabël, si veprime të SHEB-it;

dh) kushtet ose përfitimet e veçanta që lidhen me instrumente financiare, të ndryshme nga kuotat, të cilat nuk i japin mbajtësit të drejtën për t'u bërë anëtar i SHEB-it, sipas përcaktimeve të nenit 65 të këtij ligji;



e) të drejtat që SHEB-i u jep zotëruesve të kuotave me të drejta të veçanta dhe zotëruesve të instrumenteve të tjera financiare përveç kuotave ose masat e propozuara në lidhje me to;

ë) masat për mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve të shoqërive të bashkëpunimit, pjesëmarrëse në bashkim;

f) çdo përfitim i veçantë i dhënë ekspertëve, që shqyrtojnë projekt marrëveshjen e bashkimit ose anëtarëve të organeve drejtuese, administrative, mbikëqyrëse apo kontrolluese të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim;

g) statutin e propozuar të SHEB-it;

gj) informacionin për procedurat për përcaktimin e rregullimeve për përfshirjen e punëmarrësve, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim mund të përfshijnë edhe elemente të tjera në projekt marrëveshjen e bashkimit.

3. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, që synojnë krijimin e një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Arsyetimi i projekt marrëveshjes së bashkimit

Organet administrative ose drejtuese të secilës shoqëri bashkëpunimi që bashkohet hartojnë një raport të detajuar me shkrim, që shpjegon e justifikon projekt kushtet e bashkimit nga një këndvështrim ligjor dhe ekonomik e, në veçanti, raportin e këmbimit të kuotave. Raporti duhet të tregojë, gjithashtu, çdo vështirësi të veçantë vlerësimi.

Neni 25

Publikimi

1. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme edhe në lidhje me kërkesat e regjistrimit e publikimit për shoqëritë e bashkëpunimit, që u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

2. Publikimi i projekt marrëveshjes së bashkimit në regjistrin tregtar përfshin të paktën elementet e mëposhtme për secilën nga shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim:

a) llojin, emrin dhe selinë e secilës shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim;

b) adresën e vendit ose regjistrin në të cilin depozitohen statuti dhe të gjitha dokumentet dhe detajet e tjera, në lidhje me secilën shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim dhe numri i regjistrimit në atë regjistr;

c) informacion për të drejtat dhe masat mbrojtëse të kreditorëve të shoqërisë së bashkëpunimit, të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, si dhe adresën ku mund të merret pa pagesë informacioni i plotë mbi to;

ç) informacion për të drejtat dhe masat mbrojtëse të anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit, sipas parashikimeve përkatëse të legjislacionit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit, si dhe adresën ku mund të merret pa pagesë informacioni i plotë mbi to;

d) emrin dhe selinë e propozuar për SHEB-in; dh) kushtet që përcaktojnë datën kur bashkimi do të hyjë në fuqi sipas nenit 32 të këtij ligji.

Neni 26

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo anëtar ka të drejtë që, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, ku do të merret vendim për bashkimin, të njihet me dokumentet e mëposhtme në selinë e shoqërisë së bashkëpunimit:

a) projekt marrëveshjen e bashkimit;

b) pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e organeve drejtuese të shoqërive të bashkëpunimit, që marrin pjesë në bashkim, për tre vjetët financiarë të fundit;

c) raportin e audituesit, në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

ç) raportin e audituesit mbi vlerën e kuotave që do të shpërndahen në këmbim të aseteve për shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim ose raportin e vlerësimit të kuotave, siç parashikohet në nenin 27 të këtij ligji;



d) raportin e arsyetimit të kushteve të projekt marrëveshjes së bashkimit, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

2. Një kopje e plotë e dokumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni ose një ekstrakt i tyre mund të merret me kërkesë të çdo anëtarit pa pagesë.

Neni 27

Raporti i audituesit

1. Secila shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim emëron një ose më shumë auditues, në përputhje me dispozitat e pikës 7, të nenit 6 të këtij ligji, për shqyrtimin e projekt marrëveshjes së bashkimit dhe hartimin e një raporti në formë të shkruar për anëtarët.

2. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, që synojnë krijimin e një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Miratimi i projekt marrëveshjes së bashkimit

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të secilës prej shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen miraton projekt marrëveshjen e bashkimit.

2. Përfshirja e punëmarrësve në SHEB rregullohet me ligj të posaçëm. Asambleja e përgjithshme e secilës prej shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim rezervon të drejtën që të kushtëzojë regjistrimin e SHEB-it me miratimin e shprehur të marrëveshjes për përfshirjen e punëmarrësve.

Neni 29

Ligji i zbatueshëm për themelimin nëpërmjet bashkimit

Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, në lidhje me mbrojtjen e interesave të:

a) kreditorëve të shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen;

b) zotëruesve të obligacioneve në shoqëritë e bashkëpunimit që bashkohen.

Neni 30

Shqyrtimi i procedurës së bashkimit

1. Ligjshmëria e procedurës së një bashkimi shqyrtohet në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin e biznesit.

2. Noteri lëshon një vërtetim për përfundimin e veprimeve dhe të formaliteteve para bashkimit.

Neni 31

Shqyrtimi i ligjshmërisë së bashkimit

1. Ligjshmëria e një bashkimi për pjesën e procedurës që ka të bëjë me realizimin e bashkimit dhe themelimin e SHEB-it, shqyrtohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si edhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin e biznesit.

2. Për këtë qëllim, çdo shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim duhet t'i paraqesë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentin e përmendur në pikën 2, të nenit 30 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga lëshimi i tij, së bashku me një kopje të projekt marrëveshjes së bashkimit të miratuar nga shoqëria e bashkëpunimit në fjalë.

3. Qendra Kombëtare e Biznesit sigurohet që shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim të kenë miratuar projekt marrëveshjen e bashkimit me të njëjtat kushte, si edhe që parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve të jenë përcaktuar në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

4. Qendra Kombëtare e Biznesit sigurohet, gjithashtu, që SHEB-i të jetë themeluar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Regjistrimi i bashkimit

1. Një bashkim dhe themelim i njëkohshëm i një SHEB-i hyn në fuqi në datën kur SHEB-i



regjistrohet në përputhje me pikën 1, të nenit 13 të këtij ligji.

2. SHEB-i nuk mund të regjistrohet derisa të kenë përfunduar të gjitha formalitetet e parashikuara në nenet 30 e 31 të këtij ligji.

Neni 33 Publikimi

Për secilën prej shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim, përfundimi i bashkimit bëhet publik në përputhje me ligjin e zbatueshëm në shtetin anëtar përkatës.

Neni 34 Pasojat e bashkimit

1. Bashkimi i kryer në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 20 të këtij ligji, sjell pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha asetet dhe detyrimet e secilës shoqëri bashkëpunimi që përthithet i transferohen shoqërisë përthithëse;

b) anëtarët e secilës shoqëri bashkëpunimi që përthithet bëhen anëtarë të shoqërisë përthithëse;

c) shoqëritë e bashkëpunimit që përthithen pushojnë së ekzistuari;

ç) shoqëria përthithëse merr formën e një SHEB-i.

2. Bashkimi i kryer në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 20 të këtij ligji, sjell pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha asetet dhe detyrimet e shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen i transferohen SHEB-it;

b) anëtarët e shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen bëhen anëtarë të SHEB-it;

c) shoqëritë e bashkëpunimit që bashkohen pushojnë së ekzistuari.

3. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për formalitetet e bashkimeve të shoqërive të bashkëpunimit sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse, që lidhen me kushtet individuale e kolektive të punës dhe që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, praktika ose kontratat e punës në fuqi në datën e regjistrimit, i kalojnë automatikisht SHEB-it në momentin e

regjistrimit të saj. Kjo dispozitë nuk zbatohet për të drejtën e përfaqësuesve të punëmarrësve për të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 59 të këtij ligji.

5. Pas regjistrimit të bashkimit, SHEB-i duhet të njoftojë menjëherë anëtarët e shoqërisë së bashkëpunimit që përthithet për faktin se ata janë regjistruar në regjistrin e anëtarëve të SHEB-it, si edhe për numrin e kuotave të tyre.

Neni 35 Vlefshmëria e bashkimit

1. Një bashkim, siç parashikohet në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 4 të këtij ligji, nuk mund të shpallet i pavlefshëm pasi SHEB-i të jetë regjistruar.

2. Mungesa e shqyrtimit të ligjshmërisë së bashkimit, në përputhje me nenet 30 e 31 të këtij ligji, përbën një nga shkaqet për prishjen e SHEB-it, sipas parashikimeve të nenit 73 të këtij ligji.

SEKSIONI 3 SHNDËRRIMI I NJË SHOQËRIE BASHKËPUNIMI EKZISTUESE NË NJË SHEB

Neni 36 Procedurat për themelimin me anë të shndërrimit

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 13 të këtij ligji, shndërrimi i një shoqërie bashkëpunimi në një SHEB nuk do të rezultojë në mbylljen e shoqërisë së bashkëpunimit ose në krijimin e një personi të ri juridik.

2. Selia nuk mund të transferohet nga Republika e Shqipërisë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, sipas nenit 9 të këtij ligji, në të njëjtën kohë me kryerjen e shndërrimit.

3. Organi i administrimit ose drejtuesi i shoqërisë së bashkëpunimit në fjalë harton projekt marrëveshjen e shndërrimit dhe një raport shpjegues, që arsyeton aspektet ligjore e ekonomike të procesit, pasojat e tij mbi marrëdhëniet e punës dhe pasqyron ndikimet që do të ketë shndërrimi në SHEB për anëtarët dhe punëmarrësit.



4. Projekt marrëveshja e shndërrimit bëhet publike në mënyrën e përcaktuar në titullin III, të pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

5. Përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të përmendur në pikën 6 të këtij neni, një ose më shumë auditues të pavarur, të emëruar në përputhje me ligjin në fuqi, duhet të vërtetojnë rast pas rasti se janë respektuar rregullat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 23 të këtij ligji.

6. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së bashkëpunimit në fjalë miraton projekt marrëveshjen e shndërrimit së bashku me statutin e SHEB-it.

7. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së bashkëpunimit që do të shndërrohet, që lidhen me kushtet individuale e kolektive të punës dhe që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, praktika ose kontratat e punës në fuqi në datën e regjistrimit, i kalojnë automatikisht SHEB-it në momentin e regjistrimit të saj.

KREU III ORGANIZIMI I SHEB-it

Neni 37 Organet e SHEB-it

Sipas kushteve të përcaktuara nga ky ligj, një SHEB do të përbëhet nga:

- a) një asamble e përgjithshme; dhe
- b) ose një organ mbikëqyrës dhe një organ drejtues (sistem me dy nivele), ose një organ me funksione administrimi (sistem me një nivel) në varësi të formës së miratuar në statut.

SEKSIONI 1 SISTEMI ME DY NIVELE

Neni 38 Funksionet e organit drejtues dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi drejtues është përgjegjës për administrimin e SHEB-it dhe përfaqësimin e saj në marrëdhëniet dhe procedurat ligjore me palët e treta.

2. Anëtari ose anëtarët e organit drejtues emërohen dhe shkarkohen nga organi mbikëqyrës.

3. Anëtarët e organit drejtues nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të organit mbikëqyrës. Megjithatë, organi mbikëqyrës mund të emërojë një nga anëtarët e tij për të ushtruar funksionin e anëtarit të organit drejtues, në rast të një vendi të lirë. Gjatë kësaj periudhe, funksionet e personit përkatës si anëtar i organit mbikëqyrës pezullohen.

4. Numri i anëtarëve të organit drejtues ose rregullat për përcaktimin e tij pasqyrohen në statutin e SHEB-it.

Neni 39 Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit drejtues

1. Organi drejtues zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij në përputhje me statutin.

2. Kryetari thërret një mbledhje të organit drejtues sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij, ose me kërkesë të një anëtari. Çdo kërkesë duhet të tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me një kërkesë të tillë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit drejtues mund të thirret drejtpërdrejt nga anëtari/anëtarët që ka/kanë bërë kërkesën.

Neni 40 Funksionet e organit mbikëqyrës dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi mbikëqyrës kontrollon detyrat e kryera nga organi drejtues. Organi mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë vetë kompetencat e administrimit të SHEB-it. Organi mbikëqyrës nuk mund ta përfaqësojë SHEB-in në marrëdhëniet me palët e treta. Ai përfaqëson SHEB-in në marrëdhëniet me organin drejtues ose anëtarët e tij për çështje gjyqësore dhe për lidhjen, ndryshimin ose përfundimin e kontratave ndërmjet SHEB-it dhe anëtarëve të organit drejtues.

2. Anëtarët e organit mbikëqyrës emërohen dhe shkarkohen nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme. Megjithatë, anëtarët e parë të organit mbikëqyrës mund të emërohen në statut. Kjo dispozitë zbatohet pa cenuar rregullat për



përfshirjen dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve në SHEB, të përcaktuara sipas legjislacionit të zbatueshëm.

3. Jo më shumë se një e katërta e vendeve të lira në organin mbikëqyrës mund të plotësohen nga anëtarë që nuk janë përdorues.

4. Statuti përcakton numrin e anëtarëve të organit mbikëqyrës ose rregullat për përcaktimin e tij.

Neni 41

E drejta për të dhënë informacion

1. Organi drejtues i raporton organit mbikëqyrës të paktën një herë në 3 muaj për progresin dhe zhvillimet që parashikohen në veprimtarinë e SHEB-it, duke marrë parasysh çdo informacion, lidhur me shoqëritë e kontrolluara nga SHEB-i, që mund të ndikojë ndjeshëm në ecurinë e veprimtarisë së SHEB-it.

2. Përveç informacionit që komunikohet rregullisht sipas pikës 1 të këtij neni, organi drejtues duhet t'i komunikojë menjëherë organit mbikëqyrës çdo informacion mbi ngjarjet që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në veprimtarinë e SHEB-it.

3. Organi mbikëqyrës mund t'i kërkojë organit drejtues të sigurojë çdo lloj informacioni që i nevojitet për të ushtruar mbikëqyrjen sipas pikës 1, të nenit 40 të këtij ligji.

4. Organi mbikëqyrës mund të kryejë ose të organizojë çdo hetim të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij.

5. Çdo anëtar i organit mbikëqyrës ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha informacionet, që i paraqiten organit mbikëqyrës.

Neni 42

Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit mbikëqyrës

1. Organi mbikëqyrës zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij. Nëse gjysma e anëtarëve emërohen nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të zgjidhet kryetar.

2. Kryetari thërret mbledhjen e organit mbikëqyrës sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij/saj, ose me kërkesë të të paktën një të tretës së anëtarëve të tij, ose me kërkesë të organit drejtues. Kërkesa duhet të

tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit mbikëqyrës mund të thirret nga vetë personi që ka bërë kërkesën.

SEKSIONI 2

SISTEMI ME NJË NIVEL

Neni 43

Funksionet e organit të administrimit dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi i administrimit administron SHEB-in dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet e në procedurat ligjore me palët e treta.

2. Numri i anëtarëve të organit të administrimit ose rregullat për emërimin e tyre përcaktohen në statutin e SHEB-it. Jo më shumë se një e katërta e vendeve të lira në organin e administrimit mund të zihen nga anëtarë që nuk janë përdorues. Megjithatë, organi i administrimit duhet të përbëhet nga të paktën 3 anëtarë punëmarrës të SHEB-it, pjesëmarrja e të cilëve rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Anëtarët e organit të administrimit dhe, kur parashikohet nga statuti, anëtarët e tyre zëvendësues emërohen nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme. Megjithatë, anëtarët e parë të organit të administrimit mund të emërohen nga statuti. Kjo zbatohet pa cenuar asnjë parashikim të pjesëmarrjes së punëmarrësve të përcaktuar, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për pjesëmarrjen e punëmarrësve në një SHEB.

Neni 44

Frekuenca e mbledhjeve dhe e drejta për informacion

1. Organi i administrimit mbledhet të paktën një herë në 3 muaj, në intervalet e përcaktuara në statut, për të diskutuar ecurinë dhe zhvillimin e parashikueshëm të veprimtarisë së SHEB-it, duke marrë parasysh, kur është e përshtatshme, çdo informacion lidhur me shoqëritë e kontrolluara nga SHEB-i, që mund të ndikojë ndjeshëm në ecurinë e veprimtarisë së SHEB-it.

2. Çdo anëtar i organit të administrimit ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha raportet, dokumentet dhe informacionet që i paraqiten këtij organi.



Neni 45

Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit të administrimit

1. Organi i administrimit zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij. Nëse gjysma e anëtarëve emërohen nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të zgjidhet kryetar.

2. Kryetari thërret mbledhjen e organit të administrimit sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij/saj, ose me kërkesë të të paktën një të tretës së anëtarëve të tij. Kërkesa duhet të tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit të administrimit mund të thirret nga personi që ka bërë kërkesën.

SEKSIONI 3

RREGULLAT E PËRBASHKËTA PËR SISTEMET ME NJË DHE DY NIVELE

Neni 46

Mandati

1. Anëtarët e organeve të SHEB-it emërohen për një periudhë të përcaktuar në statut, që nuk i kalon 6 vjet.

2. Me përjashtim të çdo kufizimi të përcaktuar në statut, anëtarët mund të riemërohen një ose më shumë se një herë për periudhën e përcaktuar, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 47

Kushtet e anëtarësimit

1. Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi të SHEB-it, nëse:

a) është i përjashtuar sipas ligjit shqiptar nga ushtrimi i funksioneve në organet drejtuese ose mbikëqyrëse të një shoqërie bashkëpunimi të rregulluar nga ky ligj; ose

b) është i përjashtuar nga ushtrimi i funksioneve në organet përkatëse të një shoqërie bashkëpunimi sipas një vendimi gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, të dhënë nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Statuti mund të përcaktojë kushte të veçanta të përshtatshmërisë për anëtarët që përfaqësojnë organin e administrimit.

Neni 48

Kompetenca e përfaqësimit dhe përgjegjësia e SHEB-it

1. Në rastet kur kompetenca për të përfaqësuar SHEB-in në marrëdhëniet me palët e treta, në përputhje me nenet 38, pika 1, e 43, pika 1, të këtij ligji, u jepet dy ose më shumë anëtarëve të organit të administrimit, këta anëtarë e ushtrojnë këtë kompetencë bashkërisht.

2. Veprimet e kryera nga organet e një SHEB-i janë të detyrueshme për SHEB-in ndaj palëve të treta, edhe nëse këto veprime nuk përputhen me objektin e shoqërisë, për sa kohë që nuk tejkalojnë kompetencat që u janë dhënë organeve përkatëse nga ligji shqiptar ose që lejohet t'u delegohen sipas këtij ligji.

3. Kufizimet e kompetencave të organeve të SHEB-it, të përcaktuara në statutin e saj ose në vendime të organeve përkatëse, nuk mund t'u kundërdrejtohen palëve të treta, edhe nëse janë bërë publike.

Neni 49

Veprimet që kërkojnë autorizim

1. Statuti i një SHEB-i duhet të rendisë kategoritë e transaksioneve, që kërkojnë:

a) sipas sistemit me dy nivele, autorizim nga organi mbikëqyrës ose mbledhja e asamblesë së përgjithshme për organin drejtues;

b) sipas sistemit me një nivel, një vendim të shprehur të miratuar nga organi i administrimit ose autorizim nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet pa cenuar parashikimet në lidhje me kompetencat e organeve të SHEB-it, sipas nenit 48 të këtij ligji.

Neni 50

Konfidencialiteti

Anëtarët e organeve të një SHEB-i duhet të ruajnë konfidencialitetin për çdo informacion që kanë marrë në lidhje me SHEB-in edhe pas përfundimit të mandatit të tyre. Zbulimi i



informacionit mund të dëmtojë interesat e shoqërisë së bashkëpunimit ose të anëtarëve të saj, përveç rasteve kur zbulimi kërkohet, ose lejohet nga dispozitat e ligjit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit ose shoqëritë tregtare, ose kur zbulimi është në interes publik.

Neni 51

Marrja e vendimeve nga organet e SHEB-it

1. Përveç rasteve kur ky ligj ose statuti parashikojnë ndryshe, rregullat e brendshme për kuorumin dhe vendimmarrjen në organet e SHEB-it janë, si më poshtë:

a) kuorumi: të paktën gjysma e anëtarëve me të drejtë vote duhet të jenë të pranishëm ose të përfaqësuar;

b) vendimmarrja: vendimet merren nga shumica e anëtarëve me të drejtë vote, që janë të pranishëm ose të përfaqësuar.

Anëtarët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në vendimmarrje duke autorizuar një anëtar tjetër të organit ose një anëtar zëvendësues të emëruar njëkohësisht për t'i përfaqësuar.

2. Në mungesë të një parashikimi të shprehur në statut, kryetari i secilit organ ka të drejtën e votës vendimtare në rast barazie votash. Megjithatë, kjo e drejtë nuk zbatohet kur gjysma e anëtarëve të organit mbikëqyrës përbëhet nga përfaqësues të punëmarrësve, pavarësisht nga parashikimet e statutit.

Neni 52

Përgjegjësia civile

Anëtarët e organeve drejtuese, mbikëqyrëse dhe të administrimit janë përgjegjës, në përputhje me dispozitat që zbatohen për shoqëritë e bashkëpunimit në Republikën e Shqipërisë, për çdo humbje ose dëm të pësuar nga SHEB-i si pasojë e shkeljeve të detyrimeve ligjore, statute ose shkeljeve të tjera që rrjedhin nga ushtrimi i detyrave të tyre.

SEKSIONI 4

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 53

Kompetencat

1. Asambleja e përgjithshme vendos për çështjet që i janë rezervuar ekskluzivisht nga ky ligj.

2. Përveç çështjeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme vendos edhe për ato çështje që sipas ligjit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit ose statutit të shoqërisë janë në kompetencën e saj, në përputhje me strukturën e parimet e veprimit të shoqërive të bashkëpunimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 54

Zhvillimi i mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme

Pa cenuar dispozitat e këtij seksioni, organizimi dhe zhvillimi i mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme të SHEB-ve me seli në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurat e votimit rregullohen nga ligji i zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit.

Neni 55

Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme

1. SHEB-i është i detyruar të mbajë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit financiar.

2. Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme mund të thirren në çdo kohë nga organi drejtues ose ai i administrimit, nga organi mbikëqyrës apo nga çdo organ, apo autoritet tjetër kompetent, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit. Organi drejtues është i detyruar të thërrasë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme me kërkesë të organit mbikëqyrës.

3. Rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme që zhvillohet pas përfundimit të vitit financiar, duhet të përfshijë të paktën miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe shpërndarjen e fitimit.



4. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të vendosë gjatë zhvillimit të saj thirrjen e një mbledhjeje tjetër e të caktojë datën dhe rendin e ditës.

Neni 56

Thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nga një pakicë anëtarësh

Anëtarët e SHEB-it, që së bashku përfaqësojnë më shumë se 5 000 anëtarë ose që zotërojnë të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të votave, kanë të drejtë t'i kërkojnë SHEB-it thirrjen e një mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme dhe të propozojnë rendin e ditës së saj. Statuti mund të parashikojë një numër më të vogël të anëtarëve ose përqindje më të ulët të votave.

Neni 57

Njoftimi për mbledhjen

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme do të thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, i cili u dërgohet me çdo mjet të përshtatshëm komunikimi të gjithë personave që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 59 të këtij ligji, si dhe me dispozitat e statutit. Njoftimi mund të publikohet, gjithashtu, në buletin zyrtar të brendshëm të SHEB-it.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e selisë së SHEB-it;
- b) vendin, datën dhe orën e mbajtjes së mbledhjes;
- c) sipas rastit, llojin e mbledhjes;
- ç) rendin e ditës, duke specifikuar çështjet që do të shqyrtohen dhe propozimet për vendimmarrje.

3. Periudha ndërmjet datës së dërgimit të njoftimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe datës së zhvillimit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë. Ky afat mund të shkurtohet në jo më pak se 15 ditë në rrethana të jashtëzakonshme. Në rastet kur zbatohet pika 4, e nenit 62 të këtij ligji, për kërkesat për kuorum, periudha ndërmjet mbledhjes së parë dhe asaj të dytë, të thirrura për

të njëjtin rend dite, mund të shkurtohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Neni 58

Shtesa në rendin e ditës

Anëtarët e SHEB-it, që së bashku përfaqësojnë më shumë se 5 000 persona ose të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të votave, mund të kërkojnë që të përfshihen një ose më shumë pika shtesë në rendin e ditës të çdo mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme. Statuti mund të parashikojë një numër më të vogël të anëtarëve ose përqindje më të ulët të votave.

Neni 59

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi me prokurë

1. Çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesë dhe të votojë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme për çështjet e përfshira në rendin e ditës.

2. Anëtarët e organeve të SHEB-it, mbajtësit e titujve, përveç kuotave dhe obligacioneve, sipas nenit 65 të këtij ligji, si dhe, nëse parashikohet nga statuti, çdo person tjetër që ka të drejtë të marrë pjesë në bazë të ligjit të zbatueshëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme pa të drejtë vote.

3. Çdo person me të drejtë vote mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një përfaqësues me prokurë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në statut. Statuti përcakton numrin maksimal të personave që mund të përfaqësohen nga i njëjti përfaqësues.

4. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, mundësinë e votimit me postë ose të votimit elektronik, duke përcaktuar në këtë rast procedurat për realizimin e tyre.

Neni 60

E drejta e votës

1. Çdo anëtar i SHEB-it ka të drejtën e një vote, pavarësisht numrit të kuotave që zotëron.

2. Lidhur me të drejtat e votës së anëtarëve investitorë sipas statutit, SHEB-i me seli në Shqipëri do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Megjithatë, anëtarët investitorë nuk mund të zotërojnë së bashku më



shumë se 25% të të drejtave të përgjithshme të votimit.

Neni 61

E drejta për informim

1. Çdo anëtar që kërkon informacion gjatë një mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme, ka të drejtë të marrë përgjigje nga organi drejtues ose i administrimit për çështjet e SHEB-it, që lidhen me pikat e rendit të ditës të asaj mbledhjeje, në përputhje me pikën 1, të nenit 62 të këtij ligji. Për aq sa është e mundur, informacioni duhet të jepet në të njëjtën mbledhje të asamblesë së përgjithshme.

2. Organi drejtues ose i administrimit mund të refuzojë dhënien e informacionit vetëm në rastet, kur:

a) ekziston një rrezik i qenësishëm që informacioni të shkaktojë dëm të konsiderueshëm për SHEB-in;

b) zbulimi i informacionit do të ishte në kundërshtim me detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit.

3. Një anëtar, të cilit i është refuzuar informacioni, mund të kërkojë që pyetja e tij dhe arsyet e refuzimit të shënohen në procesverbalin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Brenda 10 ditëve para mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për miratimin e pasqyrave financiare, anëtarët kanë të drejtë të shqyrtojnë bilancin, llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve me shënimet shpjeguese, raportin e veprimtarisë, përfundimin e auditimit të llogarive nga personi përgjegjës dhe, në rastin e një shoqërie mëmë, në përputhje me pjesën VII, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, edhe pasqyrat financiare të konsoliduara.

Neni 62

Vendimet

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme merr vendime lidhur me pikat e rendit të ditës. Ajo, gjithashtu, merr vendime për pikat që janë shtuar në rendin e ditës nga një pakicë anëtarësh, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji.

2. Vendimet në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme merren me shumicën e votave të

vlefshme të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

3. Statuti përcakton kërkesat që do të zbatohen në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme për kuorumin dhe shumicën.

Kur statuti parashikon mundësinë që një SHEB të pranojë anëtarë investitorë ose të ndajë të drejtat e votës sipas kontributit të kapitalit në SHEB-të, që ushtrojnë aktivitete financiare ose sigurimi, ai do të përcaktojë edhe kërkesa të veçanta për kuorumin lidhur me anëtarët e tjerë, përveç anëtarëve investitorë ose atyre me të drejta vote të bazuara në kontributin e kapitalit në këto SHEB-e.

4. Një mbledhje e asamblesë së përgjithshme mund të ndryshojë statutin në mbledhjen e parë të thirrur vetëm nëse anëtarët e pranishëm ose të përfaqësuar përbëjnë të paktën gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve në datën e thirrjes. Në mbledhjen e dytë, e thirrur për të njëjtin rend dite, kuorumi nuk kërkohet.

5. Në rastet e përmendura në pikën 4 të këtij neni, vendimi duhet të miratohet me shumicën e të paktën dy të tretave të votave të vlefshme.

Neni 63

Procesverbali

1. Për çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme do të mbahet një procesverbal. Procesverbali duhet të përfshijë të paktën të dhënat e mëposhtme:

- a) vendin dhe datën e mbledhjes;
- b) vendimet e miratuara;
- c) rezultatin e votimit.

2. Procesverbalit i bashkëlidhen lista e pjesëmarrësve, dokumentet që lidhen me thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe raportet e paraqitura anëtarëve për pikat e rendit të ditës.

3. Procesverbali dhe dokumentet bashkëlidhur tij duhet të ruhen për të paktën 5 vjet. Çdo anëtar mund të kërkojë një kopje të procesverbalit dhe dokumenteve bashkëlidhur, duke mbuluar kostot administrative për marrjen e tyre.

4. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes.



Neni 64

Mbledhjet e sektorit ose të seksionit

1. Kur një SHEB ushtron veprimtari të ndryshme ose veprimtari në më shumë se një njësi territoriale, ose ka disa njësi të veçanta organizative, ose më shumë se 500 anëtarë, statuti mund të parashikojë krijimin e mbledhjeve sektoriale ose të seksioneve. Statuti përcakton ndarjen sipas sektorëve apo të seksioneve dhe numrin e të deleguarve për secilin prej tyre.

2. Mbledhjet sektoriale apo të seksioneve zgjedhin të deleguarit e tyre për një mandat maksimal prej 4 vjetësh, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shkarkimi i parakohshëm. Të deleguarit e zgjedhur përbëjnë asamblenë e përgjithshme të SHEB-it dhe përfaqësojnë në të sektorin apo seksionin përkatës, të cilit i raportojnë për rezultatet e mbledhjes së përgjithshme. Dispozitat e seksionit 4, të kreut III të këtij ligji zbatohen edhe për funksionimin e mbledhjeve sektoriale dhe të seksioneve.

KREU IV

**EMETIMI I KUOTAVE ME TË DREJTA
TË VEÇANTA**

Neni 65

Kuotat e veçanta

1. Statuti i SHEB-it mund të parashikojë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për tregjet e kapitalit, emetimin e instrumenteve të veçanta financiare, përfshirë titujt të borxhit, të tillë si obligacionet, të cilët nuk japin të drejtë vote. Këto instrumente mund të nënshkruhen nga anëtarët ose nga persona të tjerë që nuk janë anëtarë. Blerja e tyre nuk u jep mbajtësve statusin e anëtarit. Statuti ose, sipas rastit, dokumentet e emetimit përcaktojnë procedurën për shlyerjen e tyre.

2. Mbajtësve të instrumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni mund t'u jepen avantazhe të veçanta, në përputhje me dispozitat e statutit ose me kushtet e përcaktuara gjatë emetimit.

3. Vlera totale nominale e instrumenteve, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, që mbahen nga i njëjti individ, nuk mund të tejkalojë shumën maksimale të përcaktuar në statut.

4. Pa cenuar të drejtën e pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme, sipas parashikimeve të

nenit 59 të këtij ligji, statuti mund të parashikojë mbajtjen e mbledhjeve të veçanta të mbajtësve të instrumenteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

5. Para se Asambleja e Përgjithshme të marrë ndonjë vendim, që prek të drejtat apo interesat e mbajtësve të instrumenteve financiare, mbledhja e veçantë mund të japë një mendim, i cili i komunikohet Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur.

6. Mendimi i mbledhjes së veçantë duhet të përfshihet në procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V

NDARJA E FITIMEVE

Neni 66

Rezervat ligjore

1. Pa rënë ndesh me ligjin e zbatueshëm, statuti përcakton rregullat për shpërndarjen e fitimit për çdo vit financiar.

2. Statuti parashikon krijimin e një rezerve ligjore nëpërmjet derdhjes në këtë fond të fitimit të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës. Deri në momentin kur kjo rezervë të arrijë vlerën e kapitalit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 5 të këtij ligji, statuti duhet të parashikojë që jo më pak se 15% e fitimit të vitit financiar, pas zbritjes së humbjeve të mbartura, të alokohet për këtë qëllim.

3. Anëtarët që largohen nga SHEB-i nuk mund të ngrenë asnjë pretendim mbi shumën e caktuar për rezervën ligjore.

Neni 67

Dividendët

Statuti mund të parashikojë që shpërndarja e dividendëve ndërmjet anëtarëve të kryhet në përpjesëtim me vëllimin e veprimtarisë së tyre me SHEB-in ose në bazë të shërbimeve të kryera prej tyre në favor të SHEB-it.

Neni 68

Shpërndarja e tepricës së disponueshme

1. Gjendja e tepricës, pas zbritjes së shumave të caktuara për rezervën ligjore, dividendëve të paguar dhe humbjeve të mbartura, si dhe pas shtimit të çdo



teprice të mbartur nga vitet e mëparshme dhe të çdo shume të tërhequr nga rezervat, përbën fitimin e disponueshëm për shpërndarje.

2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme, me rastin e miratimit të pasqyrave financiare vjetore, mund të vendosë për shpërndarjen e këtij fitimi, në përputhje me rendin dhe përmasat e përcaktuara në statut. Në veçanti, ajo mund të vendosë, që:

- a) ta mbartë tepricën në vitin pasardhës;
- b) ta ndajë atë në fondet rezervë ligjore ose statutores;
- c) të shpërndahet si përfitim mbi kapitalin e paguar dhe/ose mbi mjetet e tjera të barasvlershme me kapitalin (*quasi-capital*), në formë monetare ose në kuota.

3. Statuti, gjithashtu, mund të parashikojë ndalime për shpërndarjen e fitimit.

KREU VI

PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE PASQYRAT E KONSOLIDUARA

Neni 69

Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore dhe të atyre të konsoliduara

1. Për qëllime të hartimit të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara, përfshirë raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin dhe publikimin e tyre, SHEB-i u nënshtrohet dispozitave ligjore të zbatueshme për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. SHEB-i harton pasqyrat financiare vjetore dhe, në rast se ka, edhe pasqyrat e saj të konsoliduara në monedhën vendase.

Neni 70

Pasqyrat financiare të SHEB-eve që ushtrojnë aktivitete krediti ose financiare

1. SHEB-i që ushtron veprimtari si institucion krediti ose financiar u nënshtrohet dispozitave të ligjit të zbatueshëm për themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, të pasqyrave të konsoliduara, raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin e publikimin e këtyre pasqyrave.

2. SHEB-i që ushtron veprimtari si shoqëri sigurimi u nënshtrohet dispozitave të ligjit të

zbatueshëm për shoqëritë e sigurimit, në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, të pasqyrave të konsoliduara, përfshirë raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin e publikimin e këtyre pasqyrave.

Neni 71

Auditimi

Auditimi i pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, i pasqyrave të konsoliduara të një SHEB-i kryhet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për auditimin ligjor.

KREU VII

PRISHJA, LIKUIDIMI, FALIMENTIMI DHE PAAFTËSIA PAGUESE

Neni 72

Prishja, likuidimi, falimentimi dhe procedurat e ngjashme

Prishja, likuidimi, falimentimi, paaftësia paguese dhe procedurat e ngjashme për SHEB-et u nënshtrohen procedurave të parashikuara në ligjin për falimentimin, si dhe dispozitave përkatëse të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 73

Prishja e SHEB-it

1. Selia e regjistruar e një SHEB-i duhet të përkohet me vendndodhjen ku ushtrohen funksionet kryesore të administrimit të saj, përfshirë vendndodhjen e organeve ekzekutive dhe mbajtjen e dokumentacionit të shoqërisë. Nëse QKB-ja konstaton se kjo vendndodhje (drejtimi qendror) e një SHEB-i, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, është transferuar në një shtet tjetër, ajo i kërkon SHEB-it që brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar prej saj të rikthejë drejtimin qendror në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të fillojë procedurat për transferimin e selisë së regjistruar në një shtet tjetër, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

2. Kërkesa e QKB-së, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të rrethanave që e justifikojnë atë dhe të përfshijë shprehimisht njoftimin se në rast të moszbatimit nga ana e SHEB-it, do të pasojë kërkesa për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar.



3. Nëse SHEB-i nuk vepron në përputhje me kërkesën e QKB-së brenda afatit të përcaktuar, QKB-ja i drejtohet gjykatës kompetente me kërkesë për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar të SHEB-it. Njëkohësisht, QKB-ja bën shënimin përkatës në regjistrin tregtar, që pasqyron paraqitjen e kësaj kërkesë.

4. Përveç sa parashikohet në pikat 1 deri në 3 të këtij neni, çdo person i interesuar ose Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente për prishjen e një SHEB-i, kur konstatohet se:

a) ka shkelje të dispozitave të nenit 4 të këtij ligji dhe/ose të pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji, si dhe në rastet e parashikuara nga neni 35 i këtij ligji; ose

b) SHEB-i ka më pak se tre anëtarë për një periudhë të pandërprerë prej 6 muajsh.

5. Vendimi i gjykatës për prishjen e SHEB-it regjistrohet në regjistrin tregtar dhe hyn në fuqi menjëherë pas regjistrimit. Çdo SHEB, që prishet me vendim gjykatë, në përputhje me këtë nen, i nënshtrohet likuidimit të detyruar.

Neni 74

Publikimi i prishjes

Pa cenuar dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm, lidhur me detyrimet për regjistrim e publikim, fillimi dhe përfundimi i procedurave të likuidimit, përfshirë likuidimin vullnetar, falimentimin apo paaftësinë paguese, si dhe çdo vendim për vazhdimin e veprimtarisë, duhet të publikohet në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

Neni 75

Shpërndarja

Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve ndaj kreditorëve dhe rimbursimit të kontributeve të anëtarëve në kapital, aktivet e mbetura të SHEB-it shpërndahen në përputhje me parimin e mosfitimit vetjak. Për qëllimet e këtij neni, aktivet e mbetura përfshijnë çdo pasuri të mbetur në zotërim të SHEB-it pas përmbushjes së detyrimeve financiare dhe kthimit të kapitalit të anëtarëve. Nëse statuti i shoqërisë nuk parashikon ndryshe, këto aktive shpërndahen ndërmjet anëtarëve në përpjesëtim me veprimtarinë e bashkëpunimit të ndërsjellë të zhvilluar nga secili prej tyre.

Neni 76

Shndërrimi në shoqëri bashkëpunimi

1. Një SHEB mund të shndërrohet në një shoqëri bashkëpunimi të rregulluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Vendimi për shndërrimin nuk mund të merret përpara përfundimit të një periudhe 2-vjeçare nga data e regjistrimit të saj ose përpara miratimit të dy grupeve të para të pasqyrave financiare vjetore.

2. Shndërrimi i një SHEB-i në shoqëri bashkëpunimi nuk sjell likuidimin e saj dhe as krijimin e një personi të ri juridik.

3. Organi drejtues ose i administrimit të SHEB-it harton projekt marrëveshjen e shndërrimit, si dhe një raport që shpjegon dhe arsyeton aspektet juridike dhe ekonomike të shndërrimit, pasojat e tij në marrëdhëniet e punës, si dhe pasojat e shndërrimit për anëtarët, mbajtësit e kuotave të përmendur në nenin 16 të këtij ligji dhe për punëmarrësit.

4. Projekt marrëveshja e shndërrimit bëhet publike të paktën një muaj përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për të vendosur mbi shndërrimin.

5. Përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, të përmendur në pikën 6 të këtij neni, një ose më shumë auditues të emëruar nga autoriteti kompetent verifikojnë që SHEB-i, që transformohet në shoqëri bashkëpunimi, zotëron pasuri të paktën të barasvlershme me kapitalin e saj.

6. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme e SHEB-it miraton projekt marrëveshjen e shndërrimit, së bashku me statutin e shoqërisë së bashkëpunimit. Vendimi merret në përputhje me legjislacionin shqiptar për shoqëritë tregtare.

KREU VIII

DISPOZITA SHITESË

Neni 77

Monedha e kapitalit dhe e pasqyrave financiare

1. Një SHEB me seli të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë shpreh kapitalin e saj në lekë. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, që kapitali të shprehet edhe në euro, kur kjo është e nevojshme për qëllime të raportimit financiar ose për bashkëpunim ndërkufitar. Në këtë rast, kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin nga “lekë” në



“euro” është ai i ditës së fundit të muajit paraardhës të datës së regjistrimit të SHEB-it, sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

2. SHEB-i përgatit e publikon pasqyrat e saj financiare vjetore dhe, kur është e aplikueshme, pasqyrat e konsoliduara në lekë, siç kërkohet për shoqëritë aksionare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

KREU IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 78

Shfuqizime në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

1. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të gjitha dispozitat e këtij ligji shfuqizohen pasi nga ajo datë SHEB-et e themeluara në territorin e Republikës së Shqipërisë u nënshtrohen drejtpërdrejt Rregullores (KE) nr. 1435/2003 të Këshillit, datë 22 korrik 2003, “Për Statutin e Shoqërisë Evropiane Kooperative (SCE)”, dhe akteve të tjera të BE-së në fuqi për këtë qëllim.

2. SHEB-et e regjistruara para datës së anëtarësimit vazhdojnë ekzistencën e tyre juridike pa ndërprerje, si shoqëri evropiane të bashkëpunimit në kuptim të rregullores së përmendur në pikën 1 të këtij neni.

³ Ky ligj është përfshirë plotësisht, me:

- direktivën 2004/109/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, “Për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar”, dhe që ndryshon direktivën 2001/34/EC;

- direktivën 2007/14/EC e Komisionit, datë 8 mars 2007, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e disa dispozitave të direktivës 2004/109/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, Për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar”;

- direktivën 2008/22/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2008, “Për ndryshimin e direktivës 2004/109/EC për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, sa i përket kompetencave zbatuese të dbëna Komisionit”;

- direktivën 2010/73/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2010, që ndryshon direktivat 98/26/EC, 2002/87/EC, 2003/6/EC, 2003/41/EC, 2003/71/EC, 2004/39/EC, 2004/109/EC, 2005/60/EC, 2006/48/EC, 2006/49/EC dhe 2009/65/EC, në lidhje me kompetencat e Autoritetit Evropian Mbikëqyrës;

- direktivën 2013/50/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 22 tetor 2013, “Për ndryshimin e direktivës 2004/109/EC të Parlamentit Evropian

Neni 79

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026

**Shpallur me dekretin nr. 462, datë 31.7.2026,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET

Nr. 462, datë 31.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 77/2026, “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB)”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 80/2026

PËR KËRKESAT E TRANSPARENCËS PËR EMETUESIT E TITUJVE³

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

dhe të Këshillit, për harmonizimin e kërkesave për transparencën, në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, të direktivës 2003/71/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për prospektin që duhet të publikohet kur ofrohen ose pranohen për tregtim tituj dhe të direktivës 2007/14/EC të Komisionit, që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e disa dispozitave të direktivës 2004/109/EC”;

- rregulloren e deleguar e Komisionit (BE) 2015/761, datë 17 dhjetor 2014, që plotëson direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me disa standarde teknike rregullatore për zotërimet e mëdha;

- rregulloren (BE) 2021/337 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 shkurt 2021, për ndryshimin e rregullores (BE) 2017/1129, në lidhje me prospektin e rimëkëmbjes së BE-së dhe përshatjet e synuara për ndërmjetësit financiarë, si dhe të direktivës 2004/109/EC, në lidhje me përdorimin e formatit të vetëm elektronik për raportet vjetore financiare, për të mbështetur rimëkëmbjen nga kriza COVID-19;

- direktivën (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 537/2014, direktivën 2004/109/EC, direktivën 2006/43/EC dhe direktivën 2013/34/BE, në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave;

- direktivën (BE) 2023/2864 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2023, për ndryshimin e disa direktivave, në lidhje me krijimin dhe funksionimin e pikës së vetme të aksesit evropian (ESAP).

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj përcakton kërkesat për publikimin e informacionit periodik dhe të vazhdueshëm për emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar që ndodhet ose që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë apo brenda një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Kërkesat e këtij ligji nuk zbatohen për kuotat e emetuar nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, të ndryshme nga ato me pjesëmarrje të mbyllur ose për kuotat që janë blerë, ose janë shitur në sipërmarrje të tilla investimi kolektiv.

3. Dispozitat e përmendura në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 26 të këtij ligji, nuk zbatohen për titujt që pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, të emetuar nga Republika e Shqipërisë, nga një shtet anëtar i BE-së ose nga organet e tyre të qeverisjes vendore e rajonale.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për emetuesin për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, si dhe nga një emetues, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim vetëm në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Titujt”** janë titujt e transferueshëm siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, i cili transpozon legjislacionin e Bashkimit Evropian për tregjet e instrumenteve financiare, me përjashtim të instrumenteve të tregut të parasë, që kanë një maturitet më pak se 12 muaj;

b) **“Tituj borxhi”** janë obligacionet ose forma të tjera të borxheve, të titulluara të transferueshme, me përjashtim të titujve që janë ekuivalentë me aksionet në shoqëri ose të cilat,

nëse konvertohen, ose nëse ushtrohen të drejtat e dhëna prej tyre, krijojnë një të drejtë për të blerë aksione ose tituj ekuivalentë me aksionet;

c) **“Autoriteti”** është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

ç) **“Treg i rregulluar”** është tregu siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, i cili transpozon legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian për tregjet e instrumenteve financiare;

d) **“Emetues”** është një person fizik ose juridik, i rregulluar nga e drejta private ose publike, përfshirë një shtet titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

Në rastin e certifikatave të depozitave, të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, emetues është emetuesi i titujve të përfaqësuar, pavarësisht nëse këta tituj janë pranuar apo jo për tregtim në një treg të rregulluar;

dh) **“Aksionar”** është çdo person fizik ose juridik, i cili zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi:

i. aksionet e një emetuesi në emër të vet dhe për llogari të vet;

ii. aksionet e një emetuesi në emër të vet, por për llogari të një personi tjetër fizik ose juridik;

iii. certifikata depozitash, rast në të cilin mbajtësi i dëftesës së depozitarit duhet të konsiderohet si aksionar për aksionet bazë, që përfaqësohen përmes certifikatave të depozitave;

e) **“Shoqëri e kontrolluar”** është çdo shoqëri, për të cilën:

i. një person fizik ose juridik zotëron shumicën e të drejtave të votës; ose

ii. një person fizik ose juridik ka të drejtën për të emëruar ose për të shkarkuar një pjesë të madhe të anëtarëve të organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës dhe është në të njëjtën kohë aksionar, ose anëtar i shoqërisë në fjalë; ose

iii. një person fizik ose juridik është aksionar ose anëtar dhe, në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar me aksionarë, ose anëtarë të tjerë të shoqërisë në fjalë, kontrollon i vetëm të drejtat e votës së një pjese të madhe të aksionarëve apo të anëtarëve; ose

iv. një person fizik ose juridik ka kompetencat për të ushtruar apo ushtron aktualisht një ndikim dominues ose kontroll;

ë) **“Sipërmarrje e investimeve kolektive, e ndryshme nga ato me pjesëmarrje të mbyllur”** është fondi i investimit dhe shoqëria e investimit:



i. objekti i të cilit është investimi kolektiv i kapitalit të ofruar nga publiku, që vepron mbi parimin e shpërndarjes së rrezikut;

ii. kuotat e të cilit, me kërkesë të mbajtësit të tyre, blihen apo shlyhen drejtpërdrejt apo tërthorazi nga aktivet e këtyre sipërmarrjeve.

f) **“Kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive”** janë titujt e emetuar nga një sipërmarrje e investimeve kolektive dhe përfaqësojnë të drejtat e pjesëmarrësve për aktivet e një sipërmarrjeje të tillë;

g) **“Shtet i origjinës”**:

i. për emetuesin e titujve të borxhit, vlera nominale për njësi e të cilave është më e vogël se ekuivalenti në lekë i 1000 eurove apo për emetuesin e aksioneve:

- kur emetuesi është themeluar në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian është Republika e Shqipërisë apo shteti anëtar i Bashkimit Evropian (në vijim shteti anëtar) në të cilin emetuesi ka selinë e regjistruar;

- kur emetuesi është themeluar në një vend të tretë është Republika e Shqipërisë ose shteti anëtar i Bashkimit Evropian, i zgjedhur nga emetuesi ndërmjet vendeve anëtare, ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Zgjedhja e shtetit anëtar të origjinës mbetet e vlefshme nëse emetuesi nuk ka zgjedhur një shtet të ri anëtar të origjinës, sipas nënndarjes “iii” të kësaj shkronje dhe ka bërë publike zgjedhjen, në përputhje me nënndarjen “iv” të kësaj shkronje.

Përkufizimi “shteti i origjinës” zbatohet për titujt e borxhit të denominuar në valutë të ndryshme nga euro, me kusht që vlera nominale për njësi në datën e emetimit të jetë më pak se ekuivalenti në lekë i 1000 eurove përveçse kur kjo vlerë është afërsisht ekuivalenti në lekë i 1000 eurove;

ii. për çdo emetues që nuk parashikohet në nënndarjen “i” të kësaj shkronje, shteti anëtar i përzgjedhur nga emetuesi ndërmjet shtetit anëtar në të cilin emetuesi ka selinë e tij të regjistrimit, kur është e aplikueshme, dhe atyre shteteve anëtare ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar. Emetuesi mund të zgjedhë vetëm një shtet anëtar si shtetin e tij të origjinës. Zgjedhja e tij mbetet e vlefshme të paktën 3 vjet nëse titujt e tij nuk janë më të pranuar për tregtim në ndonjë treg të rregulluar në Bashkimin Evropian ose nëse emetuesi nuk mbulohet nga

nënndarjet “i” ose “iii”, të kësaj shkronje, gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare;

iii. për një emetues titujt e të cilit nuk janë më të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në shtetin e tij të origjinës, siç përcaktohet në paragrafin e dytë, të nënndarjes “i” ose nënndarjen “ii”, të kësaj shkronje, por janë të pranuar për tregtim në një ose më shumë shtete të tjera anëtare, shteti i ri i origjinës është shteti anëtar i Bashkimit Evropian, që emetuesi mund të përzgjedhë ndërmjet shteteve anëtare, ku titujt e tij janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe, kur është e aplikueshme, shteti anëtar ku emetuesi ka selinë e regjistruar;

iv. një emetues bën publik shtetin e tij të origjinës, siç referohet në nënndarjet “i”, “ii” ose “iii”, të kësaj shkronje, në përputhje me nenet 28 dhe 29 të këtij ligji. Përveç kësaj, një emetues ia bën të ditur shtetin e tij të origjinës autoritetit, si autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë ose autoritetit kompetent të shtetit anëtar, ku ka selinë e regjistruar, kur është e aplikueshme, tek autoriteti kompetent i shtetit të origjinës dhe tek autoritetet kompetente të të gjitha shteteve anëtare pritëse.

Në mungesë të bërjes publike nga emetuesi të shtetit të tij të origjinës, siç përcaktohet në paragrafin e dytë, të nënndarjeve “i” ose “ii” të kësaj shkronje, brenda një periudhe prej tre muajsh nga data kur titujt e emetuesit pranohen për herë të parë për tregtim në një treg të rregulluar, shteti i origjinës do të jetë Republika e Shqipërisë ose shteti anëtar ku titujt e emetuesit pranohen për tregtim në një treg të rregulluar. Kur titujt e emetuesit pranohen për tregtim në tregje të rregulluara, që ndodhen ose veprojnë në Republikën e Shqipërisë, dhe brenda më shumë se një shteti anëtar, Republika e Shqipërisë dhe këto shtete anëtare konsiderohen shtete të origjinës të emetuesit derisa të bëhet publike nga emetuesi zgjedhja e mëvonshme e një shteti të vetëm të origjinës.

Për qëllim të këtij ligji, Republika e Shqipërisë trajtohet si “shtet i origjinës” ose “shtet pritës”, sipas rastit, në kuptim të përkufizimit të këtij neni, pavarësisht statusit të saj si vend joanëtar i Bashkimit Evropian;

gj) **“Shteti pritës”** është Republika e Shqipërisë ose një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (në vijim shteti anëtar), ku titujt



pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, nëse është i ndryshëm nga shteti i origjinës;

h) **“Informacion i rregulluar”** është i gjithë informacioni që emetuesi ose çdo person tjetër që ka paraqitur kërkesë për pranim të instrumenteve financiare për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, është i detyruar ta bëjë publik në përputhje me këtë ligj, si dhe informacioni që duhet bërë publik sipas legjislacionit në fuqi për abuzimin në treg (manipulimin e tregut dhe përdorimin e informacionit të brendshëm) dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

i) **“Mjete elektronike”** janë mjetet elektronike të përdorura për përpunimin (përfshirë kompresimin digjital), ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave, duke përdorur kablo, radio, teknologji optike ose çdo mjet tjetër elektromagnetik;

j) **“Shoqëri administruese”** është shoqëria sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive, që transpozon të drejtën evropiane, që lidhet me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (UCITS);

k) **“Krijues tregu”** është personi, i cili në mënyrë të vazhdueshme është i pranishëm në tregjet financiare si person i gatshëm të tregtojë për llogari të vet, me fondet e veta, duke blerë dhe duke shitur instrumente financiare kundrejt aktiveve të veta, me çmime që i përcakton vetë;

l) **“Institucion krediti”** është shoqëria sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe transpozon legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në këtë fushë;

ll) **“Tituj të emetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur”** janë tituj borxhi në dispozicion, të emetuar nga i njëjti emetues ose të paktën dy emetime të veçanta titujsh që janë të ngjashme në lloj dhe/ose klasë;

m) **“Marrëveshje formale”** është një marrëveshje detyruese sipas legjislacionit në fuqi;

n) **“Raportimi i qëndrueshmërisë”** është raportimi sipas përcaktimeve në legjislacionin që rregullon kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

nj) **“Ekuivalenti në lekë i shumës në euro”** është vlera në lekë e shumës përkatëse në euro, e llogaritur sipas kursit zyrtar të këmbimit, të

publikuar nga Banka e Shqipërisë një ditë përpara datës së referencës.

2. Për qëllim të përkufizimit të termit “shoqëri e kontrolluar”, e parashikuar në nënndarjen “ii”, të shkronjës “e”, të pikës 1 të këtij neni, të drejtat e zotëruesit në lidhje me votën, emërimin dhe shkarkimin përfshijnë të drejtat e çdo shoqërie tjetër të kontrolluar nga aksionari dhe ato të çdo personi fizik ose juridik që vepron, pavarësisht se në emër të tij, për llogari të aksionarit ose çdo shoqërie tjetër të kontrolluar nga ky i fundit.

3. Çdo referencë për personat juridikë në këtë ligj do të përfshijë edhe shoqatat e regjistruara të biznesit pa personalitet juridik dhe personat që veprojnë në emër të të tjerëve (*trust-et*).

Neni 3

Kalendari i ditëve të tregtimit

1. Ditë tregtimi janë ditët e tregtimit të tregut të rregulluar të shtetit të origjinës së emetuesit, në kuptim të pikave 2 dhe 6, të nenit 15, si dhe të pikës 1, të nenit 22 të këtij ligji.

2. Autoriteti publikon në faqen zyrtare kalendarin e ditëve të tregtimit të çdo tregu të rregulluar, që ndodhet ose ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

INFORMACIONI PERIODIK

Neni 4

Raportet financiare vjetore

1. Emetuesi publikon raportin financiar vjetor jo më vonë se 4 muaj nga mbyllja e çdo viti financiar dhe sigurohet që ai të jetë i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet.

2. Raporti financiar vjetor duhet të përfshijë:

a) pasqyrat financiare të audituara, individuale apo të konsoliduara, sipas rastit;

b) raportin e drejtimit të brendshëm, si pjesë përbërëse e raportit të ecurisë së veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, sipas të cilave, për aq sa kanë dijeni, pasqyrat e përgatitura financiare, në përputhje me setin e standardeve të zbatueshme të kontabilitetit, të



paraqesin një pamje të vërtetë e të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar të fitimit e të humbjes së emetuesit dhe shoqërive të përfshira në konsolidim, të marra si një e tërë. Deklaratat duhet të konfirmojnë se raporti i drejtimit të brendshëm përmban një pasqyrë të drejtë të zhvillimit e të ecurisë së aktivitetit dhe pozicionit të emetuesit e të shoqërive, të përfshira në konsolidim, të marra si një e tërë, së bashku me përshkrimin e rrezeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballen, dhe kur është e përshtatshme, se ky raport është përgatitur në përputhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të përmendura në legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Kur emetuesi është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të audituara përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara, të përgatitura në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë mëmë, të përgatitura në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë apo të shtetit anëtar ku është themeluar shoqëria mëmë.

4. Kur emetuesi nuk është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të audituara përfshijnë pasqyrat e përgatitura në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë apo të shtetit anëtar ku është themeluar shoqëria.

5. Auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore të emetuesit kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

6. Audituesi ligjor përgatit një opinion dhe deklaratë për raportin e drejtimit të brendshëm, sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

7. Së bashku me raportin financiar vjetor, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, emetuesi publikon raportin e plotë të auditimit, të nënshkruar nga audituesi ligjor ose nga shoqëria audituese nëpërmjet audituesit ligjor, që kryen auditimin në emër të saj, si persona përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të emetuesit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor. Raporti i auditimit publikohet sipas mënyrës dhe afatit të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

8. Në rastet kur emetuesi ka detyrim të raportoje për qëndrueshmërinë, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ai duhet të marrë opinionin e audituesit ligjor për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

9. Së bashku me raportin financiar vjetor, emetuesi publikon të plotë raportin për dhënien e sigurisë për raportin e qëndrueshmërisë sipas legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

10. Kur emetuesi është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, raporti i konsoliduar i drejtimit të brendshëm përgatitet sipas parashikimeve të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe dispozitave në fuqi për taksonominë, kur hartohen nga shoqëri për të cilat zbatohen këto dispozita.

11. Në rastet kur emetuesi nuk është i detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, raporti i drejtimit të brendshëm përgatitet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, kur ai hartohet nga shoqëritë për të cilat zbatohen këto dispozita.

12. Për vitet financiare pas datës 1 janar 2028, të gjitha raportet financiare vjetore do të përgatiten, do të depozitohen dhe do të publikohen në një format unik elektronik raportimi pa cenuar kompetencat e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për përcaktimin e formateve kontabël të pasqyrave financiare dhe pa ndryshuar kërkesat e standardeve të zbatueshme të kontabilitetit.

13. Formatimi elektronik i raportimit, i parashikuar në pikën 12 të këtij neni, duhet të jetë në përputhje me standardet teknike rregullatore të miratuara nga Autoriteti për specifikimin e një formati unik elektronik të raportimit, që transponon plotësisht rregulloren e deleguar (BE) 2018/815.

Neni 5

Raportet financiare 6-mujore

1. Emetuesi i aksioneve ose titujve të borxhit publikon një raport që mbulon gjashtëmujorin e parë të vitit financiar, sa më shpejt të jetë e mundur, pas përfundimit të periudhës përkatëse, por jo më vonë 3 muaj nga përfundimi i kësaj



periudhe. Emetuesi sigurohet që raporti 6-mujor të mbetet publik për të paktën 10 vjet.

2. Raporti 6-mujor financiar përfshin:

a) setin e pasqyrave të përmbledhura financiare, individuale apo të konsoliduara, sipas rastit;

b) raportin e ndërmjetëm të drejtimit të brendshëm, si pjesë përbërëse e raportit të ecurisë së veprimtarisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

c) deklaratat e dhëna nga personat përgjegjës të emetuesit, ku jepen qartë emrat dhe funksionet e tyre, në mënyrë që, për aq sa janë në dijeni, seti i pasqyrave të përmbledhura financiare të hartuara në përputhje me standardet përkatëse të kontabilitetit të paraqesë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, pasiveve, pozicionit financiar dhe fitimeve ose humbjeve të emetuesit apo të shoqërive të përfshira në këtë përmbledhje të konsoliduar në tërësi, sipas parashikimit në pikat 3 dhe 4 të këtij neni. Raporti i ndërmjetëm i drejtimit të brendshëm duhet të përmbajë një pasqyrë të drejtë të informacionit, sipas parashikimit në pikën 5 të këtij neni.

3. Në rastet kur emetuesi kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, seti i përmbledhur i pasqyrave financiare duhet të përgatitet në përputhje me standardin ndërkombëtar të kontabilitetit, që zbatohet për raportimin financiar të ndërmjetëm, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

4. Në rastet kur emetuesi nuk kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara, pasqyrat e përmbledhura financiare duhet të përmbajnë të paktën një përmbledhje të bilancit, një pasqyrë të përmbledhur të fitimit dhe të humbjeve dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Për përgatitjen e bilancit dhe pasqyrës së fitimit dhe të humbjeve, emetuesi zbaton të njëjtat parime si gjatë përgatitjes së raporteve financiare vjetore.

5. Raporti i ndërmjetëm i drejtimit të brendshëm përfshin të paktën një përshtkrim të ngjarjeve të rëndësishme, që kanë ndodhur gjatë 6 muajve të parë të vitit financiar dhe ndikimin e tyre në pasqyrat e përmbledhura financiare, së bashku me përshtkrimin e rreziqeve dhe pasigurive kryesore për 6 muajt e mbetur të vitit financiar. Për emetuesit e aksioneve, raporti i ndërmjetëm i

drejtimit të brendshëm duhet të përfshijë edhe transaksionet e rëndësishme me palët e lidhura.

6. Nëse raporti financiar 6-mujor është audituar, raporti i auditimit duhet të paraqitet i plotë. E njëjta gjë vlen edhe në rastin e rishikimit nga audituesit, të kryer sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Në rast se raporti financiar 6-mujor nuk është audituar apo nuk është rishikuar nga audituesit, emetuesi bën një deklaratë në raportin e tij.

Neni 6

Përmbajtja minimale e pasqyrave financiare 6-mujore individuale jo të konsoliduara

1. Përmbajtja minimale e setit të pasqyrave financiare, të përmbledhura 6-mujore, në rastet kur këto pasqyra nuk janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), të miratuara nga organi kompetent i Republikës së Shqipërisë, duke marrë parasysh procedurën e miratimit të standardeve, sipas rregullores (KE) nr. 1606/2002 të Bashkimit Evropian, duhet të jetë në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Bilanci dhe pasqyra e përmbledhur e të ardhurave duhet të përfshijnë të gjithë titujt dhe nëntoatet e përfshira në pasqyrat financiare vjetore më të fundit të emetuesit. Zëra shtesë përfshihen në rastet kur mungesa e tyre do të sillte një paraqitje të pasaktë ose të paplotë të aktiveve, detyrimeve, pozicionit financiar dhe fitimit apo humbjeve të emetuesit.

3. Pasqyrat financiare 6-mujore përfshijnë edhe informacionin krahasues, si më poshtë:

a) bilancin në datën e mbylljes së periudhës së parë 6-mujore të vitit financiar aktual, si dhe bilancin krahasues në datën e mbylljes së vitit financiar paraardhës;

b) pasqyrën e të ardhurave për 6-mujorin e parë të vitit financiar aktual dhe pasqyrën krahasuese për periudhën përkatëse të vitit financiar të mëparshëm.

4. Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare 6-mujore, përfshijnë:

a) informacion të mjaftueshëm për të siguruar krahasueshmërinë midis pasqyrave financiare të përmbledhura 6-mujore dhe pasqyrave financiare vjetore;



b) informacion dhe shpjegime të mjaftueshme për të mundësuar kuptimin e plotë nga ana e përdoruesit të ndryshimeve të rëndësishme të vlerave, si dhe të ndonjë zhvillimi të ndodhur gjatë periudhës 6-mujore në fjalë, të cilat pasqyrohen në bilanc dhe në pasqyrën e fitimit dhe humbjeve.

Neni 7

Transaksionet kryesore me palë të lidhura

1. Në raportet e ndërmjetme të drejtimit të brendshëm, emetuesit e aksioneve duhet të publikojnë si transaksione kryesore me palë të lidhura, të paktën:

a) transaksionet me palë të lidhura, që kanë ndodhur gjatë 6 muajve të parë të vitit aktual financiar dhe që kanë ndikuar ndjeshëm në pozicionin financiar ose në performancën e shoqërisë gjatë asaj periudhe;

b) çdo ndryshim në transaksionet me palë të lidhura, të përshkruara në raportin vjetor të fundit, që mund të ketë një efekt të rëndësishëm për pozicionin financiar ose performancën e shoqërisë gjatë 6 muajve të parë të vitit aktual financiar.

2. Kur emetuesi i aksioneve nuk është i detyruar të përgatisë pasqyrat e konsoliduara, ai publikon minimalisht transaksionet me palë të lidhura sipas kërkesave të legjislacionit për kontabilitetin.

3. Autoriteti miraton rregullore për kriteret për transaksionet kryesore me palë të lidhura që i nënshtrohen detyrimit për publikim.

Neni 8

Raporti për pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore

1. Emetuesit aktivë në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve, të përkufizuar në legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, përgatisin çdo vit një raport për pagesat e kryera ndaj institucioneve shtetërore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të përmendur në këtë nen.

2. Raporti publikohet jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i çdo viti financiar dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun për të paktën 10 vjet. Pagesat ndaj institucioneve shtetërore raportohen në nivel të konsoliduar.

Neni 9

Përgjegjësitë dhe detyrimet

1. Emetuesi dhe anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, sipas kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjës për hartimin, saktësinë, plotësinë dhe publikimin e informacionit, në përputhje me kërkesat e neneve 4, 5, 6, 7, 8 dhe 24 të këtij ligji.

2. Dispozitat e legjislacionit në fuqi, që rregullojnë përgjegjësinë, zbatohen ndaj emetuesve dhe organeve të përmendura në këtë nen ose personave përgjegjës brenda emetuesit.

Neni 10

Përfundime

1. Parashikimet e neneve 4 dhe 5 të këtij ligji nuk zbatohen për emetuesit, si më poshtë:

a) qeverinë e Republikës së Shqipërisë, njësitë e qeverive vendore në Republikën e Shqipërisë, një shtet anëtar i Bashkimit Evropian apo një prej autoriteteve të tij rajonale ose vendore, një organ publik ndërkombëtar, anëtar i të cilit është të paktën një shtet anëtar, Bankën Qendrore Evropiane (ECB), Fondin Evropian të Stabilitetit Financiar (EFSF), i krijuar nga marrëveshja kuadër e EFSF-së, dhe për çdo mekanizëm tjetër të krijuar me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të Bashkimit Monetar Evropian, që ofron ndihmë të përkohshme financiare për shtetet anëtare, monedha e të cilave është euro, si dhe Bankën e Shqipërisë dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare, pavarësisht nëse ato emetojnë aksione apo tituj të tjerë;

b) një emetues ekskluzivisht i titujve të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalente në lekë me 100 000 euro ose kur titujt e borxhit janë të denominuar në një monedhë tjetër nga euro, vlera për njësi në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove.

2. Parashikimet e nenit 5 të këtij ligji mund të mos zbatohen për institucionet e kreditit, aksionet e të cilave nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe të cilat në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur kanë emetuar vetëm tituj borxhi, me kusht që vlera nominale totale e të gjithë këtyre titujve të borxhit të mbetet



nën ekuivalentin në lekë të 10 000 000 eurove dhe nuk kanë publikuar prospekt sipas kërkesave të legjislacionit që rregullon tregjet e kapitalit dhe në përputhje me të drejtën evropiane për prospektin, që publikohet kur titujt i ofrohen publikut ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

3. Pavarësisht parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1 të këtij neni, nenet 4 dhe 5 të këtij ligji nuk zbatohen për emetuesit e titujve të borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove. Në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një monedhë tjetër përveç euros, vlera për njësi në datën e emtimit është e barabartë me të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 50 000 eurove, të cilat janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Bashkimin Evropian, para datës 31 dhjetor 2010, për atë kohë sa këta tituj të borxhit janë në qarkullim.

Neni 11

Mekanizmat e kontrollit të Autoritetit në lidhje me krijuesit e tregut

1. Krijuesi i tregut që kërkon të përfitojë nga përjashtimi i parashikuar në pikën 5, të nenit 12 të këtij ligji, njofton Autoritetin, në cilësinë e autoritetit përgjegjës të shtetit të origjinës së emetuesit, brenda 4 ditëve tregtimi se ai ushtron ose synon të ushtrojë veprimtari të krijimit të tregut për një emetues të caktuar.

Krijuesi i tregut e njofton Autoritetin edhe kur ai ndalon ushtrimin e veprimtarisë së krijimit të tregut për emetuesin përkatës.

2. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, nëse Autoriteti kërkon nga krijuesi i tregut që përfiton nga përjashtimi, sipas pikës 5, të nenit 12 të këtij ligji, të identifikojë aksionet ose instrumentet e tjera financiare të mbajtura për qëllimet e veprimtarisë së krijimit të tregut, krijuesi i tregut kryen identifikimin me çdo mjet të verifikueshëm. Vetëm në rast se krijuesi i tregut nuk është në gjendje të identifikojë aksionet ose instrumentet financiare përkatëse, ai duhet t'i mbajë ato në një llogari të veçantë për qëllime të identifikimit.

3. Pa cenuar zbatimin e shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 36 të këtij ligji, kur sipas legjislacionit kombëtar kërkohet një marrëveshje për krijimin e tregut ndërmjet krijuesit të tregut dhe bursës

dhe/ose emetuesit, krijuesi i tregut, me kërkesë të Autoritetit, vë në dispozicion një kopje të marrëveshjes përkatëse.

KREU III

INFORMACIONI I VAZHDUESHËM

SEKSIONI I

INFORMACION PËR PJESËMARRJET INFLUENCUESE NË KAPITAL

Neni 12

Njoftimi i blerjes ose shitjes së pjesëmarrjeve influencuese në kapital

1. Aksionari që blen ose shet aksionet e emetuesit, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe me të cilat lidhen të drejtat e votës, njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës së emetuesit, që zotërohen nga aksionari si rezultat i blerjes ose shitjes, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie në kufirin prej 5%, 10%, 15%, 20%, 25%, 30%, 50% dhe 75%.

Të drejtat e votës llogariten mbi bazën e të gjitha aksioneve me të cilat lidhen të drejtat e votës, edhe nëse ushtrimi i tyre është pezulluar. Ky informacion jepet edhe për të gjitha aksionet që janë në të njëjtën klasë dhe me të cilat lidhen të drejtat e votës.

2. Aksionari njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie në kufijtë e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si rezultat i ngjarjeve që ndryshojnë përbërjen e të drejtave të votës dhe mbi bazën e informacionit të bërë publik sipas nenit 23 të këtij ligji. Në rast se emetuesi është themeluar në një shtet të tretë, njoftimi bëhet për ngjarje të barasvlershme.

3. Në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e shtetit të origjinës, nuk zbatohet:

a) kufiri prej 30% në rastet kur zbatohet kufiri i një të tretës;

b) kufiri prej 75 % në rastet kur zbatohet kufiri i dy të tretës.

4. Ky nen nuk gjen zbatim për aksionet e blera vetëm për qëllime të klerimit dhe shlyerjes, brenda ciklit të shkurtër të zakonshëm të shlyerjes ose për kujdestarët që mbajnë aksione në cilësinë e tyre të kujdestarit, me kusht që këta kujdestarë të mund



të ushtrojnë vetëm të drejtat e votës që janë të lidhura me këto aksione, sipas udhëzimeve të dhëna me shkrim, ose me anë të mjeteve elektronike. Afati maksimal i ciklit të shkurtër të zakonshëm të shlyerjes është 3 ditë tregtimi pas transaksionit.

5. Ky nen nuk gjen zbatim për blerjen ose shitjen e pjesëmarrjeve influencuese në kapital, që arrijnë ose tejkalojnë kufirin prej 5% nga një krijues tregu që vepron në cilësinë e tij si i tillë, me kusht që:

a) të jetë i licencuar nga Autoriteti apo autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit;

b) të mos ndërhyjë as në administrimin e emetuesit në fjalë, as të ushtrojë ndikim për këtë emetues për blerjen e këtyre aksioneve ose për të mbështetur çmimin e aksioneve.

6. Ky nen nuk gjen zbatim për të drejtat e votës të mbajtura në librin e tregtimit të një institucioni krediti apo shoqërie komisionere, të përkufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjaftueshmërinë e kapitalit të institucioneve të kreditit dhe shoqërive komisionere, me kusht që:

a) të drejtat e votës të mbajtura në librin e tregtimit të mos tejkalojnë 5%;

b) të drejtat e votës të lidhura me aksionet e mbajtura në librin e tregtimit të mos ushtrohen dhe të mos përdoren për të ndërhyrë ose për të ndikuar në drejtimin ose menaxhimin e emetuesit.

Përfshihen nga zbatimi i kësaj pike instrumentet financiare të mbajtura nga një person fizik ose juridik, i cili ekzekuton urdhra të marrë nga klientët, i përgjigjet kërkesës së një klienti për të kryer tregtim jo për llogari të vet (jo mbi bazë pronësore) ose mbulon rrezikun e pozicioneve që lindin nga këto transaksione.

7. Ky nen nuk zbatohet për të drejtat e votës, që lidhen me aksionet e blera për qëllime stabilizimi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, lidhur me përjashtimet për programet e riblerjes dhe stabilizimin e instrumenteve financiare, me kusht që të drejtat e votës, të cilat përkojnë me këto aksione, të mos ushtrohen apo përdoren për të ndërhyrë në drejtimin e emetuesit.

8. Me qëllim llogaritjen e kufirit prej 5%, të parashikuar në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, pjesëmarrjet sipas këtij neni dhe neneve 13 dhe 20

të këtij ligji llogariten si agregate ose bashkohen dhe, në rastin e një grupi shoqërisht, pjesëmarrjet grumbullohen në nivel grupi, sipas parimit të parashikuar në shkronjën “d”, të nenit 13, të këtij ligji.

Neni 13

Përvetësimi ose tjetërsimi i të drejtave të votës

Kërkesat për njoftim, të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 12 të këtij ligji, gjejnë zbatim edhe për personin fizik ose juridik në masën që ai ka të drejtë të përvetësojë, të tjetërsojë ose të ushtrojë të drejtat e votës në cilëndo nga rastet e mëposhtme ose në një kombinim të tyre:

a) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë me të cilin ky person ose subjekt ka lidhur një marrëveshje, e cila i detyron të miratojnë një politikë të përbashkët që zgjat në kohë për drejtimin e emetuesit në fjalë, me anë të ushtrimit të përbashkët të të drejtave të votimit që zotërojnë;

b) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me atë person ose subjekt, që parashikon transferimin e përkohshëm për marrjen në konsideratë të të drejtave të votimit në fjalë;

c) të drejtat e votës që lidhen me aksionet, të cilat i janë dhënë këtij personi ose subjekti si kolateral, me kusht që personi ose subjekti të kontrollojë të drejtat e votimit dhe të deklarojë qëllimin që ka për ushtrimin e tyre;

ç) të drejtat e votës që lidhen me aksionet, në të cilat personi ose subjekti ka interes gjatë jetës (uzufruktin);

d) të drejtat e votës që zotërohen ose mund të ushtrohen në kuptim të shkronjave “a” deri në “ç” të këtij neni nga shoqëria që kontrollohet nga ai person apo subjekt;

dh) të drejtat e votës që lidhen me aksionet e depozituara te ky person ose subjekt, të cilat personi ose subjekti mund t'i ushtrojë sipas gjykimit të tij, në mungesë të udhëzimeve konkrete nga aksionarët;

e) të drejtat e votës që zotërohen nga një person i tretë, në emrin e vet ose për llogari të këtij personi ose subjekti;

ë) të drejtat e votës që personi ose subjekti mund t'i ushtrojë si përfaqësues (*proxy*), kur mund



t'i ushtrojë ato sipas diskrecionit të vet, në mungesë të udhëzimeve specifike nga aksionarët.

Neni 14

Përfshirje për qëllime të politikës monetare

1. Shkronja “c” e nenit 13 të këtij ligji nuk zbatohet për aksionet e dhëna ose të marra nga anëtarët e sistemit evropian të bankave qendrore (në vijim ESCB) gjatë kryerjes së funksioneve të tyre si autoritete monetare, duke përfshirë aksionet e dhëna ose të marra nga anëtarët e ESCB-së, në formën e një garancie, riblerjeje apo një marrëveshjeje të ngjashme për sigurimin e likuiditetit për qëllime të politikës monetare ose brenda një sistemi pagesash.

2. Përfshirja e parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet për transaksionet e mësipërme që zgjasin për një periudhë të shkurtër, me kusht që të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione të mos ushtrohen.

Neni 15

Procedurat e njoftimit dhe publikimit të informacionit për pjesëmarrjet influencuese në kapital

1. Njoftimi i parashikuar në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji përfshin të dhënat e mëposhtme:

- a) gjendjen në lidhje me të drejtat e votës;
- b) zinxhirin e sipërmarrjeve të kontrolluara përmes të cilave zotërohen efektivisht të drejtat e votës, kur ka;
- c) datën kur është arritur ose është tejkaluar kufiri;
- ç) identitetin e aksionarit, edhe nëse aksionari nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e votës sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, si dhe identitetin e personit fizik ose juridik që ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e votës për llogari të këtij aksionari.

2. Emetuesi njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 4 ditë tregtimi pas datës në të cilën aksionari ose personi fizik apo juridik, i parashikuar në nenin 13 të këtij ligji:

- a) merr dijeni për blerjen ose shitjen apo për mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës ose për të cilat duhej të kishte marrë dijeni, duke pasur parasysh rrethanat, pavarësisht datës në të cilën

hyn në fuqi blerja, shitja ose mundësia e ushtrimit të të drejtave të votës; ose

- b) merr njoftim për ngjarjen e parashikuar në pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji.

3. Një sipërmarrje përfshihet nga kryerja e njoftimit të kërkuar, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse njoftimi bëhet nga shoqëria e saj mëmë ose kur vetë shoqëria mëmë është shoqëri e kontrolluar nga shoqëria mëmë e saj.

4. Për qëllim të neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, shoqëria mëmë e një shoqërie administruese nuk kërkohet të bashkojë zotërimet e saj me zotërimet që administron shoqëria administruese, sipas kërkesave të ligjit për sipërmarrjet e investimeve kolektive, me kusht që kjo e fundit të ushtrojë të drejtat e saj të votës në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë.

Nenet 12 dhe 13 të këtij ligji zbatohen në rastet kur shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë ka investuar në zotërimet të administruara nga kjo shoqëri administruese dhe kur kjo e fundit nuk ka diskrecion për të ushtruar të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione dhe mund t'i ushtrojë këto të drejta vetëm sipas udhëzimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë.

5. Shoqëria mëmë e një shoqërie komisionere, e licencuar sipas ligjit për tregjet e kapitalit, nuk kërkohet, për qëllim të përcaktimeve në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, të bashkojë zotërimet e saj me aksionet që kjo shoqëri komisionere administron për llogari të klientëve, në kuptim të ligjit për tregjet e kapitalit, me kusht që:

- a) shoqëria komisionere të jetë e licencuar për administrimin e portofolit individual, sipas kërkesave të ligjit për tregjet e kapitalit;

b) të mund të ushtrojë vetëm të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione, sipas udhëzimeve të dhëna me shkrim apo në mënyrë elektronike, ose të garantojë që shërbimet e administrimit të portofolit individual të ofrohen në mënyrë të pavarur nga çdo shërbim tjetër, në kushte të barasvlershme me ato të parashikuara në legjislacionin për sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, duke caktuar mekanizmat e duhur;

- c) shoqëria komisionere ushtron të drejtat e saj të votës në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë.



Nenet 12 dhe 13 të këtij ligji zbatohen në rastet kur shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë ka investuar në aksione të administruara nga kjo shoqëri komisionere dhe kjo e fundit nuk ka diskrecion për të ushtruar të drejtat e votës që shoqërojnë këto aksione dhe mund t'i ushtrojë këto të drejta vetëm sipas udhëzimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga shoqëria mëmë ose nga një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë.

6. Pas marrjes së njoftimit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, por jo më vonë se 3 ditë tregtimi, emetuesi bën publik të gjithë informacionin që përmban njoftimi.

7. Emetuesi përjashtohet nga parashikimi i pikës 6 të këtij neni nëse informacioni i përfshirë në njoftim publikohet nga Autoriteti menjëherë pas marrjes së tij dhe në çdo rast jo më vonë se tri ditë tregtimi nga data e marrjes së njoftimit, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji.

Neni 16

Aksionarët dhe personat fizikë ose juridikë që detyrohen të njoftojnë për pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital

1. Për qëllim të pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji, detyrimi për njoftim për pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital, që lind në rast se përqindja e të drejtave të votës të mbajtura nga secila palë, arrin, tejkalon ose bie nën pragu e zbatueshëm pas transaksioneve të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji është një detyrim individual, që i takon secilit aksionar ose secilit person fizik ose juridik, siç përmendet në nenin 13 të këtij ligji ose të dyjave në rast se përqindja e të drejtave të votës të mbajtura nga secila palë arrin, tejkalon ose bie nën pragu e zbatueshëm. Në rrethanat e përmendura në shkronjën “a”, të nenit 13 të këtij ligji detyrimi për njoftim do të jetë një detyrim kolektiv i ndarë midis të gjitha palëve në marrëveshje.

2. Në rrethanat e parashikuara në shkronjën “ë”, të nenit 13 të këtij ligji, nëse një aksionar jep prokurën për përfaqësimin në një mbledhje aksionarësh, njoftimi bëhet në momentin e dhënies së prokurës, me kusht që në njoftim të sqarohet se cila do të jetë situata që do të rezultojë në aspektin e të drejtave të votës, kur mbajtësi i prokurës ushtron të drejtat e votës, sipas gjykimit të tij.

3. Nëse në kushtet e përmendura në shkronjën “ë” të nenit 13 të këtij ligji mbajtësi i prokurës merr një ose disa prokura për një mbledhje aksionarësh, njoftimi mund të bëhet me anë të një njoftimi të vetëm në momentin e marrjes së prokurave, me kusht që në njoftim të sqarohet se cila do të jetë situata që do të rezultojë në aspektin e të drejtave të votës kur mbajtësi i prokurës nuk mund të ushtrojë më të drejtat e votës, sipas gjykimit të tij.

4. Kur detyrimi për të bërë një njoftim i takon më shumë se një personi fizik ose juridik, njoftimi mund të bëhet me anë të një njoftimi të vetëm të përbashkët. Megjithatë, përdorimi i një njoftimi të vetëm të përbashkët nuk mund të konsiderohet si lirim nga përgjegjësia i ndonjërit prej personave fizikë ose juridikë të përfshirë në lidhje me njoftimin.

Neni 17

Rrethanat në të cilat personi njoftues duhet të kishte marrë dijeni për blerjen ose shitjen ose për mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës

Për qëllim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 15 të këtij ligji, aksionari ose personi fizik apo juridik, i parashikuar në nenin 13 të këtij ligji, konsiderohet se ka marrë dijeni për blerjen, shitjen ose mundësinë e ushtrimit të të drejtave të votës jo më vonë se dy ditë tregtimi pas kryerjes së transaksionit.

Neni 18

Kushtet e pavarësisë që duhet të përmbushen nga shoqëria administruuese dhe shoqëria komisionere, të përfshira në administrimin e portofolit individual

1. Për qëllimet e përjashtimit nga bashkimi i zotërimeve, të parashikuara në nënparagrafët e parë të pikave 4 dhe 5 të nenit 15 të këtij ligji, shoqëria mëmë e një shoqërie administruuese ose e një shoqërie komisionere duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të mos ndërhyjë drejtpërdrejt ose të tërthorazi duke dhënë udhëzime ose në ndonjë mënyrë tjetër në ushtrimin e të drejtave të votës, të mbajtura nga ajo shoqëri administruuese ose nga shoqërie komisionere;



b) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të jetë e lirë të ushtrojë në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë të drejtat e votës të lidhura me asetet që ajo administron.

2. Shoqëria mëmë, që synon të përfitojë nga përjashtimi, njofton pa vonesë Autoritetin, në cilësinë e autoriteti kompetent të shtetit anëtar të origjinës së emetuesve, të drejtat e votës së të cilëve janë të lidhura me zotërimet e administruara nga shoqëritë administruese ose nga shoqëritë komisionere si më poshtë:

a) një listë të emrave të atyre shoqërive administruese ose shoqërive komisionere, duke treguar autoritetet kompetente që i mbikëqyrin ato, ose që asnjë autoritet kompetent nuk i mbikëqyr ato, por pa iu referuar emetuesve përkatës;

b) një deklaratë që në rastin e secilës shoqërie administruese ose shoqërie komisionere shoqëria mëmë përmbush kushtet e përcaktuara në pikën të këtij neni.

Shoqëria mëmë duhet ta përditësojë listën e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni në mënyrë të vazhdueshme.

3. Kur shoqëria mëmë synon të përfitojë nga përjashtimi vetëm në lidhje me instrumentet financiare të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, ajo duhet t’i njoftojë Autoritetit, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës së emetuesit, vetëm listën e përmendur në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni.

4. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, një shoqëri mëmë e një shoqërie administruese ose e një shoqërie komisionere duhet të jetë në gjendje t’i tregojë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së emetuesit, me kërkesë të tij, se:

a) të drejtat e votës së shoqërisë mëmë, të shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere ushtrohen në mënyrë të pavarur nga shoqëria mëmë;

b) personat që vendosin se si do të ushtrohen të drejtat e votës veprojnë në mënyrë të pavarur;

c) nëse shoqëria mëmë është klient i shoqërisë së saj të administrimit ose shoqërisë komisionere apo zotëron pjesëmarrje në aktivet e administruara nga shoqëria administruese ose nga shoqëria komisionere, ekziston një mandat i qartë me shkrim për një marrëdhënie të pavarur “*armslength*” me klientin me kushte të barabarta

ndërmjet shoqërisë mëmë dhe shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere.

Kërkesa në shkronjën “a” të kësaj pike nënkupton, si minimum, që shoqëria mëmë dhe shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të hartojnë politika dhe procedura me shkrim, në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar shpërndarjen e informacionit ndërmjet shoqërisë mëmë dhe shoqërisë administruese ose shoqërisë komisionere në lidhje me ushtrimin e të drejtave të votës.

5. Për qëllimet e shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni, “udhëzim i drejtpërdrejtë” është çdo udhëzim i dhënë nga shoqëria mëmë ose një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë, që specifikon se si do të ushtrohen të drejtat e votës nga shoqëria administruese ose nga shoqëria komisionere në raste të veçanta. “Udhëzim i tërthortë” është çdo udhëzim i përgjithshëm ose i veçantë, pavarësisht nga forma, i dhënë nga shoqëria mëmë ose nga një shoqëri tjetër e kontrolluar e shoqërisë mëmë, që kufizon diskrecionin e shoqërisë administruese ose të shoqërisë komisionere në lidhje me ushtrimin e të drejtave të votës, në funksion të interesave specifike të biznesit të shoqërisë mëmë ose një shoqërie tjetër të kontrolluar të shoqërisë mëmë.

Neni 19

Instrumentet financiare që i japin mbajtësit të drejtën për të përfituar, vetëm me iniciativën e tij, aksione të lidhura me të drejta vote

1. Njoftimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 20 të këtij ligji duhet të përfshijë informacionin si më poshtë:

a) situatën përfundimtare në lidhje me të drejtat e votës;

b) nëse është e zbatueshme, zinxhirin e ndërmarrjeve të kontrolluara përmes të cilave instrumentet financiare mbahen në mënyrë efektive;

c) datën në të cilën pragu përkatës është arritur ose është kaluar;

ç) për instrumentet që kanë një periudhë ushtrimi, tregimin e datës ose periudhës kohore kur aksionet do të mund të fitohen ose të ushtrohen, nëse është e aplikueshme;



d) datën e maturimit ose të skadimit të instrumentit;

dh) identitetin e mbajtësit;

e) emrin e emetuesit bazë.

Në kuptim të përcaktimeve të shkronjës “a” të kësaj pike, përqindja e të drejtave të votës duhet të llogaritet në raport me numrin total të të drejtave të votës dhe kapitalit, siç është publikuar së fundi nga emetuesi, në përputhje me nenin 23 të këtij ligji.

2. Njoftimi do të kryhet sipas afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 15 të këtij ligji.

3. Njoftimi do t’i dërgohet emetuesit të aksioneve bazë dhe autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës së atij emetuesi.

Në rastet kur një instrument financiar lidhet me më shumë se një aksion bazë, atëherë do të bëhet një njoftim i veçantë për secilin emetues të aksioneve bazë.

Neni 20

Detyrimi për njoftim

1. Kërkesat për njoftim, të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, zbatohen edhe për personat fizikë ose juridikë që zotërojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi:

a) instrumente financiare që pas maturimit i japin zotëruesit të tyre mbi bazën e një marrëveshjeje formale të drejtën e pakushtëzuar për të përfituar ose diskrecionin lidhur me të drejtën e tij për të përfituar aksione të shoqëruara me të drejta vote, të cilat janë emetuar nga një emetues, aksionet e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

b) instrumente financiare, të cilat nuk përfshihen në shkronjën “a” të kësaj pike, por u referohen aksioneve dhe kanë efekt ekonomik të ngjashëm me instrumentet financiare të parashikuara në atë shkronjë, pavarësisht nëse japin ose jo të drejtën e shlyerjes fizike.

Njoftimi i kërkuar përfshin ndarjen sipas llojit të instrumenteve financiare të zotëruara, në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike dhe sipas llojit të instrumenteve financiare të zotëruara, në përputhje me shkronjën “b” të kësaj pike, që bën dallimin ndërmjet instrumenteve financiare, të cilat japin të drejtën e shlyerjes fizike dhe instrumenteve financiare, që japin të drejtën e shlyerjes me mjete monetare (*cash*).

2. Numri i të drejtave të votës përllogaritet duke iu referuar shumës së plotë nominale të aksioneve, që janë në bazë të instrumentit financiar, përveçse kur instrumenti financiar parashikon vetëm shlyerjen me mjete monetare (*cash*), rast në të cilin numri i drejtave të votës përllogaritet mbi bazën e një “koeficienti delta të korrigjuar”, duke shumëzuar shumën nominale të aksioneve bazë me koeficientin delta të instrumentit. Për këtë qëllim zotëruesi bashkon dhe njofton të gjitha instrumentet financiare që lidhen me të njëjtin emetues bazë. Për përllogaritjen e të drejtave të votës merren në konsideratë vetëm pozicionet afatgjata. Pozicionet afatgjata nuk kompensohen me pozicionet afatshkurtra të të njëjtit emetues bazë.

Të drejtat e votës, të përmendura në këtë pikë, në rastin e një instrumenti financiar, të referuar ndaj një shporte aksionesh ose një indeksi, llogariten mbi bazën e peshës së aksionit në shportën e aksioneve ose në indeks kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) të drejtat e votës në një emetues të caktuar, të mbajtura nëpërmjet instrumenteve financiare, të referuara ndaj shportës ose indeksit, përfaqësojnë 1% ose më shumë të të drejtave të votës që u bashkëlidhen aksioneve të atij emetuesi;

b) aksionet në shportë ose në indeks përfaqësojnë 20% ose më shumë të vlerës së titujve në shportë ose në indeks.

Kur një instrument financiar i referohet një serie shportash aksionesh ose indeksesh, të drejtat e votës, të mbajtura përmes shportave ose indekseve individuale, nuk grumbullohen për qëllimet e pragjeve të përcaktuara në këtë pikë.

3. Numri i të drejtave të votës që lidhen me instrumente financiare, të cilat parashikojnë ekskluzivisht shlyerje në para dhe kanë një profil linear e simetrik kthimi në raport me aksionin bazë, llogaritet mbi bazë të rregulluar, sipas deltës, ku pozicioni në para konsiderohet i barabartë me 1.

Numri i të drejtave të votës që lidhen me një instrument financiar të shlyer ekskluzivisht në para, i cili nuk ka një profil linear e simetrik kthimi në raport me aksionin bazë, llogaritet mbi bazë të rregulluar sipas deltës, duke përdorur një model standard çmimi të pranuar gjerësisht.

Një model standard çmimi i pranuar gjerësisht është një model që përdoret zakonisht në



industrinë financiare për atë instrument financiar dhe që është mjaftueshëm i qëndrueshëm për të marrë parasysh elementet që janë të rëndësishme për vlerësimin e instrumentit. Elementet që janë të rëndësishme për vlerësimin përfshijnë të paktën:

- a) normën e interesit;
- b) pagesat e dividendëve;
- c) kohën deri në maturim;
- ç) paqëndrueshmërinë (*volatilitetin*);
- d) çmimin e aksionit bazë.

Gjatë përcaktimit të deltës, mbajtësi i instrumentit financiar duhet të sigurojë që:

- i. modeli i përdorur të mbulojë kompleksitetin dhe rrezikun e çdo instrumenti financiar;
- ii. i njëjti model të përdoret në mënyrë të qëndrueshme për llogaritjen e numrit të të drejtave të votës për një instrument financiar të caktuar.

Sistemet e teknologjisë së informacionit të përdorura për kryerjen e llogaritjes së deltës duhet të sigurojnë raportim të qëndrueshëm, të saktë dhe në kohë të të drejtave të votës.

Numri i të drejtave të votës llogaritet çdo ditë duke marrë parasysh çmimin e fundit të mbylljes së aksionit bazë. Mbajtësi i instrumentit financiar njofton emetuesin kur arrin, tejkalon ose bie nën pragjet e parashikuara në pikën 1, të nenit 12 të këtij ligji.

4. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, nëse plotësohet një prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” ose “b” të kësaj pike, konsiderohen si instrumente financiare:

- a) titujt e transferueshëm;
- b) kontratat e opsioneve (*option*);
- c) kontratat e së ardhmes (*future*);
- ç) kontratat e shkëmbimit (*swap*);
- d) marrëveshjet për normat e ardhshme të këmbimit (*forward rate*);
- dh) kontratat për diferencë;
- e) çdo kontratë ose marrëveshje tjetër me efekte ekonomike të ngjashme, e cila mund të shlyhet fizikisht apo me mjete monetare.

Autoriteti publikon një listë treguese të instrumenteve financiare, që u nënshtrohen kërkesave për njoftim, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, duke marrë në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare, hartuar dhe përditësuar periodikisht nga Autoriteti Evropian i Tregjeve të Titujve (në vijim ESMA).

5. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme të zbatimit të pikës 1 të këtij neni dhe për të marrë parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare, Autoriteti harton rregulla, në përputhje me standarde teknike zbatuese të hartuara nga ESMA, me qëllim përcaktimin e formateve standarde, modeleve dhe procedurave standarde, që përdoren kur njoftohet informacioni i kërkuar tek emetuesi, sipas pikës 1 të këtij neni, ose kur depozitohet informacioni në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 27 të këtij ligji.

6. Përjashtimet e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6, të nenit 12 dhe në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 15 zbatohen rast pas rasti për kërkesat për njoftim sipas këtij neni.

Neni 21

Bashkimi i të drejtave të votës/agregimi

1. Kërkesat për njoftim, të përcaktuara në nenet 12, 13 dhe 20 të këtij ligji, zbatohen edhe për personat fizikë ose juridikë, kur numri i të drejtave të votës, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky person apo subjekt, sipas neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, së bashku me numrin e të drejtave të votës, që lidhen me instrumentet financiare, të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sipas nenit 20 të këtij ligji, arrin, tejkalon apo bie nën kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji.

Njoftimi i kërkuar në këtë pikë duhet të përfshijë ndarjen e numrit të të drejtave të votës, që përkojnë me aksionet e zotëruara, në përputhje me parashikimet e neneve 12 dhe 13 të këtij ligji, dhe të drejtat e votës që lidhen me instrumentet financiare, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji.

2. Të drejtat e votës që lidhen me instrumentet financiare të njoftuara, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, i nënshtrohen një njoftimi të ri kur personi fizik ose juridik ka përfituar aksionet bazë dhe si rezultat i këtij përfitimi numri total i të drejtave të votës, të lidhura me aksionet e emetuara nga i njëjti emetues, arrin ose tejkalon kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të këtij ligji.



Neni 22

Detyrimi për publikim i emetuesit

1. Nëse një emetues i aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, blen ose shet aksionet e veta, vetë ose nëpërmjet një personi, që vepron në emër të tij, por për llogari të emetuesit, emetuesi bën publik përqindjen e aksioneve të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 4 ditë tregtimi pas blerjes ose shitjes, kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën kufirin prej 5% ose 10% të të drejtave të votës. Përqindja llogaritet në bazë të numrit total të aksioneve me të cilat lidhen të drejtat e votës.

2. Autoriteti miraton rregullore për përcaktimin e rregullave të detajuara në zbatim të përcaktimeve në këtë nen, duke marrë në konsideratë aktet e deleguara të Komisionit Evropian në fushën përkatëse, si dhe duke pasur parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare.

Neni 23

Publikimi i të drejtave të votës

Për qëllim të llogaritjes së kufijve të parashikuar në nenin 12 të këtij ligji, emetuesi për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës publikon numrin total të të drejtave të votës dhe të kapitalit në fund të çdo muaji kalendarik gjatë të cilit ka pasur një rritje ose ulje të numrit total.

Neni 24

Informacione shtesë

1. Emetuesi i aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar publikon pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat që lidhen me klasa të ndryshme të aksioneve, duke përfshirë ndryshimet në të drejtat që lidhen me titujt derivativë, të emetuar nga vetë emetuesi, që japin akses në aksionet e tij.

2. Emetuesi i titujve të tjerë, përveç aksioneve, të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, bën publike pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat e mbajtësit të titujve të tjerë përveç aksioneve, duke përfshirë ndryshimet në kushtet dhe termat e këtyre titujve, që mund të ndikojnë në mënyrë indirekte te këto të drejta, që lindin veçanërisht

nga ndryshimi i termave të huas ose i normave të interesit.

Seksioni II

Informacioni për mbajtësit e titujve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

Neni 25

Kërkesat për informacion nga emetuesit, aksionet e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i aksioneve të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar siguron trajtim të barabartë për të gjithë mbajtësit e aksioneve që kanë të njëjtin pozicion.

2. Emetuesi siguron vënien në dispozicion të të gjitha mjeteve dhe informacioneve të nevojshme për ushtrimin e të drejtave të mbajtësve të aksioneve në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e saj si shtet i origjinës, si dhe garanton ruajtjen e integritetit të të dhënave. Aksionarët nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është themeluar emetuesi. Veçanërisht emetuesi duhet:

a) të informojë për vendin, orën dhe agjendën e mbledhjeve, numrin e përgjithshëm të aksioneve dhe të drejtave të votimit, si dhe të drejtat e mbajtësve për të marrë pjesë në mbledhje;

b) të vërë në dispozicion një formular përfaqësimi, në formë fizike ose, kur është rasti, përmes mjeteve elektronike për çdo person me të drejtë vote në asamblenë e aksionarëve së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, kur kërkohet, pas shpalljes së mbledhjes;

c) të caktojë si agjent një institucion financiar, përmes të cilit aksionarët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare;

ç) të publikojë njoftime ose të shpërndajë informacion lidhur me shpërndarjen dhe pagesën e dividendëve dhe emetimin e aksioneve të reja, përfshirë informacion për rregullat e caktimit të pjesës, nënshkrimin, anulimin ose konvertimin.

3. Për qëllim të përcjelljes së informacionit te aksionarët, emetuesi mund të përdorë mjete elektronike me kusht që vendimi të merret në asamblenë e përgjithshme dhe të përmbushë të paktën kriteret si më poshtë:



a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimit të aksionarit ose, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “e”, të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji, të personave fizikë ose juridikë;

b) miratohen rregulla identifikimi në mënyrë që aksionarët ose personat fizikë apo juridikë, me të drejtë ushtrimi apo drejtimi të ushtrimit të të drejtave të votës, të informohen në mënyrë efektive;

c) aksionarët ose, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “e”, të pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji, personat fizikë apo juridikë që kanë të drejtën e blerjes, shitjes apo ushtrimit të të drejtave të votës, kontaktohen me shkrim për t’u kërkuar miratimin për përdorimin e mjeteve elektronike për përcjelljen e informacionit dhe, në rast se ata nuk kundërshtojnë brenda një afati të arsyeshëm, por jo më të gjatë se 2 javë, miratimi i tyre konsiderohet i dhënë. Ata mund të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni t’u përcillet me shkrim;

ç) çdo shpërndarje e kostos që përfshin përcjellja e këtij informacioni me anë të mjeteve elektronike përcaktohet nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Autoriteti miraton me rregullore rregulla të detajuara për zbatimin e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, në përputhje me aktet e miratuara nga Komisioni Evropian në këtë fushë e duke marrë në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Në veçanti, Autoriteti përcakton llojet e institucioneve financiare nëpërmjet të cilave aksionarët mund të ushtrojnë të drejtat financiare, të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 2 të këtij neni.

Neni 26

Kërkesat për informacion për emetuesit, titujt e borxhit të të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar

1. Emetuesi i titujve të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar sigurohet që të gjithë mbajtësit e titujve të borxhit, me renditje “*pari passu*” marrin trajtim të barabartë sa u takon të drejtave që lidhen me këta tituj borxhi.

2. Emetuesi sigurohet që të gjitha mjetet dhe informacioni i nevojshëm, që u mundësohet mbajtësve të titujve të borxhit të ushtrojnë të drejtat e tyre në Republikën e Shqipërisë, në cilësinë e vendit të origjinës, janë të vlefshme publikisht dhe se do të ruhet integriteti i të dhënave. Mbajtësit e titujve të borxhit nuk ndalohen të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes përfaqësimit sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është themeluar emetuesi. Veçanërisht emetuesi duhet:

a) të publikojë njoftimet ose të shpërndajë informacion lidhur me vendin, orën dhe agjendën e mbledhjeve të mbajtësve të titujve të borxhit, pagesën e interesit, ushtrimin e të drejtave të konvertimit, këmbimit, nënshkrimit ose anulimit e shlyerjen, si dhe të drejtën e këtyre mbajtësve për të marrë pjesë në to;

b) të vërë në dispozicion formularin e përfaqësimit në formë shkresore ose, kur është e mundur, me anë të mjeteve elektronike për çdo person me të drejtë vote në mbledhjen e mbajtësve të titujve të borxhit, së bashku me njoftimin për mbledhjen ose, me kërkesë, pas njoftimit të mbledhjes;

c) të caktojë si agent një institucion financiar përmes të cilit mbajtësit e titujve të borxhit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre financiare.

3. Nëse në mbledhje ftohen vetëm mbajtësit e titujve të borxhit, vlera për njësi e të cilëve arrin të paktën ekuivalentin në lekë të 100 000 eurove, në rastin e titujve të borxhit, në monedhë të ndryshme nga euro, vlera për njësi e të cilëve në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove, emetuesi mund të zgjedhë si vendndodhje cilindo shtet anëtar, me kusht që në atë shtet anëtar të vihen në dispozicion të gjitha mjetet dhe informacionet e nevojshme për t’u mundësuar këtyre mbajtësve ushtrimin e të drejtave të tyre.

Zgjedhja e emetuesit, e parashikuar në këtë pikë, zbatohet gjithashtu për titujt e borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove, ose, në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një valutë tjetër të ndryshme, ku vlera e kësaj njësie në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 50 000 eurove, të cilët janë pranuar tashmë për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, përpara datës 31



dhjetor 2010, për aq kohë sa këta tituj borxhi janë në qarkullim, me kusht që të gjithë mekanizmat dhe informacionet e nevojshme për t'u mundësuar mbajtësve të tyre ushtrimin e të drejtave të tyre të vihen në dispozicion në shtetin anëtar të zgjedhur nga emetuesi.

4. Për qëllime të përcjelljes së informacionit të mbajtësit e titujve të borxhit, emetuesit mund të përdorin mjete elektronike me kusht që vendimi për këtë të merret nga asambleja e përgjithshme dhe të përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) përdorimi i mjeteve elektronike nuk varet në asnjë mënyrë nga vendndodhja e selisë ose vendqëndrimi i mbajtësit të titujve të borxhit apo të ndërmjetësit që përfaqëson këtë mbajtës;

b) miratimi i rregullave të identifikimit, në mënyrë që mbajtësit e titujve të borxhit të informohen në mënyrë efektive;

c) mbajtësit e titujve të borxhit kontaktohen me shkrim për të kërkuar miratimin e tyre për përdorimin e mjeteve elektronike të përcjelljes së informacionit dhe, në rast se nuk paraqesin kundërshtim brenda një afati të arsyeshëm, miratimi i tyre do të konsiderohet i dhënë. Ata kanë mundësi të kërkojnë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni të përcillet me shkrim;

ç) ndarjet e kostove, që përfshin përcjellja e informacionit përmes mjeteve elektronike, do të përcaktohen nga emetuesi në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

5. Autoriteti miraton rregulla në përputhje me aktet e deleguara të Komisionit Evropian, që marrin në konsideratë zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe zhvillimet në teknologjinë e informacionit e të komunikimit për të garantuar zbatimin e pikave 1 deri në 4 të këtij neni. Në veçanti, ai specifikon llojet e institucioneve financiare nëpërmjet të cilave mbajtësit e titujve të borxhit mund të ushtrojnë të drejtat financiare të parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 2 të këtij neni.

Seksioni III

Detyrime të përgjithshme

Neni 27

Kontrolli nga Autoriteti

1. Kur emetuesi ose çdo person që ka kërkuar pranimin e titujve të tij për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, dhe për të cilin Republika e Shqipërisë është shteti i origjinës, publikon informacion të rregulluar, ai e depoziton njëkohësisht këtë informacion pranë Autoritetit.

2. Autoriteti mund të publikojë në faqen zyrtare të internetit informacionin e depozituar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni që do t'i përcillet emetuesit, në përputhje me nenet 12, 13, 15 dhe 20, të këtij ligji, duhet të depozitohet njëkohësisht në Autoritet.

Neni 28

Gjuhët për publikimin dhe komunikimin e informacionit të rregulluar

1. Kur titujt janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar vetëm në Republikën e Shqipërisë, si shtet i origjinës së emetuesit, çdo informacion i rregulluar, mbështetur në këtë ligj, publikohet në gjuhën shqipe.

2. Kur titujt janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar edhe në Republikën e Shqipërisë, si shtet i origjinës, edhe në një ose më shumë shtete anëtare, si shtete pritëse, çdo informacion i rregulluar, në mbështetje të këtij ligji, do të publikohet:

a) në gjuhën shqipe;

b) në varësi të zgjedhjes së emetuesit, në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të atyre shteteve anëtare pritëse ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

3. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, por jo në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, informacioni i rregulluar, në varësi të zgjedhjes së tregut nga emetuesit, publikohet në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

Gjithashtu, informacioni i rregulluar, sipas parashikimeve të kësaj pike, në varësi të zgjedhjes së emetuesit, publikohet në territorin e Republikës



së Shqipërisë në një gjuhë të pranuar nga Autoriteti, në këtë rast në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze, si gjuhë e zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare.

4. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, pa miratimin e emetuesit, detyrimi i parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk i takon emetuesit, por personit që ka kërkuar pranimin pa miratimin e emetuesit.

5. Aksionarët dhe personat fizikë ose juridikë të përmendur në nenet 12, 13 dhe 20 të këtij ligji lejohet t'u përcjellin emetuesve informacionet, sipas këtij ligji, në gjuhën shqipe ose vetëm në një gjuhë të përhapur në fushën e financave ndërkombëtare. Nëse emetuesi e merr këtë njoftim, ai nuk është i detyruar të sigurojë një përkthim në gjuhën shqipe.

6. Si përjashtim nga pikat 1 deri 4 të këtij neni, kur titujt që kanë vlerë për njësi, të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 100 000 eurove, ose në rastin e titujve të borxhit të shprehur në monedhë të ndryshme nga euro kanë vlerë për njësi ekuivalente me të paktën vlerën në lekë të 100 000 eurove në datën e emetimit dhe pranohen për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare, informacioni i rregulluar i jepet publikut në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse dhe nga Autoriteti, ose në një gjuhë të zakonshme në fushën e financave ndërkombëtare, të zgjedhur nga emetuesi ose personi i cili ka kërkuar pranimin për tregtim pa miratimin e emetuesit.

7. Përjashtimi i përmendur në pikën 6 të këtij neni zbatohet edhe për titujt e borxhit, vlera nominale për njësi e të cilëve është të paktën ekuivalenti në lekë i 50 000 eurove, ose në rastin e titujve të borxhit të denominuar në një valutë tjetër nga euroja, vlera e kësaj njësie në datën e emetimit është ekuivalente me të paktën vlerën ekuivalente në lekë të 50 000 eurove, të cilët janë pranuar tashmë për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare përpara datës 31 dhjetor 2010, për aq kohë sa këta tituj borxhi janë në qarkullim.

8. Nëse pranë një gjykate të Republikës së Shqipërisë apo një shteti anëtar paraqitet një vepër në lidhje me përmbajtjen e informacionit të rregulluar, përgjegjësia për pagesën e kostove të përkthimit të këtij informacioni për qëllimet e procedimeve vendoset në përputhje me

legjislacionin e Republikës së Shqipërisë apo shtetit anëtar.

Neni 29

Aksesi në informacionin e rregulluar

1. Emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, publikon informacionin e rregulluar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses të shpejtë dhe mbi baza jodiskriminuese të këtij informacioni dhe e vendos atë në dispozicion të mekanizmit të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni.

Emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa miratimin e emetuesit, nuk mund t'u vendosë asnjë kosto të posaçme investitorëve për ofrimin e këtij informacioni. Emetuesi përdor mjete komunikimi, që mbi baza të arsyeshme konsiderohen të besueshme për shpërndarjen efektive të informacionit të publiku në Republikën e Shqipërisë dhe në të gjitha shtetet anëtare. Sidoqoftë, nuk është detyrim përdorimi vetëm i atyre mjeteve të komunikimit (medieve), operatorët e të cilëve janë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti cakton një apo më shumë mekanizma zyrtarë për ruajtjen qendrore të informacionit, të rregulluar në formën e një regjistri. Ky mekanizëm duhet të jetë në përputhje me standardet minimale të cilësisë për sa i përket mbrojtjes, sigurisë së burimit të informacionit, regjistrimit të kohës dhe lehtësisë së aksesit nga përdoruesit fundorë dhe në harmoni me procedurën e depozitimit sipas pikës 1 të nenit 27 të këtij ligji.

3. Emetuesi paraqet informacionin e plotë të rregulluar njëkohësisht me publikimin pranë Autoritetit dhe mekanizmit zyrtar qendror të caktuar prej Autoritetit.

4. Mekanizmi zyrtar i informacionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë mbahet nga Autoriteti, i cili e publikon informacionin e rregulluar në faqen zyrtare të tij.

5. Pavarësisht parashikimit të pikës 1 të këtij neni, mekanizmi zyrtar i informacionit të rregulluar mund të mbahet edhe nga një person juridik tjetër, i cili është miratuar nga Autoriteti, me kusht që të plotësojë kërkesat teknike, të



sigurisë, organizative dhe kushte të tjera për mbajtjen e mekanizmit zyrtar të informacionit të rregulluar, si dhe të sigurojë që aksesimi i informacionit të rregulluar në nivelin e Bashkimit Evropian të mos cenohet.

6. Kur titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar me vendndodhje dhe që operon vetëm në Republikën e Shqipërisë si shtet pritës dhe jo si shtet i origjinës, emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, e publikon informacionin e rregulluar në përputhje me kërkesat e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

7. Autoriteti miraton rregullore duke marrë në konsideratë aktet e deleguara të Komisionit Evropian për specifikimin e:

a) standardeve minimale të shpërndarjes së informacionit të rregulluar, siç përmendet në pikën 1 të këtij neni;

b) standardeve minimale për mekanizmin qendror të ruajtjes, siç përmendet në pikën 2 të këtij neni;

c) rregullave që garantojnë ndërveprimin e informacionit dhe teknologjive të komunikimit të përdorura nga mekanizmat e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, si dhe aksesin në informacionin e rregulluar në nivelin e Bashkimit Evropian të përmendur në të.

Neni 30

Standardet minimale

1. Për qëllime të parashikimeve të pikës 1, të nenit 29 të këtij ligji, shpërndarja e informacionit të rregulluar kryhet në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në pikat 2 deri në 5 të këtij neni.

2. Informacioni i rregulluar duhet të shpërndahet në mënyrë të tillë që të sigurojë akses të një publik sa më i gjerë dhe në të njëjtën kohë sa më afër të jetë e mundur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shtetit të origjinës, ose në shtetin anëtar të parashikuar në pikën 6, të nenit 29 të këtij ligji, si dhe në shtetet e tjera anëtare.

3. Informacioni i rregulluar duhet t'u komunikohet medieve në tekst të plotë të pa edituar. Në rastin e raporteve dhe deklaratave të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse

njoftimi për informacionin e rregulluar i komunikohet medies dhe tregon se në cilën faqe interneti, përveç mekanizmit të caktuar zyrtarisht për ruajtjen qendrore të informacionit, të rregulluar në nenin 29 të këtij ligji, janë të disponueshme dokumentet përkatëse.

4. Informacioni i rregulluar duhet t'i komunikohet medies në një mënyrë që të garantojë sigurinë e komunikimit, të minimizojë rrezikun e korrupsionit të të dhënave dhe aksesit të paautorizuar, si dhe të ofrojë siguri në lidhje me burimin e informacionit të rregulluar.

Siguria e marrjes duhet të garantohet duke korrigjuar sa më shpejt të jetë e mundur çdo dështim ose ndërprerje në komunikimin e informacionit të rregulluar.

Emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim, për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, nuk do të jetë përgjegjës për gabimet sistemike ose mangësitë në medien të cilës i është komunikuar informacioni i rregulluar.

5. Informacioni i rregulluar duhet t'u komunikohet medieve në një mënyrë që e bën të qartë se informacioni është informacion i rregulluar, identifikon qartë emetuesin përkatës, objektin e informacionit të rregulluar dhe kohën e datën e komunikimit të informacionit nga emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim në tregtim në një treg të rregulluar pa pëlqimin e emetuesit.

Me kërkesë, emetuesi ose personi që ka aplikuar për pranim në tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, duhet të jetë në gjendje t'i komunikojë Autoritetit për çdo publikim në lidhje me informacionin e rregulluar, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e personit që ia ka komunikuar informacionin medies;

b) detajet e validimit të sigorisë;

c) orën dhe datën në të cilën informacioni iu komunikua medies;

ç) mjetin në të cilin u komunikua informacioni;

d) nëse është e aplikueshme, detajet e çdo embargoje të vendosur nga emetuesi për informacionin e rregulluar.



Neni 31

Bashkërendimi me sistemin evropian të aksesit

1. Aksesit në informacionin e rregulluar në nivel të Bashkimit Evropian sigurohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe me dispozitat e këtij ligji.

2. Rregullat për aksesin dhe transmetimin e informacionit përmes pikës evropiane të aksesit elektronik (ESAP) përcaktohen në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 32

Aksesit i informacionit përmes pikës evropiane të aksesit elektronik (ESAP)

1. Autoriteti siguron që kur publikohet informacioni i rregulluar, i parashikuar në pikën 1 të nenit 29 të këtij ligji, emetuesi ose personi që ka paraqitur kërkesën për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, pa pëlqimin e emetuesit, e dorëzon atë informacion të rregulluar njëkohësisht të njësisë që mbledh informacionin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, me qëllim që informacioni të jetë i aksesueshëm në pikën e vetme evropiane të aksesit (ESAP), e krijuar sipas rregullores (BE) 2023/2859 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2. Informacioni i rregulluar duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) të dorëzohet në një format të dhënash të ekstraktueshme, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 2 të rregullores (BE) 2023/2859 ose, kur kërkohet nga ligji i Bashkimit ose ligji kombëtar, në një format të lexueshëm nga makineria, siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 2 të asaj rregulloreje;

b) të shoqërohet me të dhënat/metadatat e mëposhtme:

i. të gjithë emrat e personave fizikë ose juridikë, të cilëve u referohet informacioni;

ii. identifikuesi ligjor i subjektit (LEI), siç specifikohet në nenin 7(4), pika (b), të rregullores (BE) 2023/2859;

iii. madhësia e emetuesit, sipas kategorisë, siç specifikohet sipas nenit 7(4), pika (d), të rregullores (BE) 2023/2859;

iv. sektori/ët i/e industrisë së aktiviteteve ekonomike të emetuesit, siç specifikohet sipas nenit 7 (4), pika (e), të rregullores BE 2023/2859;

v. lloji i informacionit, siç klasifikohet sipas nenit 7(4), pika (c), të rregullores (BE) 2023/2859;

vi. një indikacion nëse informacioni përmban të dhëna personale.

3. Për qëllim të nënndarjes “i” të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, emetuesit duhet të sigurojnë një kod identifikues të subjektit ligjor (LEI).

4. Për qëllim të bërjes të aksesueshëm në ESAP të informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, njësisë që mbledh informacionin, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të rregullores (BE) 2023/2859, do të jetë mekanizmi zyrtar i caktuar sipas pikës 2 të nenit 29 të këtij ligji.

5. Autoriteti siguron që informacioni i parashikuar në pikën 1 të nenit 42 të këtij ligji të bëhet i aksesueshëm në ESAP. Për këtë qëllim, njësisë mbledhëse e informacionit, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të rregullores të (BE) 2023/2859, do të jetë Autoriteti.

Neni 33

Aksesit në informacionin e rregulluar në nivel BE-je

Autoriteti harton rregulla në përputhje me rregulloren e deleguar (BE) 2016/1437 të Komisionit, bazuar në standardet teknike rregullatore të ESMA-së, të cilat përcaktojnë kërkesat teknike në lidhje me aksesin në informacionin e rregulluar në nivel BE-je për të specifikuar:

a) kërkesat teknike në lidhje me teknologjitë e komunikimit të përdorura nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

b) kërkesat teknike për vënien në funksion të pikës qendrore të aksesit për kërkimin e informacionit, të rregulluar në nivel BE-je;

c) kërkesat teknike në lidhje me përdorimin e një identifikuesi unik për çdo subjekt ligjor nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

ç) formatin standard për dorëzimin e informacionit të rregulluar nga mekanizmat e përmendur në pikën 2, të nenit 29 të këtij ligji;

d) klasifikimin e përbashkët të informacionit të rregulluar nga mekanizmat e përmendur në pikën



2, të nenit 29 të këtij ligji dhe listën e përbashkët të llojeve të informacionit të rregulluar.

Neni 34 Vendet e treta

1. Kur selia e regjistruar e emetuesit ndodhet në një vend të tretë për të cilin Republika e Shqipërisë është vendi i origjinës, Autoriteti mund ta përjashtojë këtë emetues nga kërkesat e neneve 4, 5, 6, 7, 8, 9, 13, pikat 6, 18, 21, 22, 23 dhe 24 të këtij ligji, me kusht që legjislacioni i vendit të tretë në fjalë të përcaktojë kërkesa ekuivalente me kërkesat e këtij ligji ose që ky emetues të përmbushë kërkesat e legjislacionit të një vendi të tretë që Autoriteti e konsideron si ekuivalent në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e vlerësimit të ekuivalencës.

2. Autoriteti njofton ESMA-n për përjashtimin e dhënë sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni i mbuluar nga kërkesat e përcaktuara në vendin e tretë paraqitet në përputhje me nenin 27 të këtij ligji dhe publikohet në përputhje me parashikimet e neneve 28 dhe 29 të këtij ligji.

4. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, një emetues, selia e regjistruar e të cilit ndodhet në një vend të tretë, përjashtohet nga përgatitja e pasqyrave të tij financiare në përputhje me parashikimet e neneve 4 ose 5 të këtij ligji, me kusht që ky emetues t'i përgatisë pasqyrat e tij financiare në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, që merr në konsideratë nenin 9 të rregullores (KE) nr. 1606/2002.

5. Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës, siguron që informacioni i publikuar në një vend të tretë, që mund të jetë i rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë dhe publikun në BE, publikohet në përputhje me nenet 28 dhe 29 të këtij ligji, edhe nëse ky informacion nuk rregullohet sipas përkufizimit të informacionit të rregulluar, në kuptim të shkronjës “gj” të pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji.

6. Sipërmarrjet që e kanë selinë e tyre të regjistruar në një vend të tretë, të cilat do të kishin kërkuar autorizim në përputhje me legjislacionin në fuqi për sipërmarrjet e investimeve kolektive ose sa i përket administrimit të portofolit sipas

legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit, nëse do ta kishin selinë e regjistruar ose, vetëm në rastin e një shoqërie komisionere, selinë qendrore brenda Bashkimit Evropian, përjashtohen nga detyrimi për të agreguar zotërimet me zotërimet e sipërmarrjes mëmë sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 15, me kusht që ato të përmbushin kushte të barasvlershme të pavarësisë si shoqëri administruese ose shoqëri komisionere.

7. Për të siguruar kushte të njëtrajtshme të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa zbatuese që përcaktojnë:

a) mekanizmin për vlerësimin e ekuivalencës së informacionit të kërkuar sipas këtij ligji, përfshirë pasqyrat financiare dhe informacionin e kërkuar, rregulloreve ose dispozitave administrative të një vendi të tretë;

b) deklarin se për shkak të së drejtës së tij të brendshme, rregulloreve, dispozitave administrative ose praktikave apo procedurave, të bazuara në standardet ndërkombëtare të vendosura nga organizatat ndërkombëtare, vendi i tretë, ku është regjistruar emetuesi, siguron ekuivalencën e kërkesave të informacionit të parashikuara në këtë ligj.

8. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa që lidhen me vlerësimin e standardeve përkatëse për emetuesit e më shumë se një shteti.

9. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian merr vendimet e nevojshme për ekuivalencën e standardeve të kontabilitetit dhe për ekuivalencën e standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë, siç parashikohet në legjislacionin kombëtar që transponon nenin 29b të Direktivës 2013/34/BE.

10. Nëse Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian vendos se standardet e kontabilitetit ose standardet e raportimit të qëndrueshmërisë së një shteti të tretë nuk janë ekuivalente, ai mund t'u lejojë emetuesve përkatës të vazhdojnë përdorimin e këtyre standardeve gjatë një periudhe kalimtare të përshtatshme. Periudhat kalimtare dhe kushtet e përdorimit të standardeve joekuivalente përcaktohen me rregullore nga Autoriteti.

11. Autoriteti në përputhje me rregullat e Komisionit Evropian miraton masa që synojnë vendosjen e kriterëve të përgjithshme të



ekuivalencës në lidhje me standardet e kontabilitetit dhe standardet e raportimit të qëndrueshmërisë, të rëndësishme për emetuesit e më shumë se një shteti.

12. Kriteret minimale që përdor Autoriteti për vlerësimin e ekuivalencës së standardeve të raportimit të qëndrueshmërisë të emetuesve të vendeve të treta sigurojnë të paktën:

a) që sipërmarrjet të zbulojnë informacion për faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG);

b) zbulimin e informacionit të nevojshëm për të kuptuar ndikimet e sipërmarrjes për çështjet e qëndrueshmërisë dhe se si çështjet e qëndrueshmërisë ndikojnë në zhvillimin, ecurinë dhe pozicionin e saj.

Neni 35

Kërkesat ekuivalente

1. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 4 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi raporti vjetor i drejtimit të brendshëm kërkohet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) një analizë të drejtë të zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe të pozicionit të tij, së bashku me një përshkrim të rreziqeve dhe pasigurive kryesore me të cilat përballlet, në mënyrë të tillë që shqyrtimi të paraqesë një analizë të balancuar dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe performancës së biznesit të emetuesit dhe të pozicionit të tij, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit;

b) një indikacion të çdo ngjarjeje të rëndësishme që ka ndodhur nga fundi i vitit financiar;

c) indikacion të zhvillimit të mundshëm të ardhshëm të emetuesit.

Analiza e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, në masën e nevojshme për të kuptuar zhvillimin, performancën ose pozicionin e emetuesit, duhet të përfshijë si treguesit financiarë, ashtu edhe, kur është e përshtatshme, treguesit jofinanciarë kryesorë të performancës që lidhen me biznesin e veçantë.

2. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në

pikën 4 të nenit 5 të këtij ligji kur legjislacioni i tij kërkon përgatitjen e një seti të përmbledhur pasqyrash financiare së bashku me një raport të ndërmjetëm të menaxhimit, i cili përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) vlerësimin e periudhës së mbuluar;

b) treguesit mbi zhvillimin e mundshëm të ardhshëm të emetuesit për 6 muajt e mbetur të vitit financiar;

c) për emetuesit e aksioneve, transaksionet kryesore me palët e lidhura, nëse këto nuk janë bërë më parë publike në mënyrë të vazhdueshme.

3. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 4 dhe në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji, kur sipas ligjit të atij vendi një person ose persona brenda emetuesit janë përgjegjës për informacionin financiar vjetor dhe 6-mujor dhe në veçanti për sa vijon:

a) përputhshmërinë e pasqyrave financiare me kuadrin e raportimit ose setin e standardeve të kontabilitetit në fuqi;

b) drejtësinë e vlerësimit/analizës së menaxhimit të përfshirë në raportin e drejtimit të brendshëm.

4. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi nuk kërkohet ofrimi i llogarive individuale nga kompania mëmë, por emetuesi, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet, në përgatitjen e llogarive të konsoliduara, të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) për emetuesit e aksioneve, llogaritjen e dividendëve dhe aftësinë për të paguar dividendë;

b) për të gjithë emetuesit, kur është e aplikueshme, kërkesat minimale të kapitalit dhe kapitalit dhe çështjet e likuiditetit.

Për qëllime të ekuivalencës, emetuesi duhet të jetë gjithashtu në gjendje t'i ofrojë Autoritetit deklarime shitesë të audituara, që japin informacion për llogaritë individuale të emetuesit si një të vetme, relevante për elementet e informacionit, të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike. Këto deklarime mund të përgatiten sipas standardeve të kontabilitetit të vendit të tretë.

5. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në



pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji për llogaritë individuale kur sipas ligjit të një vendi të tretë një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, nuk kërkohet të përgatisë llogari të konsoliduara, por kërkohet të përgatisë llogaritë e tij individuale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të njohura nga legjislacioni i fushës, që merr në konsideratë nenin 3 të rregullores (KE) nr. 1606/2002, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, siç zbatohet në Republikën e Shqipërisë dhe brenda Komunitetit Evropian ose me standardet kombëtare të kontabilitetit të vendeve të treta ekuivalente me ato standarde.

Për qëllime të ekuivalencës, nëse informacioni i tillë financiar nuk është në përputhje me ato standarde, ai duhet të paraqitet në formën e pasqyrave financiare të rishikuara. Për më tepër, llogaritë individuale duhet të auditohen në mënyrë të pavarur.

6. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në pikën 6 të nenit 15 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi periudha kohore brenda së cilës një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, duhet të njoftohet për zotërimet kryesore dhe brenda së cilës duhet t'ia zbulojë publikut këto zotërimë kryesore është në total jo më shumë se 7 ditë tregtimi. Afatet kohore për njoftimin e emetuesit dhe për publikimin e mëtejshëm të publiku nga emetuesi mund të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të nenit 15 dhe pikën 6, të nenit 15 të këtij ligji.

7. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë deri në një maksimum prej 5% të aksioneve të veta, me të cilat janë të bashkëngjitura të drejtat e votës, ai duhet të bëjë një njoftim sa herë që arrihet ose tejkalohet ky prag;

b) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë deri në një maksimum prej 5% dhe 10% të aksioneve të veta, me të cilat janë të bashkëngjitura të drejtat e votës, ai duhet të bëjë një njoftim sa herë që arrihet ose tejkalohet një prag prej 5% ose ai prag maksimal;

c) në rastin e një emetuesi, të cilit i lejohet të mbajë më shumë se 10% të aksioneve të veta, të cilave u bashkëngjiten të drejtat e votës, ai duhet të bëjë njoftim sa herë arrihet ose tejkalohet pragu prej 5% ose pragu prej 10%.

Për qëllime të ekuivalencës, nuk kërkohet njoftim mbi prapun prej 10%.

8. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi, një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet t'i zbulojë publikut numrin e përgjithshëm të të drejtave të votës dhe kapitalin brenda 30 ditëve kalendarike pasi të ketë ndodhur një rritje ose ulje e këtij numri të përgjithshëm.

9. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kërkesa ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 25, pika 2, dhe 26, pika 2, të këtij ligji, për sa i përket përmbajtjes së informacionit në lidhje me mbledhjet, kur, sipas ligjit të atij vendi, një emetues, selia e të cilit është e regjistruar në atë vend të tretë, kërkohet të ofrojë të paktën informacion për vendin, kohën dhe rendin e ditës së mbledhjeve.

10. Një vend i tretë konsiderohet se vendos kushte pavarësie ekuivalente me ato të përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 15 të këtij ligji kur sipas ligjit të atij vendi një shoqëri administruese ose shoqëri komisionere kërkohet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të jetë e lirë në të gjitha situatat për të ushtruar në mënyrë të pavarur nga shoqëria e saj mëmë të drejtat e votës të lidhura me asetet që ajo administron;

b) shoqëria administruese ose shoqëria komisionere duhet të mos konsiderojë interesat e shoqërisë mëmë ose të çdo shoqërie tjetër të kontrolluar të shoqërisë mëmë sa herë që lindin konflikte interesi.

Shoqëria mëmë duhet të përmbushë kërkesat e njoftimit të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 18 të këtij ligji.

Përveç kësaj, ajo duhet të bëjë një deklaratë se në rastin e secilës shoqëri administrimi ose shoqërie komisionere në fjalë shoqëria mëmë i përmbush kushtet e përcaktuara në këtë paragraf.

11. Pa cenuar zbatimin e nenit 36 të këtij ligji, shoqëria mëmë duhet të jetë në gjendje që me kërkesë të Autoritetit t'i provojë këtij të fundit, në



cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës së emetuesit, se janë respektuar kërkesat e përcaktuara në pikën 4 të nenit 18 të këtij ligji.

KREU IV KOMPETENCAT E AUTORITETIT

Neni 36

Autoritetet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre

1. Autoriteti është autoriteti kompetent për zbatimin e kërkesave të këtij ligji.

2. Me qëllim kryerjen e funksioneve të tij, Autoriteti ka kompetencën:

a) t'u kërkojë audituesve, emetuesve, zotëruesve të aksioneve ose instrumenteve të tjera financiare apo personave ose subjekteve, të përmendura në nenet 13, 14, 15 dhe 20 të këtij ligji, dhe personave që i kontrollojnë ose kontrollohen prej tyre sigurimin e informacioneve dhe dokumenteve;

b) t'i kërkojë emetuesit të publikojë informacionin e kërkuar sipas shkronjës "a" të kësaj pike me anë të mjeteve dhe brenda afateve kohore që Autoriteti konsideron të nevojshme. Ai mund ta publikojë këtë informacion me iniciativën e tij në rastet kur emetuesi ose personat që e kontrollojnë ose kontrollohen nga ai nuk arrijnë ta bëjnë këtë dhe pasi ka dëgjuar emetuesin;

c) t'u kërkojë drejtuesve të emetuesve dhe të zotëruesve të aksioneve ose instrumenteve të tjera financiare apo të personave ose subjekteve, të përmendura në nenet 13, 14, 15 dhe 20 të këtij ligji, të përcjellin informacionin e kërkuar dhe, nëse është e nevojshme, të sigurojnë informacione dhe/ose dokumente shtesë;

ç) të pezullojë ose t'i kërkojë tregut të rregulluar përkatës të pezullojë tregtimin e titujve për një maksimum prej dhjetë ditësh të njëpasnjëshme, nëse ka arsye që të dyshojë se dispozitat e këtij ligji janë shkelur nga emetuesi;

d) të ndalojë tregtimin në një treg të rregulluar nëse konstaton ose nëse ka arsye që të dyshojë se janë shkelur dispozitat e këtij ligji;

dh) të monitorojë që emetuesi publikon në kohë informacionet, me qëllim garantimin e aksesit efikas dhe të barabartë të publikut në të gjitha shtetet anëtare, ku tregtohen titujt dhe, në rast të kundërt, të marrë masat e duhura;

e) të bëjë publik faktin që një emetues, zotërues aksionesh apo instrumentesh të tjera financiare, ose një person apo subjekt, i parashikuar në nenet 13 deri në 15 të këtij ligji, nuk po përmbush detyrimet e tij;

ë) të verifikojë që informacioni i përmendur në këtë ligj është hartuar në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit dhe të marrë masat e duhura në rast të konstatimit të shkeljeve;

f) të kryejë inspektime në vend në territorin e tij, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me dispozitat e këtij ligji dhe masat e tij zbatuese.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, Autoriteti në çdo rast mund t'u drejtohet organeve gjyqësore në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

4. Autoriteti ushtron kompetencat e tij të përcaktuara në këtë nen në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) drejtpërdrejt;

b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;

c) me delegim tek autoritete të tjera, nën përgjegjësinë e tij;

ç) me kërkesë të autoriteteve gjyqësore kompetente.

5. Pikat 1 deri në 4 të këtij neni nuk e cenojnë mundësinë që një shtet anëtar të bëjë rregullime të veçanta ligjore dhe administrative për territoret evropiane jashtë vendit për të cilat marrëdhëniet e jashtme janë përgjegjësi e atij shteti anëtar.

6. Dhënia e informacionit Autoritetit nga audituesit për ndonjë fakt ose vendim në lidhje me kërkesa të bëra nga Autoriteti, sipas shkronjës "a", të pikës 2 të këtij neni, nuk do të përbëjë shkelje të ndonjë kufizimi për dhënien e informacionit të vendosur nga kontrata ose nga ndonjë ligj, rregullore apo dispozitë administrative dhe nuk do t'i bëjë këta auditues të përgjegjshëm në ndonjë formë.

Neni 37

Sekreti profesional dhe bashkëpunimi midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare

1. Personat që punojnë ose kanë punuar për Autoritetin, si dhe entitete tek të cilët Autoriteti mund të ketë deleguar detyra të caktuara janë subjekt i detyrimit të sekretit profesional. Informacioni konfidencial i marrë në këtë mënyrë



nuk mund të zbulohet ndaj asnjë personi apo autoriteti tjetër, përveç rasteve të përcaktuara në ligj, rregullore apo dispozita administrative

2. Autoriteti bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve anëtare sa herë që është e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave të tij dhe ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj. Autoriteti u jep mbështetje/asistencë autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare.

3. Gjatë ushtrimit të kompetencave hetimore dhe sanksionuese, Autoriteti bashkëpunon me autoritetet kompetente të shteteve anëtare për të siguruar që sanksionet dhe masat japin rezultatet e dëshiruara dhe koordinojnë veprimet e tyre kur trajtojnë raste ndërkufitare.

4. Autoriteti dhe autoritetet e tjera kompetente mund t'i drejtohen ESMA-s në rastet kur një kërkesë për bashkëpunim është refuzuar ose nuk është zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, sipas kompetencave të përcaktuara me rregulloren (BE) nr. 1095/2010. Pa paragjykuar nenin 258 të Traktatit për Funksimin e BE-së, ESMA mund të veprojë sipas kompetencave të saj të dhëna në nenin 19 të rregullores (BE) nr. 1095/2010.

5. Autoriteti bashkëpunon me ESMA-n për qëllim të këtij ligji në përputhje me rregulloren (BE) nr. 1095/2010.

6. Autoriteti i jep pa vonesë ESMA-s të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e detyrave të saj, sipas këtij ligji dhe rregullores (BE) nr. 1095/2010.

7. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni nuk e pengon Autoritetin të shkëmbejë apo të përcjellë informacion konfidencial tek autoritetet e tjera kompetente, tek ESMA dhe te Bordi Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB). Çdo informacion i shkëmbyer në këtë mënyrë mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional, subjekt i të cilit janë punonjësit aktualë apo ish-punonjësit e autoriteteve kompetente që marrin informacionin.

8. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente ose organet e vendeve të treta, të mundësuar në bazë të legjislacionit të tyre përkatës, për përmbushjen e çdo detyre, sipas këtij ligji, në përputhje me parashikimet e nenit 36 të këtij ligji. Shkëmbimi i informacioni kryhet me qëllim përmbushjen e funksioneve mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente apo organeve të

përmendura dhe është subjekt i garantimit të sekretit profesional, të paktën i barasvlershëm me atë që përmendet në këtë nen, kur:

a) lidh marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit me autoritetet kompetente ose organet e vendeve të treta, Autoriteti njofton ESMA-n;

b) informacioni buron nga një shtet anëtar tjetër, ai nuk mund të zbulohet pa dakordësinë e shprehur të autoriteteve kompetente që e kanë zbuluar atë dhe, kur është e përshtatshme, vetëm për qëllimet për të cilat këto autoritete kanë dhënë dakordësinë e tyre.

Neni 38

Masat paraprake

1. Kur Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit pritës, zbulon se një emetues ose mbajtësi i aksioneve apo i instrumenteve të tjera financiare të tij, ose një person apo entitet, i përmendur në nenin 13 të këtij ligji, ka kryer parregullsi ose ka shkelur detyrimet, ai i referon gjetjet tek autoriteti kompetent përkatës i shtetit anëtar të origjinës dhe tek ESMA.

2. Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i vendit anëtar të origjinës ose për shkak se këto masa rezultojnë të pamjaftueshme, emetuesi ose mbajtësi i titujve vijon të shkelë dispozitat ligjore apo rregullatore përkatëse, Autoriteti, në cilësinë e autoritetit kompetent të shtetit pritës, pasi informon autoritetin kompetent të shtetit të origjinës, merr të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e investitorëve dhe informon Komisionin Evropian dhe ESMA-n sa më shpejt të jetë e mundur.

KREU V

SHKELJET E DISPOZITAVE

Neni 39

Masat mbikëqyrëse dhe sanksionet

1. Në rast të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji, Autoriteti vendos masa mbikëqyrëse dhe sanksione si më poshtë:

a) publikon një deklaratë që identifikon personin fizik ose juridik përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;



b) urdhëron personin fizik ose juridik përgjegjës të korrigjojë shkeljen brenda një afati të caktuar dhe të mos e përsërisë më atë;

c) vendos sanksion me gjobë.

2. Masat administrative dhe sanksionet sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.

3. Pa cenuar parashikimet e nenit 9 të këtij ligji, kur detyrimet e parashikuara në këtë ligj u ngarkohen personave juridikë, Autoriteti siguron që në rast shkeljeje sanksionet dhe masat mbikëqyrëse të parashikuara në këtë ligj të mund të zbatohen ndaj anëtarëve të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të personit juridik, si dhe ndaj personave të tjerë fizikë përgjegjës për shkeljen, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Pa cenuar kompetencat e Autoritetit të parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe zbatimin e dispozitave penale sipas legjislacionit në fuqi, Autoriteti mund të pezullojë ushtrimin e së drejtës së votës që lidhet me aksionet në rastin e shkeljeve të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji, kur këto shkelje vlerësohen si të rënda.

Neni 40

Sanksionet me gjobë

1. Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 500 000 lekë deri në 4 000 000 lekë ndaj subjektit juridik nëse:

a) në kundërshtim me nenin 4 të këtij ligji, nuk publikon raportin financiar vjetor brenda afatit ligjor dhe/ose nuk e paraqet atë pranë Autoritetit, si dhe nuk siguron që raporti financiar vjetor të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

b) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji, raporti financiar vjetor nuk përmban informacionin e kërkuar nga ky nen;

c) në kundërshtim me nenin 5 të këtij ligji, nuk publikon raportin financiar 6-mujor brenda afatit ligjor dhe/ose nuk e paraqet atë pranë Autoritetit, si dhe nuk siguron që raporti financiar 6-mujor të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

ç) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, raporti financiar 6-mujor nuk përmban informacionin e kërkuar;

d) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 12 të këtij ligji, nuk njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës që zotëron, kur si rezultat i blerjes ose shitjes së aksioneve kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën pragjet prej 5%, 10%, 15%, 20%, 25%, 30%, 50% dhe 75% për aksionet e një emetuesi, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

dh) në kundërshtim me pikën 2 të nenit 12 të këtij ligji, nuk njofton emetuesin për përqindjen e të drejtave të votës që zotëron kur kjo përqindje arrin, tejkalon ose bie nën pragjet prej 5%, 10%, 15%, 20%, 25%, 30%, 50% dhe 75%, si rezultat i ngjarjeve që ndryshojnë përbërjen e të drejtave të votës ose numrin e të drejtave të votës të lidhura me aksionet;

e) në kundërshtim me pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji, nuk përgatit raportin për pagesat që bëhen ndaj institucioneve shtetërore, kur ushtron veprimtari në industrinë nxjerrëse ose në industrinë primare të prerjes së pyjeve;

ë) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 8 të këtij ligji, nuk e bën publik raportin për pagesat që bëhen ndaj institucioneve shtetërore brenda afatit ligjor dhe nuk siguron që ai të mbetet i disponueshëm publikisht për të paktën 10 vjet;

f) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 11 të këtij ligji, nuk njofton Autoritetin se vepron ose synon të veprojë si krijues tregu për një emetues të caktuar brenda afatit ligjor, si dhe nuk zbaton detyrimet sipas nenit 13 të këtij ligji.

g) në kundërshtim me pikën 3, të nenit 11 të këtij ligji, me kërkesë të Autoritetit, nuk vë në dispozicion marrëveshjen e krijimit të tregut të lidhur me operatorin e tregut dhe/ose emetuesin;

gj) në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të këtij ligji, nuk njofton Autoritetin;

h) në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji, nuk publikon informacionin për ndryshimet dhe numrin e ri total të aksioneve me të drejta vote brenda afatit të parashikuar;

i) në kundërshtim me pikën 6, të nenit 15 të këtij ligji, nuk bën publik brenda afatit ligjor informacionin e përfshirë në njoftimin e marrë për zotërimet e mëdha ose pjesëmarrjet e rëndësishme në kapital;

j) në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji, nuk paraqet pranë Autoritetit informacionin e rregulluar të paraqitur pranë emetuesit;



k) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 18 të këtij ligji, nuk paraqet pranë Autoritetit listën e shoqërive administruese dhe/ose shoqërive komisionere së bashku me deklaratën për përmbushjen e kushteve të pavarësisë;

l) në kundërshtim me pikën 3 të nenit 18 të këtij ligji, nuk përditëson në mënyrë të vazhdueshme listën e përmendur në këtë nen;

ll) në kundërshtim me nenin 22 të këtij ligji, në rast të blerjes ose shitjes së aksioneve të veta, nuk bën publik përqindjen e aksioneve të veta brenda afatit ligjor;

m) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk publikon informacionin për vendin, kohën dhe rendin e ditës së mbledhjeve të aksionarëve;

n) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk vë në dispozicion formularin e prokurës për aksionarët;

nj) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk cakton një institucion financiar si agjent për ushtrimin e të drejtave financiare të aksionarëve;

o) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji, nuk publikon njoftime lidhur me dividendët dhe emetimin e aksioneve të reja;

p) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 26 të këtij ligji, nuk siguron trajtim të barabartë për zotëruesit e titujve të borxhit që renditen *pari passu*;

q) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji, nuk publikon informacionin e kërkuar për mbledhjet dhe të drejtat e zotëruesve të titujve të borxhit;

r) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji, nuk vë në dispozicion formularin e prokurës për zotëruesit e titujve të borxhit;

rr) në kundërshtim me pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji, nuk cakton një institucion financiar si agjent për ushtrimin e të drejtave financiare të zotëruesve të titujve të borxhit;

s) në kundërshtim me pikën 1, të nenit 29 të këtij ligji, nuk i paraqet Autoritetit informacionin e rregulluar për publikim;

sh) në kundërshtim me nenin 23 të këtij ligji, nuk e paraqet informacionin e rregulluar në gjuhën shqipe kur titujt janë pranuar për tregtim vetëm në Republikën e Shqipërisë;

t) në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji, nuk bën publik pa vonesë çdo ndryshim në të drejtat

që lidhen me aksionet ose instrumentet derivative që japin të drejtë për akses në aksione;

th) në kundërshtim me nenin 29 të këtij ligji, nuk publikon informacionin e rregulluar në mënyrë që të sigurojë akses të shpejtë, të barabartë dhe jodiskriminues dhe nuk e vë atë në dispozicion të mekanizmit qendror të ruajtjes së informacionit.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, në rastet e shkeljeve shumë të rënda, të cilat cenojnë ose rrezikojnë seriozisht integritetin e tregut financiar, shkaktojnë çrregullim të rëndë të tregut ose kanë sjellë përfitime të konsiderueshme materiale, duke cenuar mbrojtjen e investitorëve, transparencën e tregut ose funksionimin e rregullt të tij, Autoriteti mund të vendosë, në mënyrë të arsyetuar, sanksion me gjobë:

a) 100 000 000 lekë ose deri në 5% të totalit të xhiros vjetore, sipas pasqyrave financiare më të fundit të disponueshme të miratuara nga organi drejtues apo të xhiros vjetore, sipas pasqyrave të konsoliduara të miratuara nga organi drejtues i shoqërisë mëmë; ose

b) deri në dyfishin e shumës së fitimeve të nxjerra ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, kur këto mund të përcaktohen, cilado qoftë shuma më e madhe, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike.

3. Për shkeljet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni Autoriteti vendos sanksion me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë ndaj personit fizik apo personit përgjegjës të subjektit.

4. Pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, në rastet e shkeljeve shumë të rënda, të cilat cenojnë ose rrezikojnë seriozisht integritetin e tregut financiar, shkaktojnë çrregullim të rëndë të tregut ose kanë sjellë përfitime të konsiderueshme materiale, duke cenuar mbrojtjen e investitorëve, transparencën e tregut ose funksionimin e rregullt të tij, Autoriteti mund të vendosë, në mënyrë të arsyetuar, sanksion me gjobë:

a) 20 000 000 lekë; ose

b) deri në dyfishin e shumës së fitimeve të nxjerra ose humbjeve të shmangura për shkak të shkeljes, kur këto mund të përcaktohen, cilado qoftë shuma më e madhe, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike.



Neni 41

Kriteret për vendosjen e sanksioneve administrative

1. Në përcaktimin e llojit dhe nivelit të sanksioneve administrative, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse duke përfshirë, sipas rastit:

- a) shkallën dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- b) shkallën e përgjegjësisë së personit fizik ose subjektit juridik përgjegjës;
- c) situatën financiare të personit fizik ose juridik përgjegjës, të treguar nga xhiroja vjetore totale e subjektit juridik përgjegjës ose nga të ardhurat vjetore të personit fizik përgjegjës;
- ç) rëndësinë e të ardhurave të fituara ose të humbjeve të shmangura nga personi fizik ose juridik përgjegjës, nëse ato mund të përcaktohen;
- d) humbjet që u janë shkaktuar palëve të treta nga shkeljet, nëse ato mund të përcaktohen;
- dh) nivelin e bashkëpunimit të personit fizik ose subjektit juridik përgjegjës me autoritetin;
- e) shkeljet e mëparshme nga personi fizik ose subjekti juridik përgjegjës.

2. Përpunimi i të dhënave personale, të marra me qëllim ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse dhe hetimore administrative, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 42

Publikimi i vendimeve

1. Autoriteti publikon pa vonesë në faqen zyrtare të internetit çdo vendim për sanksionet administrative të vendosura për shkelje të këtij ligji, duke përfshirë të paktën informacionin për llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personave fizikë ose juridikë përgjegjës për shkeljen.

Autoriteti mund të shtyjë publikimin e vendimit ose të vendosë publikimin e tij në formë anonime kur konstaton se ekziston të paktën një nga rrethanat e mëposhtme:

a) në rast se sanksioni vendoset ndaj një personi fizik dhe publikimi i të dhënave personale rezulton të jetë joproporcional ose cenues, bazuar në një vlerësim paraprak të detyrueshëm të proporcionalitetit;

b) publikimi do të rrezikonte seriozisht stabilitetin e sistemit financiar ose një hetim në vazhdim;

c) publikimi, për aq sa mund të përcaktohet, do të shkaktonte dëme joproporcionale dhe serioze për institucionet ose personat fizikë të përfshirë.

2. Nëse apelohehet kundër vendimit të publikuar, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Autoriteti ose duhet të përfshijë informacion në lidhje me këtë në publikim në kohën e publikimit, ose ta ndryshojë publikimin nëse apelimi ndërmerret pas publikimit fillestar.

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Aktet nënligjore

Autoriteti miraton rregulloret në zbatim të këtij ligji brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi e tij.

Neni 44

Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji, të cilat lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e mekanizmave dhe infrastrukturës së Bashkimit Evropian, zbatohen plotësisht nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian si më poshtë:

- a) neni 31;
- b) pikat 1, 4 dhe 5, të nenit 32;
- c) neni 33;
- ç) pikat 4, 5, 6, 7 dhe shkronja “a” e pikës 8 të nenit 37;

d) çdo dispozitë tjetër e këtij ligji, që parashikon detyrime për Autoritetin në lidhje me njoftimet ose raportimet drejtuar Autoritetit Evropian të Tregjeve të Titujve (ESMA); bashkimit, ndërveprimin ose integrimin e mekanizmit zyrtar të ruajtjes qendrore të informacionit të rregulluar me pikën e vetme evropiane të aksesit (ESAP); zbatimin e drejtpërdrejtë të procedurave të përcaktuara nga Komisioni Evropian për nivelin e Bashkimit Evropian.

2. Dispozitat që lidhen me ESMA-n, njoftimin e saj dhe mekanizmat në nivel BE-je të ekuivalencës, sipas nenit 34 të këtij ligji, do të



zbatohen nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, të gjitha detyrimet e emetuesve dhe personave të tjerë, sipas parashikimeve të këtij ligji, përfshirë kërkesat për publikim dhe depozitim të informacionit të rregulluar në mekanizmin zyrtar të ruajtjes qendrore, zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 45
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Bordi i Autoritetit shfuqizon rregulloren “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”, miratuar me vendimin nr. 5, datë 26.1.2023.

Neni 46
Hyryra në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç dispozitave të parashikuara në nenin 44 të këtij ligji, të cilat fillojnë efektet juridike pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekreten nr. 458, datë 30.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 458, datë 30.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 80/2026, “Për kërkesat e transparencës për emetuesit e titujve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 84/2026

PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9251,
DATË 8.7.2004, “KODI DETAR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

1. Kudo në ligj ku është përdorur emërtimi “Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me emërtimin “ministri përgjegjës për transportin”.

2. Kudo në ligj ku është përdorur emërtimi “Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve” zëvendësohet me emërtimin “Administrata Detare.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhet ndryshimi dhe shtesat, si më poshtë:

a) Titulli i nenit ndryshohet dhe titullohet “Përkufizime”;

b) Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“5. “**Administrata Detare**” është autoriteti kompetent shtetëror i Republikës së Shqipërisë, përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me instrumentet detare ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare, përfshirë Kodin për Zbatimin e Instrumenteve të IMO-s (III Code), në ushtrimin e funksioneve të shtetit të flamurit, shtetit portual dhe shtetit bregdetar.



6. **“Autoritet Portual”** është autoriteti publik i krijuar me ligj për administrimin, zhvillimin dhe funksionimin e infrastrukturës portuale.

7. **“Delegim i funksioneve teknike”** është transferimi i kompetencave të caktuara teknike nga Administrata Detare tek një organizatë e njohur, pa cenuar përgjegjësinë përfundimtare të shtetit.

8. **“Dritarja e Vetme Kombëtare Detare”** është platforma teknike e krijuar dhe e përdorur në nivel kombëtar për marrjen, shkëmbimin dhe përcjelljen elektronike të informacionit për të përmbushur detyrimet e raportimit, e cila përfshin administrimin e të drejtave të aksesit që përcaktohen në mënyrë të përbashkët, një modul ndërfaqeje raportimi dhe një ndërfaqe grafike të përdoruesit të harmonizuar për komunikimin me deklaruesit, si dhe lidhjet me sistemet dhe bazat e të dhënave relevante të autoriteteve në nivel kombëtar dhe në nivel të Bashkimit Evropian, që mundëson që deklaruesve t’u komunikohen mesazhe ose konfirmime që mbulojnë gamën më të gjerë të vendimeve të marra nga të gjitha autoritetet pjesëmarrëse relevante dhe e cila mund të lejojë, gjithashtu, aty ku është e aplikueshme, lidhjen me mjete të tjera raportuese.

9. **“Infrastrukturë detare dhe nënujore”** është tërësia e pasurive, objekteve, instalimeve, strukturave, pajisjeve, kablllove, tubacioneve, sistemeve dhe rrjeteve të vendosura në, mbi ose nën sipërfaqen e detit apo në shtratin e tij, që shërbejnë ose mbështesin lundrimin, veprimtarinë portuale, prodhimin, transmetimin, depozitimin dhe shpërndarjen e energjisë, komunikimet elektronike, furnizimin, monitorimin, kërkimin shkencor, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë, mbrojtjen kombëtare ose ushtrimin e veprimtarive të tjera në hapësirën detare, pavarësisht regjimit të pronësisë ose mënyrës së administrimit të tyre.

10. **“Infrastrukturë portuale”** është tërësia e pasurive, objekteve, sistemeve dhe rrjeteve tokësore dhe detare, që shërbejnë për administrimin, funksionimin, sigurinë, mbrojtjen, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve portuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: basenet portuale, kanalet hyrëse, dallgëthyesit, kalatat, terminalët, pontilet, vendankorimet, rrugët, hekurudhat, magazinat dhe objektet e depozitimit, zonat logjistike dhe intermodale, rrjetet dhe

objektet energjetike, infrastrukturën e furnizimit me energji elektrike, ujë, karburante dhe lëndë të tjera energjetike, rrjetet e telekomunikacionit dhe komunikimeve elektronike, sistemet e teknologjisë së informacionit, monitorimit dhe automatizimit, si dhe çdo pasuri, objekt, sistem ose rrjet tjetër të lidhur funksionalisht me administrimin, funksionimin ose zhvillimin e portit.

11. **“Organizatë e njohur”** janë persona juridikë të autorizuar nga Administrata Detare për të kryer në emër të saj funksione të klasifikimit, kontrollit, inspektimit dhe certifikimit të anijeve.

12. **“Organizata Ndërkombëtare Detare”** (IMO) është agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, përgjegjëse për zhvillimin dhe miratimin e standardeve ndërkombëtare për sigurinë detare, mbrojtjen e mjedisit detar dhe lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar.

13. **“Sistemi i monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS)”** është sistemi i informacionit dhe monitorimit të trafikut detar të anijeve.

14. **“SOLAS”** është Konventa Ndërkombëtare për Shpëtimin e Jetës në Det e vitit 1974, me ndryshimet përkatëse, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 9213, datë 1.4.2004.

15. **“STCW”** është Konventa Ndërkombëtare për Standardet e Trajnimit, Certifikimit dhe Vrojtimit për Detarët, 1978 (STCW 78/95), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8596, datë 20.1.2000.”.

Neni 3

Në nenin 30, pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Mbikëqyrja e sigurisë së objekteve portuale ushtrohet nga autoriteti kompetent shtetëror, në përputhje me Kodin Ndërkombëtar për Sigurinë e Anijeve dhe Objekteve Portuale (*ISPS Code*) dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurinë në anije dhe porte.

6. Autoriteti kompetent kryen miratimin e vlerësimeve dhe planeve të sigurisë së objekteve portuale, auditimet, inspektimet, verifikimet e përputhshmërisë dhe ushtron kompetencat e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.



7. Autoriteti Portual dhe operatorët e objekteve portuale nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent shtetëror marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kërkesave të sigurisë portuale.”.

Neni 4

Në nenin 31, pikat 1, 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Autoriteti Portual siguron administrimin, zhvillimin, mirëmbajtjen, modernizimin dhe funksionimin e një ose më shumë porteve dhe infrastrukturës portuale përkatëse. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Autoriteti Portual realizon drejtimin administrativ të veprimtarisë në fushat e detarisë dhe të zonave detare përkatëse, si dhe bashkërendon marrëdhëniet me Administratën Detare, Rojën Bregdetare, organet e tjera shtetërore, operatorët portualë dhe subjektet e tjera që ushtrojnë veprimtari në port.

2. Autoriteti Portual në përputhje me kompetencat e tij:

a) administron dhe zhvillon portet, infrastrukturën dhe pasuritë portuale që i janë ngarkuar në administrim;

b) organizon, koordinon dhe rregullon funksionimin e shërbimeve portuale, përdorimin efikas të infrastrukturës portuale dhe veprimtarinë e operatorëve portualë;

c) planifikon përdorimin dhe zhvillimin e hapësirës portuale, të infrastrukturës portuale, zonave logjistike dhe intermodale, duke promovuar investimet, inovacionin dhe integrimin e tyre me rrjetet kombëtare, rajonale dhe evropiane të transportit;

ç) aplikon regjim tarifor të shërbimeve dhe infrastrukturës portuale, në përputhje me këtë Kod dhe legjislacionin në fuqi;

d) garanton akses në infrastrukturë dhe shërbime portuale në administrim të tij për ushtrimin e veprimtarisë nga Administrata Detare, Roja Bregdetare dhe autoritetet e tjera kompetente për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë si shtet i flamurit, shtet portual dhe shtet bregdetar në përputhje me këtë Kod, legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;

dh) siguron ndërveprueshmërinë dhe shkëmbimin e informacionit në administrim të tij

nëpërmjet sistemeve kombëtare dhe ndërkombëtare të informacionit detar, në përputhje me këtë Kod dhe legjislacionin në fuqi.

3. Autoriteti Portual krijohet dhe organizohet me ligj të posaçëm, i cili përcakton natyrën juridike, organizimin, kompetencat, fushën territoriale dhe funksionale të administrimit, si dhe mënyrën e funksionimit të tij.”.

Neni 5

Në nenin 32, pika 2, shkronja “v” shfuqizohet.

Neni 6

Pas nenit 32 shtohen nenet 32/1, 32/2 dhe 32/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 32/1

Sistemi i Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të anijeve (VTMIS)

1. Sistemi i Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të Anijeve (VTMIS) ka për qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi monitorimi dhe informacioni për trafikun e anijeve, me synim:

a) rritjen e sigurisë së navigimit, mbrojtjen e jetës në det dhe efikasitetin e trafikut detar;

b) përmirësimin e reagimit të autoriteteve ndaj incidenteve, aksidenteve apo situatave potencialisht të rrezikshme në det, përfshirë operacionet e kërkim-shpëtimit;

c) parandalimin, zbulimin dhe reagimin më efektiv ndaj ndotjes nga anijet;

ç) sigurimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente;

d) integrimin me sistemet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Rregullat për ngritjen, organizimin, funksionimin, administrimin dhe operimin e VTMIS-it, organi përgjegjës për këtë sistem, kompetencat e autoriteteve përgjegjëse, si dhe afatet për vënien në funksion të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 32/2

Dritarja e Vetme Kombëtare Detare (NMSWe)

1. Dritarja e Vetme Kombëtare Detare (NMSWe) përcakton funksionimin e një sistemi të unifikuar për pranimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit, në lidhje me detyrimet e raportimit për anijet që mbërrijnë, qëndrojnë dhe nisen nga portet detare të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet një ndërfaqeje të harmonizuar, teknologjikisht neutrale dhe të ndërveprueshme me mjedisin e Dritares së Vetme Detare Evropiane (EMSWe), me qëllim lehtësimin e transmetimit elektronik të këtij informacioni.

2. Ky sistem zbatohet për detyrimet e raportimit në mbërritje, qëndrim dhe nisje nga portet detare të Republikës së Shqipërisë, të anijeve që plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Rregullat për ngritjen, organizimin, funksionimin, administrimin dhe ndërveprueshmërinë e Dritares së Vetme Kombëtare Detare, organi përgjegjës për këtë platformë, mënyra e shkëmbimit të të dhënave, kompetencat e autoriteteve përgjegjëse, si dhe afatet për vënien në funksion të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32/3

Administrata Detare

1. Administrata Detare i ushtron funksionet e saj në përputhje me parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke garantuar një nivel të lartë sigurie detare dhe mbrojtjeje të mjedisit detar.

2. Administrata Detare krijohet me ligj dhe garanton:

a) zbatimin efektiv të detyrimeve ndërkombëtare, duke përfshirë konventat, kodet dhe rezolutat e IMO-s, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të legjislacionit kombëtar përkatës;

b) ushtrimin e funksioneve të shtetit të flamurit (*Flag State*), përfshirë regjistrimin e anijeve, certifikimin, inspektimin, auditimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të tyre;

c) ushtrimin e kontrollit të shtetit portual (*Port State Control*) në përputhje me marrëveshjet

rajonale dhe standardet ndërkombëtare, për të verifikuar përputhshmërinë e anijeve të huaja;

ç) në bashkërendim me Rojën Bregdetare, ushtrimin e funksioneve të shtetit bregdetar, përfshirë sigurinë e lundrimit, mbrojtjen e mjedisit detar, menaxhimin e trafikut detar, monitorimin, mbrojtjen, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës detare e nënujore;

d) mbikëqyrjen e organizatave të autorizuar (*Recognized Organizations*) që veprojnë në emër të saj, duke garantuar që delegimi i kompetencave të jetë në përputhje me standardet e IMO-s;

dh) zbatimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me kërkesat e Kodit III, për të siguruar transparencë, gjurmueshmëri dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës;

e) trajnimin dhe kualifikimin e personelit për të garantuar kapacitete teknike dhe profesionale, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

ë) bashkëpunimin ndërkombëtar, përfshirë raportimin, auditimin dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e vlerësimit të IMO-s (si auditimet IMSAS);

f) mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave që lidhen me sigurinë detare, mbrojtjen e mjedisit dhe performancën e flotës nën flamur;

g) zbatimin e masave korigjuese dhe parandaluese në rast të mospërputhjeve të identifikuara nga auditimet, inspektimet ose hetimet e aksidenteve detare.”.

Neni 7

Neni 33, “Regjistri detar”, shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 34 bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:

1. Në pikën 1 togfjalëshi “në kapitenerinë e porteve” zëvendësohet me togfjalëshin “pranë Administratës Detare”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kontrollit shtetëror portual, procedurat e inspektimit, si dhe kompetencat e autoriteteve përgjegjëse përcaktohen me vendim



të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për transportin.”.

Neni 9

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35 Eksperti Detar

1. Ekspert detar është personi fizik që plotëson kriteret e kualifikimit profesional, përvojës në sektorin detar dhe integritetit profesional sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe që angazhohet për të dhënë opinion, vlerësim, asistencë teknike ose këshillimore për çështje që lidhen me hapësirën dhe veprimtarinë detare.

2. Rregullat për kriteret e kualifikimit, përvojën profesionale, procedurat e aplikimit, vlerësimit, regjistrimit, pezullimit dhe çregjistrimit të ekspertëve detarë, si dhe për krijimin, administrimin, përditësimin dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të Ekspertëve Detarë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet detare.

3. Hetimi i aksidenteve dhe incidenteve detare kryhet nga një organ i pavarur hetimor i krijuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 91/2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare”, në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në fuqi.

4. Hetimi nuk synon përcaktimin e fajit apo përgjegjësisë civile ose penale.”.

Neni 10

Në nenin 36 pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Klasifikimi i anijeve, sipas llojit, tonazhit, destinacionit të përdorimit, kapacitetit transportues, fuqisë motorike, shpejtësisë dhe të dhënave të tjera teknike bëhet nga një shoqëri klasifikuese publike ose private.”.

Neni 11

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1 Organizatave e njohura

1. Autorizimi i organizatave të njohura bëhet në përputhje me kërkesat e Kodit për Organizatat e Njohura dhe standardet e përcaktuara nga IMO.

2. Marrëdhëniet ndërmjet Administratës Detare dhe organizatave të njohura rregullohen me marrëveshje të posaçme me shkrim, në të cilat përcaktohen:

- a) fusha e kompetencave të deleguara;
- b) detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve;
- c) procedurat e raportimit dhe shkëmbimit të informacionit;
- ç) kërkesat për transparencë dhe cilësi të shërbimit.

3. Rregullat për autorizimin, monitorimin dhe vlerësimin e organizatave të njohura përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin detar.”.

Neni 12

Neni 100 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 100 Ekuipazhi minimal i sigurt

1.Çdo anije që mban flamurin e Republikës së Shqipërisë duhet të ketë në bord një ekuipazh minimal të mjaftueshëm për të garantuar operimin e sigurt të anijes, mbrojtjen e jetës njerëzore në det dhe mbrojtjen e mjedisit detar, në përputhje me kërkesat e *SOLAS Convention* dhe *STCW Convention*.

2.Ekuipazhi minimal përcaktohet nga Administrata Detare për çdo anije individualisht, duke marrë në konsideratë tipin, madhësinë, fuqinë motorike, nivelin e automatizimit, zonën e lundrimit, organizimin e shërbimit në bord dhe kërkesat për pushim dhe orë pune të ekuipazhit.

3.Administrata Detare lëshon për çdo anije dokumentin “*Minimum Safe Manning Document*”, i cili përcakton numrin dhe kualifikimin minimal të



anëtarëve të ekuipazhit dhe është i detyrueshëm të mbahet në bord.

4. Pronari, operatori dhe kapiteni i anijes janë përgjegjës për respektimin në çdo kohë të kërkesave të ekuipazhit minimal, si dhe për sigurimin që anëtarët e ekuipazhit të jenë të certifikuar dhe të kualifikuar në përputhje me kërkesat e *STCW Convention*.

5. Administrata Detare siguron zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e kërkesave për ekuipazhin minimal, në përputhje me Kodin për Zbatimin e Instrumenteve të IMO-s (*III Code*), duke përfshirë verifikimet, auditimet dhe masat korrigjuese në rast mospërputhjeje.”.

Neni 13

Në nenin 182, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kushtet dhe rregullat që garantojnë sigurinë detare, të cilat janë në përputhje me konventat ndërkombëtare në fushën e sigurisë detare, për përgjegjësinë e transportuesve të pasagjerëve nga deti në rast aksidenti, për radiondërlidhjen, për sistemin e sigurisë në rastet e një aksidenti detar, për kërkim shpëtimin nga rreziqet detare dhe aktet e tjera të së drejtës ndërkombëtare përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin detar.”.

Neni 14

Neni 184, “Mbikëqyrësit”, shfuqizohet.

Neni 15

Neni 191, “Certifikata e sigurisë për mjetet lundruese të udhëtarëve”, shfuqizohet.

Neni 16

Neni 192, “Certifikata për udhëtime ndërkombëtare”, shfuqizohet.

Neni 17

Neni 199, “Certifikata për mjetet lundruese të ngarkesës”, shfuqizohet.

Neni 18

Neni 202 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 202

Periudha e vlefshmërisë së certifikatave

1. Certifikata e sigurisë për anijet e pasagjerëve është e vlefshme për një periudhë që nuk tejkalon 1 vit, në përputhje me kërkesat e *SOLAS Convention*.

2. Certifikata e sigurisë së radios dhe certifikata e sigurisë së pajisjeve për anijet e mallrave janë të vlefshme për një periudhë që nuk tejkalon 5 vjet, me kusht që të kryhen me sukses inspektimet periodike të kërkuara.

3. Certifikatat e përjashtimit lëshohen në përputhje me kërkesat e instrumenteve ndërkombëtare detare dhe janë të vlefshme për një periudhë që nuk tejkalon vlefshmërinë e certifikatës përkatëse me të cilën lidhen.

4. Periudha e vlefshmërisë së certifikatave, si dhe kushtet për rinovimin, zgjatjen, pezullimin ose anulimin e tyre përcaktohen në përputhje me instrumentet ndërkombëtare detare në fuqi dhe legjislacionin kombëtar përkatës.”.

Neni 19

Nenet 204, 205 dhe 206 shfuqizohen.

Neni 20

Pas nenit 289 shtohet neni 289/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 289/1

Përcaktimi i rregullave për zbatimin e të drejtave të udhëtarëve

Rregullat, procedurat dhe masat e nevojshme për sigurimin e respektimit dhe zbatimin efektiv të të drejtave të udhëtarëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 21

Në nenin 359 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:



“Rregullat, procedurat dhe masat e nevojshme, lidhur me sigurimin e detyrueshëm të pronarëve të anijeve për mbulimin e pretendimeve detare ndaj të tretëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 22

Pas neni 395 shtohen nenet 395/1 dhe 395/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 395/1

**Shkeljet administrative në sistemin
VTMIS dhe NMSW**

1. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë Kod dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, lidhur me raportimin, komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit dhe Informacionit të Trafikut Detar (VTMIS) dhe Dritares së Vetme Kombëtare Detare (NMSW) përbën kundërvajtje administrative.

2. Në varësi të natyrës, pasojave dhe nivelit të rrezikut të krijuar për sigurinë e lundrimit, jetën njerëzore në det dhe mbrojtjen e mjedisit detar, shkeljet klasifikohen si:

- a) shkelje të lehta;
- b) shkelje të mesme;
- c) shkelje të rënda;
- ç) shkelje shumë të rënda.

3. Shkelje të lehta konsiderohen, ndër të tjera, rastet e:

- a) vonesave në përmbushjen e detyrimeve të raportimit;
- b) pasaktësive jo thelbësore në informacionin e transmetuar;
- c) mosrespektimit të kërkesave formale të komunikimit, kur nuk sjellin pasoja për sigurinë detare.

4. Shkelje të mesme konsiderohen, ndër të tjera, rastet e:

- a) mosraportimit të informacionit të detyrueshëm;
- b) mosrespektimit të procedurave të përcaktuara për komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve VTMIS dhe NMSW.

5. Shkelje të rënda konsiderohen, ndër të tjera, rastet e:

a) mosraportimit të qëllimshëm të të dhënave të kërkuara;

b) dhënies së informacionit të pasaktë ose të paplotë, kur kjo ndikon ose mund të ndikojë në sigurinë e lundrimit.

6. Shkelje shumë të rënda konsiderohen, ndër të tjera, rastet e:

- a) manipulimit të sistemeve elektronike të raportimit;
- b) ndërhyrjes së paautorizuar në të dhënat e transmetuara;
- c) veprimeve që krijojnë rrezik serioz për sigurinë detare, jetën njerëzore ose mjedisin detar.

7. Për shkeljet e përcaktuara në këtë nen zbatohen masat administrative, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative, duke përfshirë, sipas rastit:

- a) gjobën administrative;
- b) detyrimin për korrigjimin e menjëhershëm të informacionit të pasaktë ose të munguar;
- c) paralajmërimin administrativ;
- ç) kufizimin ose pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë, kur kjo kërkohet për garantimin e sigurisë detare;
- d) masa të tjera administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 395/2

**Subjektet përgjegjëse dhe parime të
zbatimit**

1. Përgjegjësia administrative për shkeljet e përcaktuara në nenin 395/1 mbahet, nga:

- a) pronari i anijes;
- b) operatori ose menaxheri i anijes;
- c) agjenti detar;
- ç) kapiteni i anijes, kur shkelja lidhet me detyrimet operationale në bord.

2. Masat administrative zbatohen në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, shkallën e fajësisë, pasojat e shkaktuara dhe rrezikun për sigurinë detare, jetën njerëzore dhe mjedisin detar.

3. Në rast përsëritjeje të shkeljes, autoriteti kompetent mund të aplikojë masa administrative më të rrepta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Korrigjimi vullnetar i shkeljes, bashkëpunimi me autoritetin kompetent dhe marrja e masave parandaluese mund të konsiderohen si rrethana



lehtësuese gjatë përcaktimit të masës administrative.

5. Kompetenca për konstatimin e shkeljeve dhe zbatimin e masave administrative ushtrohet nga Administrata Detare dhe autoritetet portuale kompetente sipas fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë Kod.

6. Kundër vendimit për vendosjen e sanksionit administrativ mund të ushtrohet e drejta e ankimit sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për kundërvajtjet administrative, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.”.

Neni 23

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32/1, 32/2, 34, 35, 289/1 dhe 359 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për transportet që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë akte nënligjore në zbatim të nenit 36/1 të këtij ligji.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 467, datë 3.8.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 467, datë 3.8.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 84/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, ‘Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 175][Datë: 06.08.2026 14:21:28
+02:00][35ad7a4f-f2eb-4eea-b241-92b4c0511165]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)